



Manuali i Raportimit të Diversitetit



Nga David Tuller

Manuali i Raportimit të Diversitetit

Parathënie nga John Owen

Londër, 2003

Një botim i Institutit të Diversitetit të

Medias me ndihmën e Komunitetit European

Instituti i Diversitetit të Medias & Samizdat B92, 2003

I përgatitur nga Instituti i Diversitetit të Medias
Çdo pyetje lidhur me këtë botim duhet t'i bëhet Institutit të Diversitetit të Medias
100 Park Village East, London NW1 3SR, UK
Tel: + 44 207 38 00 200
Fax: +44 207 38 00 050
Email: info@media-diversity.org
Website: www.media-diversity.org

Autor: David Tuller për Institutin e Diversitetit të Medias

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Komunitetit Europian. Pikëpamjet e shprehura në të janë ato të Institutit të Diversitetit të Medias dhe prandaj nuk duhet të mendohet se pasqyrojnë mendimin zyrtar të Komunitetit Europian.



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Komunitetit Europian. Pikëpamjet e shprehura në të janë ato të Institutit të Diversitetit të Medias dhe prandaj nuk duhet të konsiderohen se pasqyrojnë mendimin zyrtar të Komunitetit Europian.

Falenderime

Do të dëshironim të falenderonim Partnerët e Rrjetit të Diversitetit të Raportimit nga Europa Juglindore për kontributin e tyre për këtë manual dhe për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm gjatë të gjithë punës.

Remzi Lani, Ilda Londo, Instituti Shqiptar i Medias; Veran Matic, Shoqata e Medias Elektronike të Pavarur (ANEM); Dragan Janjic, Igor Jovanovich, Agjencia e Lajmeve Beta; Ioana Avedani, Qendra për Gazetarinë e Pavarur - Bukuresht; Sandor Orban, Qendra për Gazetarinë e Pavarur - Budapest; Angela Siribu, Qendra për Gazetarinë e Pavarur – Çisinau; Kim Mehmeti, Qendra për Mirëkuptimin dhe Bashkëpunimin Shumëkulturore; Milica Lucic-Cavic, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë; Stjepan Malovic, Qendra Ndërkombëtare për Edukimin e Gazetarëve; Zaneta Trajkoska, Antoaneta Ivanova, Instituti Maqedonas për Median; Boro Kontic, Qendra e Medias; Ognian Zlatev, Qendra e Zhvillimit të Medias; Zoran Udovicic, Radenko Udovicic, Instituti Media Plan; Gabor Bernath, Qendra e Shtypit Roma; Stojan Obradovic, Agjencia e Lajmeve STINA; Zeljko Ivanovic, Vijesti; Feodor Nincic and Stelian Dorobantu

Do të dëshironim të falenderonim veçanërisht Mirjana Milosevic dhe Gabor Stojanovits.

Manuali i Diversitetit të Raportimit

10	JOHN OWEN	Parathënie
		1.
12	MILICA PEŠIĆ	Hyrje
		2.
16		Karakteristika të përgjithshme për raportimin e diversitetit
17		Mundësitë për gjetjen e burimeve
19		Si të intervistohen njerëz nga grupe të tjerë
		3.
22		Etniciteti
26		Raste për studim
		a) “Ciganët sulmojnë me sëpata forcat e policisë ushtarake”
27		b) “Punonjësit e Radios C ndihmohen të përgatisin një reklamim të drejtuar – Atyre u pëlqen të bëjnë muhabet”
29		c) “Lufta Rome në Szentpal”
31		d) “Më vunë automatikun në kokë”
33		e) “Bebja vdes sepse nëna nuk fliste maqedonisht dhe nuk mund të komunikonte me mjekët – Kur nuk flitet gjuha zyrtare”
36		f) “Nxënësit kundërshtojnë ndarjet etnike”
39		g) “Romët si bizelet, të tjerët i shesin si lëng”
40		h) “Barcaletë”

	4.
42	Feja
	Raste për studim
46	a) "Kjo është luftë: Duhet të pushtojmë vendet e tyre"
49	b) "Mitropoliti Dënon Homoseksualitetin"
	5.
50	Gjinia
	Raste për studim
53	a) "Feministet mbulojnë posterat me grafitë"
55	b) "Gratë – Viktima të Dhunës Familjare dhe Martesore: Trupa të Rrahur dhe Shpirtra të Goditur"
60	c) "Mariana dhe shenjat që nuk kurohen: Varfëria ka shndërruar shtetin sovjetik dikur në lulëzim në një burim kryesor prostitutash"
	6.
66	Njerëz me paaftësi
	Raste për studim
69	a) "Të paaftët jetojnë mes nesh, jo të ndarë nga ne"
74	b) "Të çmendurit e pjekur"
	7.
76	Grupet shoqërisht në disavantazh
	Raste për studim
79	a) "Veteranët e luftës në gjendje alarmuese: një vetëvrasje në ditë"
81	b) "Për disa njerëz bashkësia e drogmenëve është një ishull shpëtimi"

	8.
<u>84</u>	Të moshuarit dhe pensionistët
	Raste për studim
<u>87</u>	a) "Gjysmë vote për ata mbi 60 vjeç"
	9.
<u>88</u>	Refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit
	Raste për studim
<u>91</u>	a) "Politika e strehimit davaritet si tym – Pra, kështu na falenderojnë ne ata: Të ndaluarit kryengritës fillojnë një shkëndijë 35 milionë stërlina"
<u>93</u>	b) "Familja e refugjatëve shqiptarë në dyzim: Të evakuarit janë në mës të dilemës për një jetë të re ose të merren me atë të vjetrën, ndërkohë që presin se si mund të kthehen në shtëpitë e tyre të përfshira nga lufta"
	10.
<u>98</u>	Orientimi Seksual
	Raste për studim
<u>101</u>	a) "Kundërshtimi nga një lezbike çoi në një masakër – Aventurat seksuale të viktimës"
	b) "Homoseksualët në Shqipëri: Të Jashtëligjshëm"
	11.
<u>106</u>	Opozita politike dhe disidentët
	Raste për studim
<u>109</u>	a) "Çfarë ofrojnë udhëheqësit shiptarë si zgjidhje për krizën e Kosovës? – Pavarësi përmes luftës apo paqes"
<u>111</u>	b) "Manipulimi i një përkujtimoreje"

	<u>12.</u>	_____
<u>114</u>		Fotografia dhe pamja
	<u>13.</u>	_____
<u>118</u>		Modulet e trajnimit
	<u>14.</u>	_____
<u>142</u>		Fjalor i vogël

Manuali i Raportimit të Diversitetit

JOHN OWEN **Parathënie**

Parathënie

A do ta bindte një raportim i saktë dhe i drejtë rreth “asaj tjetrës” shoferin e taksisë sime në Londër se të gjithë çëçenët nuk janë “banditë e maskarenj”? Ky emigrant i kohëve të fundit nga Bullgaria e kishte fjalën për një grup ekstremist çëçen që mbajti qindra pengje në një teatër të Moskës.

Apo një raportim më i mirë në Sllovaki do të ndihmonte për t’i dhënë fund mungesës së tolerancës racore që u shfaq kur tifozët e futbollit ngacmuan futbollistët anglezë me ngjyrë që luajtën në Bratislavë?

Instituti i Diversitetit të Medias mendon se në demokracitë në zhvillim gazetaria shpesh ka qënë një forcë negative duke botuar shkrime të mbushura me gjysmë të vërteta, keqinformime dhe dallime raciale.

Drejtori i saj themelues Milica Pesic argumenton me pasion se me trainimin e ri-trainimin e duhur një brez i ri gazetarësh të zgjuar e të përgjegjshëm mund të kthejnë komunitetet e urryer në demokraci tolerante dhe produktive.

Nuk është se Pesic dhe Instituti i Diversitetit të Medias po përpiqen të kthejnë gazetarët në punonjës socialë që synojnë të reformojnë shoqëritë e tyre. Ata po i sfidojnë ata me praktikën e bazuar në fakte të mira, të drejta e të paanshme për një gazetari që informon e jo disinformon.

Për të ndihmuar gazetarët të kuptojnë më mirë ku kanë shkelur shumë keq IDM ka prodhuar këtë Manual të Diversitetit të Medias. Është një përmbledhje ngacmuese e shkrimeve të këqinj, shpesh keqdashës që mund të përdoren si raste për studim se si kanë shërbyer kaq keq gazetaret për lexuesit dhe komunitetet e tyre. Nëse redaktorët e këtyre gazetave do të ishin mjekë, atyre do t’u hiqej liçenca për keqpërdorim mjekësor.

Por ky manual i jep gazetarëve (dhe kujtdo që është i interesuar si të përmirësojë gazetarinë) këshilla konstruktive se si të korrigojnë gabimet e tyre dhe të shmangin bërjen e të tjerëve. Çdo redaktor dhe reporter duhet ta mbajë këtë manual në tavolinën e tij dhe të pyesë veten nëse shkrimi që sapo ka bërë ose redaktuar përputhet me standartin editorial të përcaktuar nga ky manual.

Dhe jo vetëm demokracitë e paskonfliktit ose në tranzicion duhet të rishqyrtojnë raportimin e tyre për “të tjerët”. Edhe disa gazeta tabloide britanike janë përpjekur të rrisin tirazhin e tyre duke fshikulluar ata që kërkojnë strehim politik, lypësit “romë” dhe politikanët homoseksualë. Ata kanë tregtuar fitime afatshkurtra për besueshmërinë afatgjatë. Dhe në Shtetet e Bashkuara producentët e programeve të revistave televizive e kanë pranuar se shpesh ata nuk i pranojnë intervistat e pakicave nga frika se shumë shikues të tyre do të ndërrojnë stacionin televiziv.

Jam plotësisht në një mendje me Milica Pesic se gazetaria e diversitetit nuk është një problem, një gur kilometrazhi që varet në qafën e redaktorëve dhe reporterëve të mbërthyer gjithnjë nga puna. Redaktorët e mençur do ta pranojnë se një pjesë e anashkaluar dhe e lënë pas dore e popullsisë mund t’i shtohet radhëve të lexuesve të tyre. “Diversiteti shet” është një parrullë që duhet të ngjitet në të gjitha zyrat e redaksive.

John Owen Ish-kryeredaktor i emisionit të lajmeve të televizionit CBC, drejtor themelues i Qendrës Europiane për Forumin e Lirisë, dhe profesor i jashtëm i gazetarisë në City University, Londër.

MILICA PEŠIĆ **Hyrje**

Hyrje

Shumë prej nesh që kanë jetuar në komunizëm mendojnë, ndoshta në mënyrë naëve, se rënia e Murit të Berlinit do të siguronte respektin për individët dhe për të drejtën e tyre për të qënë ndryshe. Ne mendonim se frika dhe paragjykimi i mbështetur në ndryshime etnike, politike, fetare e të tjera në njëfarë mënyrë do të platitej në një epoke të re të mirëpritur të tolerancës dhe dashurisë.

Veç gjërave të tjera luftërat e gjata e të përgjakshme në Ballkan treguan se sa gabim e kishim. Ajo që ndodhi atje shkatërroi jo vetëm jetën e njerëzve dhe shoqëritë e krijuara prej kohësh por dha edhe një mësim vdekjeprurës pavarësisht se sa duhej ai se sa në mënyrë të efektshme media mund të ndihmojë të përçajë komunitetet duke nxitur e inkurajuar konfliktin ndëretnik. Propaganda e transmetuar në televizionin serb-gjuha e urrejtjes që përdorte ai për të përcaktuar ata që cilësoheshin si armiq, gënjeshtër dhe përjashtime në mbulimin e tij-është shembulli më i mirë, por jo i vetmi. Ndonjëherë dukej sikur gazetaret dhe mediat elektronike në të gjithë rajonin ishin praktikisht duke konkuruar me njëri tjetrin për të shpërndarë stereotipet dhe imazhet më të këqinj të atyre të perceptuar si “të tjerët”.

Ndërkohë që situata dhe mbulimi i çështjeve nga media në të gjithë Ballkanin dhe më gjerë në mbarë Europën juglindore është përmirësuar në dy vitet e fundit, përsëri mbeten shumë probleme. Shkeljet e ashpra të të drejtave të njeriut dhe rivalitetet etnike ende mbizotërojnë në rajon. Kundërshtarët politikë në mënyrë rutinë shprehin mosmarrëveshjet e tyre në mënyrën më të keqe të mundshme. Diskriminimi dhe mungesa e tolerancës bazuar te feja, gjinia, statusi shoqëror, mosha, paaftësia emocionale dhe fizike, orientimi seksual dhe karakteristika të tjera kërcënojnë stabilitetin e të gjithë rajonit dhe krijojnë kushte të favorshme për ata që kërkojnë të nxisin ekstremizmin.

Mediat rajonale shpesh nuk përfshijnë fare informacion për të ndihmuar audiencën e tyre për të kuptuar të drejtat, traditat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të pakicave që jetojnë mes tyre. Në vend të kësaj gazetarët shpesh ofrojnë një mbulim negativ ose më e mira sipërfaqësor që ngjall më shumë dyshime dhe frikë. Me pak përjashtime, media ende jep nocionin se ndryshimi nënkupton inferioritet, që grupet e pakicës përbëjnë një kërcënim për kombin dhe nuk meritojnë të drejta ose trajtim të barabartë.

Sigurisht që ky problem nuk është i kufizuar vetëm në Europën juglindore ose në rajonet e tjera në tranzicion. Gjatë viteve të fundit gazetarët dhe vendim-marrësit e medias në Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera në perëndim janë përfshirë nga çështja se si të përmirësojnë mbulimin e tyre për të gjithë llojet e grupeve të pakicave. Ndërkohë që është bërë shumë përparim, shembujt e stereotipeve etnike, gjuhës fyese dhe raportimit të njëanshëm ende mund të gjenden pa u munduar shumë.

Ende mundësitë e rrezikut janë të larta për vendet që janë në rrugën e vështirë drejt demokracisë. Sepse vetë thelbi i projektit demokratik ka të bëjë me përfshirjen dhe integrimin e plotë të të gjithë njerëzve në jetën e një kombi. Dhe media përfaqëson një burim shoqëror të fuqishëm që mund-dhe duhet-të mobilizohet për të ndihmuar në këtë proces ripajtimi. Kur gazetarët ndjekin misionin e tyre me vullnetin e mirë dhe një mendje të hapur, ata mund të luajnë një rol të rëndësishëm në transformimin e marrëdhënieve midis grupeve të komuniteteve të ndryshme etnike, fetare e të tjera në shoqëritë demokratike në zhvillim.

Duke njohur këtë potencial Instituti i Diversitetit të Medias ka zhvilluar dhe zbatuar një program trainues rajonal të Diversitetit të Raportimit (DR), në sajë të mbështetjes nga Komisioni European. Thelbi i programit është Rrjeti i Diversitetit të Medias (RRDM) i ndërmarrë që në nëntor 1998, i cili lidh gazetarët, organizatat e mediave, shkollat e gazetarisë dhe organizatat e tjera të medias dhe qendrat e ndihmës në mbarë Europën lindore e qendrore. Rrjeti kërkon të nxisë e të institucionalizojë standartet më të larta të gazetarisë profesioniste përmes strategjive të trainimit dhe nismave praktike të raportimit, si edhe të mobilizojë forcën e medias që publiku ta kuptojë më drejt diversitetin, komunitetet e pakicave dhe të drejtat e njeriut.

Mendojmë se raportimi i drejtë, i saktë, afirmues dhe i thellë është jetësor në nxitjen e kësaj forme të kuptuari, duke u përballur me paragjykimin e duke sfiduar rendet e ditës politike radikale. Në fakt ekziston një lidhje thelbësore midis institucioneve demokratike në zhvillim dhe diversitetit përkatës. Asnjë shoqëri nuk është me të vërtetë homogjene dhe kalimi në demokraci nuk mund të përmbushet pa e njohur këtë fakt. Në qoftë se një nga funksionet kryesore të gazetarisë është të pasqyrojë nevojat dhe aspiratat e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, atëhere gazetarët duhet të gjejnë mënyra e teknika për të bërë pikërisht këtë-jo thjesht si një çështje për drejtësi, por si një hap që kujtdo t'i ofrohet mundësia për të patur pjesën e përgjegjësive dhe shpërblimeve të qytetarisë.

Kjo do të thotë se diversiteti i raportimit nuk është çështje e një gazetarie të shkëlqyer. Është edhe një praktikë biznesi e matur. Duke rritur përfshirjen e mbulimit, organizatat e mediave do të jenë në gjendje të thyejnë barrierat e ngushta të tregjeve të parcelizuar ku gjenden shumica e tyre. Ata do të zbulojnë se ata mund të forcojnë shumë lidhjet e tyre me një audiencë potenciale të pamenduar më parë, sidomos ndërmjet atyre që nuk kanë ndjerë që jeta dhe perspektiva e tyre të jetë respektuar ose përfaqësuar mirë nga gazetat dhe mediat e tjera elektronike.

Pavarësisht ndryshimeve tona ne jemi të gjithë anëtarë të komuniteteve ku jetojmë e punojmë. Të gjithë duam të jetojmë në paqe e të kontribuojmë për shoqëritë tona. Të gjithë duam të jemi në gjendje të ushqejmë familjet tona e të edukojmë fëmijët tanë. Dhe ne duhet të mësojmë të trajtojmë diversitetin tonë aq befasues si një burim force dhe shprese, të pasurimit e të kuriozitetit jo si një justifikim për dhunë dhe shkak për dëshpërim.

Si gazetarë kemi mundësinë unike të lehtësojmë procesin e ripajtimit. Kemi aftësinë të ndihmojmë të gjithë anëtarët e komuniteteve tona për të shprehur nevojat dhe dëshirat e tyre. Kemi fuqinë të ndihmojmë për të eliminuar stereotipet dhe paraqitjen e shtrembëruar të pakicave etnike, racore dhe fetare brenda shoqërive tona. Dhe ne kemi autoritetin për të formuar diskutimin e për të përcaktuar fushat e interesave të përbashkëta përmes raportimit të saktë e të paanshëm.

Ky manual është vetëm një pjesë e programit tonë gjithëpërfshirës për të ndihmuar shoqëritë në zhvillim, për një trajtim sa më të mirë të çështjeve diversitetit dhe të “të tjerëve”. Qëllimi i tij parësor është t’u japë mundësi gazetarëve të përmirësojnë raportimin e tyre për grupet e pakicave, marrëdhëniet ndëretnike dhe të drejtat bazë të njeriut. Manuali mund të përdoret gjithashtu nga redaktorët dhe pronarët e organizatave të medias, të cilët mbajnë përgjegjësinë më të madhe se si mbulohen çështje të tilla.

Që prej krijimit të Programit të Diversitetit të Raportimit kemi prodhuar tetë versione kombëtare të Manualit të Burimeve të DR-së për vende të ndryshme të Europës juglindore, si edhe dy botime ndërkombëtare në gjuhën angleze në bashkëpunim me organizatat tona partnere të DR-së. Manuali i tanishëm mbështetet në përvojën tonë të deritanishme duke përcaktuar një metodologji sistematike për të gjitha aktivitetet trainuese të DR-së, si për reporterët ashtu edhe për vendim-marrësit e medias. Shpresojmë se do të jetë i dobishëm dhe i përdorshëm nga ana juaj. Ju lutemi jeni të lirë të kopjoni e të shkëmbeni cilido prej materialeve të ISHM në këtë manual – sa më shumë të përdoret, aq më mirë. Do t’ju kërkonim që kur të përdornit materialin tonë, ju lutemi, përmendni se ai vjen prej nesh. Ju faleminderit!

Milica Pesic,
Drejtore
Instituti i Diversitetit të Medias

2. Karakteristika të përgjithshme për raportimin e diversitetit

Karakteristika të përgjithshme për raportimin e diversitetit

Një prej detyrave më të rëndësishme me të cilën përballen gazetarët është të shkruajnë për njerëzit që ndryshojnë prej tyre në gjëra thelbësore. Nëse një burim është i një etnie, besimi fetar, orientimi seksual, klase shoqërore, ose statusi ekonomik tjetër, shpesh roli i gazetarit është të transmetojë me saktësi mendimet e personit, idetë ose pikpamja e tij, edhe pse dallimet mund të jenë të thella.

Në zona si Europa juglindore, ku dallimet shoqërore dhe etnike kanë thelluar lidhjet e komuniteteve të ndryshme, arritja e këtij objektivi mund të jetë veçanërisht shumë i vështirë për t'u kuptuar. Megjithatë nuk është i pamundur. Dhe nëse gazetarët dëshirojnë të kurojnë e të ripajtojnë shoqëritë e tyre, është thelbësore që ata të bëjnë të pamundurën për të nxitur mirëkuptimin dhe tolerancën e dallimeve dhe jo të frikësohen e të jenë mosbesues.

Mundësitë për gjetjen e burimeve

Disa strategji merren kryesisht me grupe specifike ose tipe të dallueshme. Por sugjerimet e mëposhtme përfshijnë të gjithë:

★ Kur bëni një shkrim për një minoritet etnik, shoqëror, fetar ose tjetër është jashtëzakonisht e rëndësishme të intervistoni përfaqësues të atij grupi dhe të përfshini mendimet e tyre në atë shkrim. Me fjalë të tjera, ata janë 'objekt' e jo 'subjekt' i artikullit. Asnjë artikull nuk duhet të kritikojë një grup të tërë njerëzish pa u ofruar pjesëtarëve të këtij grupi mundësinë të paraqesin pikëpamjen e tyre dhe t'i përgjigjen akuzave.

★ Tregoni kujdes në përdorimin e fjalëve e të shprehjeve tuaja. Fjalët kanë forcë të madhe për të goditur si edhe për të shëruar. Përdorimi i pakujdesshëm i gjuhës mund të ngreje tensionet etnike e shoqërore, edhe kur nuk e bën qëllimisht. Tregoni kujdes se si anëtarët e një komuniteti preferojnë të quhen në gjuhën në të cilën shkruani ju. Shqiptarët e quajnë veten "shqiptarë", për shembull, por kur ajo përdoret në gjuhën sllave ajo konsiderohet si një fjalë fyese.

★ Kur mblidhni material përpikuni të njihni, pavarësisht nga paragjykimet dhe njëanshmëria që mund të keni. Natyrisht që do të keni mendimet tuaja, por pjesë e rolit të gazetarisë është të vësh në pikëyetje veten tënde dhe idetë e paramenduara të shoqërisë. Shumë prej bindeve të mbështetura nga një grup lidhur me një grup tjetër mbështeten jo në fakte por në stereotipe, megjithëse shpesh stereotipet kanë një ele-

ment të së vërtetës. Për shembull, disa burra homoseksualë janë pak femërorë (siç mund të jenë edhe disa burra heteroseksualë), por shumica nuk janë të tillë.

★ Tregoni kujdes kur përdorni fraza si “siç e dinë të gjithë” ose “është e qartë se.” Kjo lloj shprehje është zakonisht mënyra se si gazetarët shprehin njëanshmërinë e tyre, ose atë të grupit të tyre shoqëror, dhe çfarëdo që të jetë ajo “të gjithë e dinë” ajo ka kaq shumë të ngjarë të jetë false ose e mbështetur në paragjykime sa ç’mund të jetë një mendim i vërtetë i fakteve në një situatë të veçantë.

★ Shumica e situatave që kanë të bëjnë me konflikte midis grupeve shoqërore janë të ndërlikuara. Në përgjithësi të dyja palët kanë ankesa e mendime të ligjshme dhe paraqitja e atyre mendimeve në mënyrë të drejtë e të saktë është një pjesë e rëndësishme e rolit të gazetarisë. Përpikuni të mos parashtroni çështje shoqërore të vështira me terma bardh-e-zi.

★ Përfshirja e njerëzve me përvoja të ndryshme nuk është thjesht vetëm një çështje e drejtësisë dhe e balancës. Ajo është e rëndësishme për median edhe nga pikpamja e biznesit. Shumë institute të medias e kufizojnë audiencën e tyre potenciale vetëm me opinionin e në grupi të vetëm. Nëse bëjnë ndonjë përpjekje për ta zgjeruar mbulimin duke pasqyruar edhe komunitetet e tjera, në të njëjtën kohë ato mund të zgjerojnë edhe audiencën e tyre.

★ Tregoni kujdes për të dhënë një farë konteksti për ngjarjet të cilat po i mbulon. Luftërat etnike, fetare ose të tjera shoqërore nuk dalin nga asgjëja. Zakonisht ka një histori të gjatë konflikti, ku secila palë ka ndryshime të mëdha lidhur me interpretimet e së shkuarës. Para se të paraqisni në mënyrë të drejtë materialin, ju duhet të kuptoni se çfarë ka qënë më parë dhe pastaj duhet të vendosni se sa nga e kaluara duhet të përfshini në shkrim për lexuesit që të arrijnë të kapin pikat thelbësore.

★ Gjeni mënyra të pazakonta për të shkruar për këto çështje. Kaloni një ditë të tërë me një person pa shtëpi, një lezbike, ose një refugjat për të kuptuar se si është jeta e tyre. Cilat janë shpresat dhe frika e tyre? A janë të ngjashme me stereotipet tuaja, apo jo? Nëse një grup shoqëror është kundër përdorimit të një fjale të veçantë për të përshkruar anëtarët e tij, hulumtoni historinë e kësaj fjale. Çfarë shoqatash dhe idesh komunikon kur përdoret? Përse njerëzit janë kundër përdorimit të saj? Përse anëtarët e një grupi tjetër shoqëror vazhdojnë ta përdorin atë?

★ Kultivoni burime në komunitetet e tjera. Gjeni njerëz që kanë dëshirë t’ju mbajnë të informuar se çfarë mendojnë anëtarët e një grupi shoqëror, për çfarë flasin dhe për çfarë janë të shqetësuar. Vendosni kontakte me organizata joqeveritare që përfaqësojnë këto komunitete dhe pyetini ato se çfarë aspekte të jetës së tyre nuk është mbuluar ende. Kërkojuni të qëndrojnë në kontakt me ju lidhur me zhvillimet politike, shoqërore, ekonomike e të tjera për të cilat ju nuk do të merrnit vesh diku tjetër.

★ Jini skeptik. Kontrolloni faktet. Nuk duhet të pranoni menjëherë çdo gjë që dëgjoni, edhe nëse vjen nga një anëtar i komunitetit tuaj apo i një komuniteti tjetër.

Kini parasysh se cilido që flet me ju ose intervistoni ka një këndvështrim dhe interes të veçantë. Duhet të merrni parasysh mendimin e tyre, por duhet ta balanconi atë me atë që dëgjoni nga të tjerët dhe me atë që mund të vëzhgoni vetë.

★ Mos i trajtoni minoritetet etnike e të tjera si monolite. Edhe nëse nga jashtë mund të duket sikur të gjithë anëtarët e një komuniteti kanë një pikëpamje të përbashkët, jeta kurrë nuk është kaq e thjeshtë. Kur një grup e konsideron një tjetër se vepron si një etnicitet solid, kjo gjë mund të ashpërsojë shumë tensionet duke ushqyer perceptimin se të tjerët duhen pare me frikë. Flisni me sa më shumë njerëz të jetë e mundur brenda grupeve shoqërore të tjera dhe paraqisni një numër të gjerë mendimesh me nuanca dhe sa më qartë të jetë e mundur.

★ Shumë njerëz kanë ndjenja të forta negative për grupe të ndryshme shoqërore. Thjesht fakti përse disa autoritete, politikanë, klerikë e të tjerë mund të përdorin terma e shprehje fyese nuk do të thotë se si gazetar juve ju kërkohet të përfshini këtë lloj gjuhe fyese në materialin tuaj. Nëse është e mundur, perifrazojeni këto fjalë. Nëse vendosni t'i citoni ata drejtëpërdrejtë, duhet të përmendni se anëtarët e pakicës në fjalë e konsiderojnë një gjuhë të tillë si fyese dhe keqdashëse.

Si të intervistohen njerëz nga grupe të tjera

★ Jini të ndjeshëm dhe mendoni. Duhet të kuptoni që njerëzit që janë të ndryshëm nga ju mund të kenë frikë të flasin me një gazetar, edhe nëse nuk është hera e parë që bëjnë një gjë të tillë. Për të lehtësuar ata mund ta filloni bisedën me disa probleme të thjeshta-për familjet, jetën, hobin e tyre e gjëra të tilla. Kjo do t'i ndihmojë të ndjehen rehat. Do t'i tregojë atyre se i konsideroni si një përfaqësues të një pakice, që jeni në dijëni edhe të aspekteve të tjera të jetës së tyre.

★ Sigurohuni që kuptoni rrethanat që mund të ndikojnë gjatë intervistës. Qartësoni nëse duan ose jo që t'u përdoret emri. Ose që nuk kanë problem të përdoret vetëm emri, por do të preferonin që të mos përmendnit mbiemrin e tyre, qytetin, ose detaje të tjera që do t'i identifikonin. Pranoni kërkesat e tyre dhe mos u përpiqni t'i nxisni për të kundërtën.

★ Nëse keni mundësi të zgjidhni se ku mund t'i intervistoni, vendosni për një vend ku të ndjehen rehat. Shpesh është më mirë të intervistosh njerëzit në mjedisin e tyre, në apartamentin ose zyrën e tyre, sepse atje është vendi ku ndjehen më të çliruar. Gjithashtu ju ndihmon edhe ju të kuptoni mendimin e tyre sepse do t'i kaloni ato në mjedisin e tyre normal dhe ata mund të nxjerrin gjëra që nuk do t'i thonin në një vend më zyrtar e jo të njohur prej tyre.

★ Lerini t'jua tregojnë ngjarjet e tyre sipas metodës së vet. Nëse duan të fillojnë se çfarë ndodhi pesë apo dhjetë vjet më parë, lerini edhe nëse ju duket se nuk ka të bëjë fare

me atë që doni të dini. Përpiquni të parashikoni kohë të mjaftueshme me ta me qëllim që të mos ushtroni presion për të arritur tek pika që doni ju të dini. Njerëzit zakonisht ndjehen më të çliruar të diskutojnë për diçka që e ndjejnë me zemër kur kanë mundësinë të flasin gjerë e gjatë për të.

★ Paraprakisht bëni një listë me pyetje, por përdoreni si një udhëzues të përgjithshëm e jo si diçka të cilës duhet t'i përmbaheni në mënyrë të rreptë. Ndërkohë që bëni pyetje, duhet të dëgjoni me kujdes se çfarë thuhet, kështu që jeni të hapur për këndvështrime të tjera. Jini elastik. Nëse je shumë i lidhur me idetë e tua se çfarë duhet të jetë intervista, mund të mos vësh re ato momente kur burimet tuaja përmenin aspekte të rëndësishme, por që nuk vihen shumë në dukje për problemin, për të cilat ju nuk keni qënë në dijeni më parë.

★ Pavarësisht sa të ndryshëm janë ata nga ju, mos u predikoni se si duhet të jetojnë jetën e tyre. Nëse i afroheni me një qëndrim gjykues, ka shumë të ngjarë ata ta ndjejnë menjëherë këtë dhe ka shumë të ngjarë të mos ndjehen rehat të flasin me ju ose t'ju besojnë që ju të përdorni informacion të ndjeshëm. Ata e kuptojnë gjendjen e tyre shumë më mirë se sa ju— dhe kjo është arsyeja përse ju po i intervistoni ata.

★ Përpiquni të pranoni tek vetja ndonjë njëanshmëri ose paragjykim që keni për pakicën së cilës i përkisni-dhe përpiquni t'i lini mënjanë këto ide kur intervistoni njerëz dhe përgatisni shkrimin tuaj. Nëse keni një mendim stereotip për njerëzit për të cilët po shkruani dhe nuk e pranoni atë, ka të ngjarë ta shfaqni këtë njëanshmëri si në pyetje ashtu edhe në shkrim.

★ Kini parasysh se ekspertë janë burimet tuaja. Ekspert nuk është vetëm një doktor ose një shkencëtar. Burimet tuaja janë ekspertë në jetën e tyre. Mos mendoni se dini se për çfarë do të flasin ato, sepse atëhere nuk do të ishit i hapur për ndonjë befasi. Ju doni që ata të përshkruajnë për ju jetën e përvojën e tyre-dhe puna juaj është t'ia transmetoni këto audiencës.

★ Në fund të bisedës tuaj, pyesni nëse ata njohin ndonjë tjetër që mund të dojë të intervistohet. Kjo mund të jetë një metodë e rëndësishme për gjetjen e burimeve të tjera për këtë ose një shkrim tjetër në të ardhmen. Natyrisht sa më i ndjeshëm të jesh kur interviston, aq më shumë ka të ngjarë që ata të ndihen rehat e t'ju referojnë tek dikush tjetër.

★ Mbi të gjitha tregoni kujdes si e përdorni informacionin. Kur dikush bie dakord të flasë me ju, ata po ju bëjnë një favor të madh. Kur shkruani për ta, bëjeni me kujdes dhe pasion. Është e lehtë të frikësosh anëtarët e audiencës suaj kur raportoni për njerëz të një peisazhi të ndryshëm duke përdorur stereotipe, gjuhë fyese dhe ndëshkuese, informacion të paverifikuar dhe material tjetër të njëanshëm. Megjithatë roli juaj është të ndihmoni audiencën tuaj të kuptojnë njerëz të tjerë e të bashkohen me ta e jo t'i kenë frikë.

3. Etniciteti

Etniciteti

Ndarjet etnike sigurisht luajtën një rol të madh shkatërrues në luftërat e konfliktet e fundit në Europën juglindore. Ndërkohë që faktorë fetarë e të tjerë nxitën tensionet, ishte perceptimi i njerëzve “të tjerë” për shkak të etnisë së tyre që gjeneroi pasionet më të dhunshme e agresive-të cilët, nga ana e tyre, çuan në tragjedi të papara në vitet 1990-të.

Për fat të keq, gazetarët dhe organizatat e tyre të medias shpesh janë gjendur të vendosur në një pozitë jashtëzakonisht delikate e ndonjëherë të pamundur. Si pjesëtarë të një komuniteti etnik të veçantë ata e kanë patur të vështirë të ruajnë një qëndrim të objektivitetit gazetaresk, shpesh për shkak të presioneve mbizotëruese politike dhe shoqërore. Në vend të tij, ata shpesh e kanë konsideruar rolin e tyre si mbrojtës të interesave të një grupi të veçantë etnik që i përkasin dhe jo si vëzhgues që kërkojnë të kuptojnë të gjithë kompleksitetin e situatës që kanë para syve.

Mbulimi i ngjarjeve shpesh ka pasqyruar këtë njëanshmëri duke portretizuar grupe rivale etnike në mënyrë uniforme si gjakpirës, të ligj dhe krejtësisht për t’u fajësuar për konfliktin. Gazetarët në mënyrë rutine kanë përshkruar stereotipet, kanë injoruar shkaqet rrënjësore politike dhe shoqërore të konflikteve, nuk kanë bërë përpjekje të intervistojnë ndokënd që nuk ka mendimin e shumicës dhe nuk kanë mundur t’i vendosin ngjarjet në një kontekst që do të nxiste një kuptim më të gjerë.

Për të ndihmuar shpresën e gazetarëve që të luajnë një rol në forcimin e ripajtim-it dhe respektit për mosmarrëveshjet etnike, më poshtë janë disa sugjerime kritike:

★ Asnjëherë mos shkruaj një artikull pa intervistuar shumë njerëz në pozicione të ndryshme në këtë debat. Çdo material që zhvillohet i parë vetëm nga një këndvështrim është pa dyshim i njëanshëm. Nëse burimet tuaja kritikojnë një grup të tërë etnik, përfaqësuesit e atij grupi duhet të kenë mundësinë t’i përgjigjen akuzave. Përndryshe gazetari thjesht bëhet një zëdhënës i propagandës për një palë.

★ Kushtojini vëmendje të veçantë zgjedhjes së fjalëve e shprehjeve tuaja. Shmangni frazat fyese që përdoren shpesh për t’ju referuar njerëzve të etnive të tjera. Nëse citoni njerëz që përdorin shprehje të tilla, kini parasysh t’i perifrazoni e jo t’i citoni drejtëpërdrejtë. Kjo mund të jetë një zonë e ndjeshme, sepse disa fjalë mund të jenë fyese në një gjuhë, por jo në një tjetër. Kështu është pjesë e punës së një gazetari të kuptojë nuancat e fjalëve. Nëse nuk jeni të sigurt nëse një shprehje është poshtëruese, pyesni njerëzit me të cilët flisni se si ndjehen ata kur përdoret ajo fjalë.

★ Krijoni burime në komunitetet etnike të ndryshme nga juaji. Merrni në telefon OJQ-të (organizatat joqeveritare) që përfaqësojnë interesat e tyre dhe kërkojuni takim. Pyetini për shqetësimet e tyre, shpresat, traditat dhe frikën. Kaloni kohë në institucionet kulturore dhe shoqërore ku grumbullohen-qendra të komunitetit, shkolla, teatro, kudo qoftë-dhe flisni me sa më shumë njerëz të mundeni. Krijoni një për-

shtypje për ambientin e tyre, megjithëse mund të mos jetë i rehatshëm e i këndshëm, megjithatë kjo është mënyra më e mirë për të arritur një kuptim të vërtetë të mendimit të tyre.

★ Shihni brenda vetes me qëllim që të njihni paragjykimet që mund të keni vetë ju. Të gjithë kanë nocione të paragjykuara, qoftë me ndërgjegje ose jo, për anëtarët e grupeve të tjera shoqërore. Vërtetë që kjo është e kuptueshme, por raportimi më efikas e i saktë varet nga aftësia për të njohur këto njëanshmëri dhe t'i lesh ato mënjanë. Kjo është mënyra e vetme për të dëgjuar me të vërtetë se çfarë po të tregojnë njerëzit për jetën dhe ndjenjat e tyre.

★ Sigurohuni që t'i vendosni ngjarjet dhe situatat në një kontekst dhe mos u përqëndroni vetëm në atë se cili sulmoi dikë dje. Asgjë nuk ndodh nga asgjëja. Kur shpërthejnë mosmarrëveshjet dhe konfliktet etnike, gazetarët shpesh e trajtojnë çdo incident si diçka krejt të veçantë. Por zakonisht të dyja palët kanë interpretimet e tyre se si arriti puna deri atje në atë moment. Me qëllim që materiali të paraqitet në mënyrë të drejtë, duhet ta kuptoni këtë histori dhe të përfshini një background të majftueshëm me qëllim që audienca të kuptojë kompleksitetin e vërtetë.

★ Flisni me njerëz në të dy krahët e jo vetëm me ata që e konsiderojnë veten si udhëheqës. Shpesh burrat, gratë e fëmijët në terren kanë një pikpamje shumë të ndryshme për atë që po ndodh në krahasim me ata që pretendojnë të flasin ose të veprojnë në emër të të gjithë grupit. Çfarë duan ata në të vërtetë? Pyetini ata nëse strategjitë të cilat ndiqen në emër të tyre janë, sipas pikëpamjes së tyre, mënyrat më të efektshme për të arritur objektivat.

★ Përqëndrohuni jo vetëm në efektet e dukshme të një lufte etnike, por edhe në pasojat më pak të dukshme. Çfarë traumash afatgjata po ndodhin? Cila është pasoja e konfliktit në fushën shoqërore dhe ekonomike? Cilat janë pasojat për të ardhmen e asaj që po ndodh sot?

★ Në raportimin tuaj nga të dy palët përpikuni të përcaktoni ku ka pika të përbashkëta-dhe pastaj bëjini ato të ditura. Është e lehtë të gjenden njerëz që duan të demonizojnë ata nga një grup tjetër etnik. Por një reporter që gërmon pak më thellë dhe nëse bën pyetje zhbiruese mund të gjejë që në fakt objektivat e profetizuara nga të dyja palët lidhur me ndarjen mund të mos jenë kaq të ndryshme sa besojnë njerëzit.

★ Përpikuni të përqëndroni emocionet e atyre që nuk luftojnë, si edhe ngjarjet që zhvillohen aktualisht në terren. Të gjithë jemi qenie njerëzore, në fund të fundit, dhe shpesh është e lehtë për pjesëtarët e një grupi shoqëror të bashkohen me frikën dhe dhimbjen e civilëve në anën tjetër në krahasim me deklaratat agresive dhe nxitëse të gjeneralëve dhe politikanëve. Shumë njerëz mund të ndjejnë keqardhje për vdekjen e një fëmije ose të një prindi, për humbjen e një shtëpie, ose të ndjenjës së shpresës.

★ Mos paragjykoni që çdo palë ka një realitet monolit dhe se të gjithë janë në një mendje. Çdo komunitet ka disidentë nga pozita e shumicës. Disa mund të kenë frikë

të shprehen duke iu trembur raprezaljeve nga fqinjët, politikanët ose të tjerë. Por gjithnjë duhet të jeni të ndërgjegjshëm se ekzistojnë fraksione të tjera edhe në shoqëritë në dukje më të lidhura dhe ju duhet të bëni një përpjekje të gjithanshme për të zbuluar e për të paraqitur mendimin e tyre.

★ Përpiquni t'i përshkruani ngjarjet në mënyrë të saktë dhe të citoni burimet e informacionit tuaj në vend që të mbështeteni në mbiemra nxitës si "brutal", "jonjerëzor" dhe "barbar". Gazetarët shpesh bien pre e këtyre shprehjeve, me qëllim ose jo, duke deklaruar palën tjetër që nxit ciklin e dhunës. Duke bërë kështu ata në përgjithësi po përmbushin qëllimet dhe po shpërndajnë pikëpamjet e vetëm njëres palë në konflikt.

★ Kujtoni që duhet të jeni skeptik. Mos lejoni veten të përdoret ose të manipulohet nga njerëz në cilëndo anë të konfliktit. Kontrolloni çdo fakt sa më shumë të jetë e mundur. Nëse nuk mund të jeni plotësisht i sigurt nëse diçka është e saktë, ose mos e përfshini informacionin, ose atribuojeni tek burimi juaj e mos e paraqisni atë si të vërtetë. Kur vlerësoni atë që dëgjoni, merrni parasysh besueshmërinë e burimit në të kaluarën. Audiencës jepini sa më shumë detaje që të jetë e mundur lidhur me informacionet dhe motivet me qëllim që vetë njerëzit ta gjykojnë se sa e besueshme mund të jetë ajo gjë.

★ Mos merrni parasysh thirrjet nga autoritetet e të tjerë që kërkojnë që ju të demonstroi atë që ata e quajnë "besueshmëri" ose "solidaritet etnik" të mjaftueshëm. Roli juaj nuk duhet të jetë përshkrimi i stereotipeve racistë, që të veproni si drejtues të njëres anë, ose të shpërndani thashetheme të pakonfirmuara që mund të nxisin veprime ekstreme. Besueshmëria dhe solidariteti tuaj i përkasin audiencës suaj, për të cilën mendohet se grumbulloni informacionin më të mirë e më të saktë të mundshëm.

★ Shumë njerëz kanë ndjenja të forta negative për persona nga grupe të tjera etnike thjesht sepse disa autoritete, politikanë, klerikë e të tjerë tregohen të shpër në gjuhën e tyre. Por kjo nuk do të thotë që ju kërkohet, si gazetar, ta përfshini këtë lloj gjuhe fyese në materialin tuaj. Nëse është i nevojshëm, perifrazojeni. Nëse vendosni t'i citoni drejtëprdrejtë, duhet të përmendni që anëtarët e një grupi që është në fjalë e konsiderojnë një gjuhë të tillë si fyese dhe nxitëse.

Raste për studim

Rastet për studim të përfshira në seksionet e mëposhtme ofrojnë një analizë të artikujve të mbledhur në Europë dhe Shtetet e Bashkuara nga Instituti i diversitetit të Medias, artikujt shoqërohen me komente që nxjerrin në pah shembuj të praktikave gazetareske efikase dhe problematike dhe sugjerojnë qëndrime apo udhëzime për përmirësimin e raportimit të diversitetit.

Ngjarjet e përshkruara në këtë artikull janë jashtëzakonisht të paqarta, me shumë konfuzion të shkaktuar ngaqë autori është mbështetur në stereotipet e Romëve si një popull hajdut dhe hakmarrës. Nuk duket se është bërë ndonjë përpjekje për të biseduar me ndonjë Romë që është përmendur ose të jepet ndonjë background për situatën, si, bie fjala, tensionet etnike ekzistuese dhe ndonjë veprim agresiv ndërmarrë nga pala tjetër.

3. a) Ciganët sulmojnë me sëpata forcat e policisë ushtarake

Të përshkruash një ngjarje që i ngjan një revolucioni është tepër nxitëse, sidomos meqë incidenti pëfshinte disa dhjetëra Romë e jo qindra ose mijëra. Frazja është hartuar që të përhapë frikë, jo t'u bëjë të ditur lexuesve se çfarë ndodhi.

Mund të jetë e vërtetë, por duket si një tejthjeshtëzim i një situatë të ndërlikuar. Të 26 punonjësit paraqitën dorëheqjen e tyre? A dëgjoji me të vërtetë gazetari nga të 26 ata arsye që dorëheqja e tyre vinte ngaqë kishin frikë nga hakmarrja e Romëve, apo ky konkluzion ishte vetëm një mendim i tij ose informacion i dorës së dytë që duhet t'i atribuohet një burimi specifik? A kishte një kërcënim real, apo ekzistonte frika mbështetur në stereotipet e Romëve? Përse gazetari nuk kërkoi ndonjë koment nga ndonjë prej punonjësve si edhe nga vetë Romët? Pa to shkrimi ka shumë boshllëqe që të konsiderohet si një përshkrim autoritativ i incidentit.

► Përleshje masive, që i ngjanin një revolucioni, u zhvilluan në pyjet pranë Botevgradit të martën në mbrëmje.

Rreth 50-60 ciganë, të armatosur me sëpata, rojet e pyjeve dhe policinë ushtarake në orën 8.30 të mëngjesit kur kuptuan se miqtë e të afërmit e tyre po kapeshin e po arrestoheshin për prerjen dhe vjedhjen e drurëve.

Kur u shfaqën në vendin e incidentit forcat e policisë ushtarake, ato u përpoqën të largonin burrat Romë duke qëlluar në ajër. megjithatë këta të fundit jo vetëm që nuk ndaluan aktivitetin e tyre, por filluan të shponin gomat e makinës së policisë përballë syve të oficerëve.

Tani paniku ka përfshirë personelin e pyjeve të qytetit, e të gjithë 26 punonjësit paraqitën dorëheqjen e tyre. Ata thonë që të gjithë tremben se Romët do të marrin hak.

24 Hours, Sofje, 29 gusht 2002.

◀ Titulli menjëherë krijon imazhin e frikshëm të burrave Romë që sillen vërdallë me sëpata, mesa duket duke sulmuar policinë pa provokime. E vërteta është shumë më e ndërlikuar.

A kishte secili prej tyre sëpatë? Shkrimi nënkupton që ata kishin. Nëse ishte kështu, atëhere do të mendohej se ndonjë nga autoritetet do të ishte vrarë, ose të paktën do të ishte plagosur rëndë. Meqë gazetari nuk përmend ndonjë të plagosur, atëhere ka gjasa të ishte shumë më pak serioz e i rrezikshëm se sa portretizohet. Edhe motivimi për Romët është konfuz. Cili u arrestua me saktësi? Çfarë bënë ata konkretisht? Çfarë ligji kishin thyer? Ku u dërguan ata? A po mbaheshin të ndaluar? Si e kuptuan Romët e tjerë menjëherë se çfarë po ndodhte?

◀ A do të thotë kjo që ata nuk sulmuan autoritetet, por vetëm makinat e tyre? Po oficerët vetëm qëndruan dhe shihnin ndërkohë që gomat e tyre po shpoheshin? Si përfundoi incidenti?

Ky është një shembull i shkëlqyer si merret një dukuri jo e zakonshme-një fushatë reklamuese që drejtohet tek Romët-dhe kthehet në një shkrim interesant gazetaresk. Gjithashtu ilustron se si është e mundur të shkruhet për Romët në një mënyrë të tillë që nuk përqëndrohet në radhë të parë tek stereotipet ose tek marrëdhëniet e tyre të dobëta me grupet e tjerë sociale dhe etnike.

3. b) **Punonjësit e Radios C ndihmohen të përgatisin një reklamim të drejtuar – Atyre u pëlqen të bëjnë muhabet**

Për herë të parë Matáv i konsideroi Romët si grupin e tij objektiv.

“A dëgjoni, dikush po ju thërret, a dëgjon vëlla, më gje mua, nëse je duke më kërkuar. Më thuaj si je, më thuaj gjithçka mundesh.” Kjo këngë është dëgjuar për tre javë tek Radio C. Në kanalën e radios për dëgjuesit Romë kompania hungareze e telekomunikacionit Matáv reklamoi paketën “Csevegő”.

Sipas Bálint Nagy, drejtor i komunikacioneve të kompanisë, ishte hera e parë në Hungari që komuniteti Romë po futej drejtpërdrejtë në një fushatë reklamuese.

Pyetje. Përse mendon se ishte mirë të reklamohet për Romët?

Përgjigje. Për tri arsye. Flasin për rreth 500,000-700,000 njerëz – konsumatorë, nëse ju pëlqen kështu. Do të ishte gabim të mos merreshin parasysh kaq shumë klientë potencialë. Nga ana tjetër, Matáv duhet të kërkojë ato sektorë socialë e të biznesit në tregun e telekomunikacionit ku mund të ngrejë fitimet e veta dhe këto grupe duhet të afrohen me një strategji reklamimi të drejtuar tek ata gjithnjë në rritje. Romët janë një prej këtyre grupeve objektivë. Së treti, shpresojmë se zakonet e konsumatorëve dhe fuqia blerëse e Romëve do të pasohen edhe nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Py. Nëse zakonet e tyre do të ndiqen edhe nga të tjerët, përse duhet që me ta të merreni në mënyrë të veçantë?

Pë. Ato do të ndiqen, por në këtë moment zakonet e tyre ende nuk janë identifikuar.

◀ Çfarë është paketa Csevegő? Do të ishte mirë të shpjegohej një gjë e tillë për dëgjuesit.

◀ Pretendimi i Nagyt-që kjo ishte hera e parë-mund të jetë i vërtetë, por do të ishte mirë që gazetari të shpjegonte e të përpikëj ta vërtetonte këtë deklaratë. Në çdo ngjarje do të ishte mirë që ky pretendim t'i atribuohet Nagyt, siç bën gazetari.

◀ Do të ishte interesante që gazetari të pyeste veçanërisht si ndryshojnë zakonet e tyre si konsumatorë nga ato të grupeve të tjerë.

Py. Si një popull “jugor” Romëve u pëlqen të flasin më shumë. A është kjo arsyeja përse ju promovuat veçanërisht paketën “Csevegö”?

Pë. Punonjësit e *Radios C* me të vërtetë ndihmuan për të zgjedhur produktin më të mirë të përshtatshëm. gjithashtu parashikuam edhe kartën telefonike, por mësuam që Romët e përdorin atë më pak. Megjithatë ata me të vërtetë komunikojnë më gjatë; ata nuk flasin shkurt. Në rrethet e tyre konsiderohet si jomiqësore kur një diskutim përqëndrohet vetëm në çështjen në fjalë. Konsiderohet si shumë e përshtatshme të flitet edhe për çështje të tjera-për shembull, të pyetet për të afërmit e tyre. Kjo është arsyeja përse menduam që ndoshta ia vlente të rekomandonim Romët për paketën tonë “Csevegö”, që ofron zbritje për telefonat e gjata.

◀ Ky është një vend ku gazetari mbështetet në një stereotip të dalë jashtë mode. Romët mund të duan të flasin, siç shpjegon më poshtë Nagy, por po kështu veprojnë edhe shumë njerëz “veriorë”.

◀ Kjo do të thotë që anëtarët e grupeve të tjera nuk preferojnë të pyesin për të afërmit ose të bëjnë muhabetë të tjera kur flasin në telefon – një nocion që sigurisht nuk është i vërtetë.

Magyar Hirlap, Budapest, 22 qershor 2002.

3. c) Lufta Rome në Szentpal

Në Somogyszentpal, mosmarrëveshja midis Romëve dhe banorëve të tjerë të fshatit duket e pazgjidhshme. Tensioni është i vazhdueshëm. Shumica e njerëzve, veçanërisht nga të moshuarit, tani nuk raportojnë më kur dikush futet në shtëpitë e tyre, sepse ata kanë frikë ta bëjnë një gjë të tillë. Qeveria vendore është përpjekur të kontrollojë situatën, megjithatë deri tani përpjekjet e saj kanë dështuar.

Dr. Sandor Berenyi, kryetari i bashkisë i Somogyszentpal, tha: “Deri tani Romët që banojnë në fshat kanë shkatërruar disa dhjetëra shtëpi boshe; zor se ka ndonjë bodrum ku ata nuk janë futur; ata vazhdimisht vjedhin në kopshte e në pyje.

Autoriteti vendor ka bërë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur situatën. U takua me organizatat kombëtare të minoriteteve etnike dhe gjithashtu i ka kërkuar edhe grupit të kërkimeve etnike të Akademisë hungareze të Shkencave për të hetuar lidhur me gjendjen e Romëve në Szentpal dhe të sugjerojë zgjidhje të mundshme. Gjithçka e kotë—ata vijnë këtu, shikojnë përreth dhe e pranojnë se problemi është shumë më i ashpër se sa çdo gjë që ata kanë parë më parë”, tha Dr. Sandor Berenyi.

“Asnjëri prej atyre që kemi pyetur deri tani mund të na udhëzonte si mund të zgjidhen problemet tona. Tani më shumë se 30% e popullsisë është Rome dhe siguria publike është kaq keq sa i gjithë zhvillimi i ardhshëm është në rrezik. Dhe kjo pavarësisht nga fakti se për ta do të ketë punë në fshat dhe se qeveria vendore shpenzon afro 30 milionë forinta çdo vit për t’i ndihmuar.”

Njerëzit në Somogyszentpal janë përpjekur edhe të krijojnë një “roje civile” për të përmirësuar ndjenjën e tyre të sigurisë. Megjithatë edhe ajo nuk solli ndonjë përmirësim. Pas disa muajsh nuk kishte asnjë që do të pëlqente të patrullonte nëpër rrugë, pasi të gjithë kishin frikë.

◀ Ky titull është keqdrejtues dhe nxitës. Problemi nuk është “lufta” e Romëve, por një konflikt midis Romëve dhe banorëve të tjerë. Titulli paragjykon se kjo situatë është krejtësisht për faj të Romëve—dhe thjesht individë por e gjithë popullsia Rome e fshatit.

◀ Çfarë prove ka për këto? Si mund të jetë ai i sigurt se Romët janë përgjegjës për të gjithë problemet?

◀ Përse gazetari nuk kontaktoi drejtëpërdrejtë me Akademinë hungareze të Shkencave për ta pyetur lidhur me situatën? Përse nuk kontaktoi edhe vetë Romët për të marrë mendimin e tyre?

◀ Çfarë pune do të ketë për ta? Çfarë përpjekjesh janë bërë për t’i ndihmuar ata? Çfarë ndihme marrin ata? Përgjigjet për këto pyetje do ta ndihmonin artikullin.

◀ Përse? Çfarë ndodhi pas disa muajsh? A u sulmua ndokush? Nëse jo, çfarë ndryshoi? Përse në fillim donin të patrullonin dhe jo më pas?

Dr. Sandor Berenyi tha se qeveria vendore vazhdon të kërkojë një zgjidhje të përshtatshme. Megjithatë nëse në periudhën afatshkurtër ata do të dështojnë, ata do të mund të zgjidhin problemin afatgjatë vetë dhe do të dëbojnë nga fshati ato familje që kanë shkaktuar shumicën e dëmeve.

◀ A është ky një problem vetëm me disa familje? Nëse po, përse atëhere gazetari fajëson të gjithë Romët?

Új Néplap, Budapest, 25 janar 2002.

Si shumë artikuj të tjerë të ngjashëm edhe ky është i mbështetur vetëm në një burim, një djalë 11 vjeçar. Ndërkohë që duket se ajo që i ka ndodhur ishte jashtëzakonisht e pakëndshme, gazetari e beson atë krejtësisht duke mos kërkuar ndonjë koment nga një përfaqësues i palës tjetër. Nuk është fjala të vesh në pikëpyetje fjalët e një djali të ri, por të marrësh çdo burim me pak skepticizëm derisa të provohet që ajo që kanë thënë është e vërtetë.

3. d) **Më vunë automatikun në kokë**

11-vjeçari Venhar Rexhepi nga Ljuboten tregon.

Ljuboten vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes, jo vetëm të opinionint publik, por edhe të audiencës së huaj pas gjithë asaj që kaluan banorët e këtij fshati kur forca hakmarrëse e Ljube Boshkovskit terrorizoi njerëzit e pafajshëm vitin e kaluar, duke mos kursyer as gratë, as fëmijët e as të moshuarit. Vrasjet, brutaliteti më i ashpër, plaçkitjet dhe sjelljet e pahijshme të hordhisë policeske-banorët e Ljubotenit i ndjenë ato dhe ende i ndjejnë dhe pasojat e këtyre torturave nuk mund të zhduken nga shpirtërat e të rinjve për një kohë të gjatë.

Rasti i 11-vjeçarit Venhar Rexhepi, të cilin policia e detyroi të shtrihej në tokë duke i vendosur automatikun në kokë, do të hyjë në analet se si kriminelët nuk i zgjedhin viktimat e tyre.

Tani, gjatë këtyre ditëve pranverore kur të gjithë po ndjekin zhvillimet e zhvarrosjes së 10 viktimave, një djalë me flokë të zezë ishte ulur pranë meje. Shokët e tij ishin rreth nesh dhe spontanisht filluan të tregonin përvojën e Venharit. Unë fillova të pyes se çfarë kishte ndodhur.

“Ishte kohë vere,” thotë djali syshqiponjë, “dhe unë do të shkoja të haja drekë tek xhaxhai im që ruante delet. Atje”-ai e drejtoi dorën tek vendi ku kishte ndodhur gjarja. Përmbi fshat ku ishin vendosur policia dhe ushtria-”kur ata vunë re se unë po drejtohesha për nga stallat, më ndaluan dhe pastaj më shtrinë në tokë. Më drejtuan automatikun në kokë dhe në të njëjtën kohë filluan të kontrollonin çantën time ku kisha mbledhur bukë dhe ushqim tjetër për xhaxhain. Meqë nuk gjetën ndonjë gjë të dyshimtë, policët dhe ushtarët më lanë të vazhdoja drejt stallave, por erdhën edhe vetë me mua duke më ndjekur me

◀ Përdorimi i fjalëve të tilla si “jonjerëzore”, “të ashpra” dhe “hordhi” e acaron edhe më shumë gjendjen e krijuar. Do të ishte shumë më mirë të përshkruhej konkretisht me një gjuhë joemoionale se çfarë ndodhi. Do të ndihmonte këtu nëse do të paraqitej një koment nga një psikolog ose specialist traumash lidhur me ndikimin e kësaj situatë ndaj fëmijëve.

◀ Natyrisht që këtu gazetari po bën një gjykim, por kuptimi i kësaj deklaratë është jashtëzakonisht i paqartë.

◀ Në raportimin lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga një grup kundër një tjetri është gjithnjë e rëndësishme që ai të jetë sa më i balancuar të jetë e mundur, të jepet njëfarë konteksti për ngjarjet, dhe të shmangni sa më shumë fjalët nxitëse si ‘terrorizoi,’ ‘brutalitet’ dhe ‘torturë.’ Do të ishte më mirë të përshkruhej sjellja në mënyrë sa më të thjeshtë të mundshme, nga sa më shumë burime që të ishte e mundur, dhe të bëheshin të gjitha përpjekjet për të verifikuar ato që ishin treguar. Gjithashtu është me vend të përfshihet edhe një background informativ, si, për shembull, nëse ka patur kundërukuza për akte keqdashëse nga pala tjetër. Autori i këtij shkrimi nuk e ka bërë këtë.

veturë për të parë nëse ushqimin do t'ia dërgoja luftëtarëve të UÇK-së. Ata," thotë Venhar, "erdhën me mua tek stallat dhe kur panë se atje ishte vetëm xhaxhai im u kthyen në 'bazën' e tyre përmbi fshat, ku ishin vendosur që prej gjashtë muajsh para se të ndodhte tragjedia në Ljuboten."

Kjo nuk ishte hera e parë që Venhar ishte viktimë e hordhive të policisë ushtarake, thanë shokët e tij. Ai ka patur edhe incidente të tjera që kishin shfaqur edhe rrezik për të. Venhar dukej se nuk kishte qejf të fliste edhe për rastet e tjera, por ra dakord me këmbënguljen e shokëve të tij. "Kjo ka ndodhur më parë," tha Venhar, pak i shqetësuar. "Unë," vazhdon Venhar, "po kthehesha nga stallat dhe po sillja pak qumësht në shtëpi dhe xhaxhai kishte ngarkuar në gomar enë me qumësht dhe disa dru për të gatuar. Kur mbërrita në pikën e kontrollit të policisë, ku ishin të vendosur policia dhe ushtria, ata më ndaluan dhe ushtarët më detyruan ta shkarkoja gomarin. Filluan të kërkonin me imtësi edhe tek drutë e zjarrit që i vunë në tokë. Dukej se mendonin se në gomar unë kisha armë dhe meqë nuk gjetën gjë më lanë t'i ngarkoja përsëri në gomar vetë dhe meqë unë kisha vështirësi ata qeshnin me mua, por nuk më ndihmuan fare. I jam mirënjohës Haxhi Reshatit, që në atë moment po kalonte dhe më ndihmoi të ngarkoja gomarin tim dhe të largohem nga sytë e policëve dhe ushtarëve, sepse nëse do të qëndroja edhe më shumë atje diçka kishte për të ndodhur me mua."

Flaka, Shkup, 2002.

Ky është një shembull i mirë i shfrytëzimit të një tragjedie për të nxjerrë në pah një pikë nacionaliste. Artikulli në thelb fajëson nënën për vdekjen e fëmijës së saj për faktin se ajo nuk fliste maqedonisht. Ky incident mund të kishte shërbyer si nxitës për të raportuar e shkruar për një ngjarje të rëndësishme lidhur me komunikimin ndërkulturor-dhe mungesën e komunikimit-dhe rreziqet që dalin kur dy komunitetet detyrohen të bashkëekzistojnë. Në vend të kësaj, gazetari ndjehet i detyruar të verë në dukje pesë-gjashtë herë që maqedonishtja është “gjuha zyrtare” e vendit dhe lejon që burimet e saj të denigrojnë aspiratat e minoritetit shqiptarofolës. Askund në artikull ndonjërit nuk i vjen keq me të vërtetë për vdekjen e fëmijës dhe asnjë nga komuniteti shqiptarofolës nuk është pyetur për mendimin e tij për këtë çështje.

3. e) **Bebja vdes sepse nëna nuk fliste maqedonisht dhe nuk mund të komunikonte me mjekët – Kur nuk flitet gjuha zyrtare**

Pacienti duhet ta dijë se nëse nuk flet gjuhën zyrtare ai e vë veten në rrezik, thotë Dr. Aleksej Duma, President i Dhomës së Mjekëve.

Një fëmijë në gjendje kritike që u soll kohët e fundit në pediatri vdiq për shkak të humbjes së kohës së çmuar ndërkohë që personeli mjekësor po përpiqej pa sukses të fliste me nënën e tij që nuk fliste maqedonisht. Nëna-një shqiptare etnike nga Tanushevci-përpiqej pa sukses të shpjegonte se nga çfarë vuante fëmija. Një grua tjetër shqiptare, që ndodhej aty pranë në atë moment, u përpoq të përkthente, por edhe ajo shpesh tundte kokën. nëna nuk mund të tregonte as adresën e shtëpisë së saj dhe as se ku mund të gjendeshin të afërmit e saj.

Kjo është një prej shumë tragjediave që ndodhin për shkak të pamundësisë së pacientëve për të folur maqedonisht, e cila është gjuha zyrtare e vendit.

Aleksej Duma, president i Dhomës së Mjekëve,

thotë: “Është diçka personale nëse dikush e di gjuhën, por është gjithashtu edhe një domosdoshmëri me qëllim që të marrësh rezultate nga praktika.” Pozicioni i Bashkimit Europian është i njëjtë, sepse kodi i mjekëve është zhvilluar me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë, thotë Duma.

◀ Çfarë është Dhoma e Mjekëve? A mos është OJQ? Një agjenci qeveritare? Gazetari duhet ta identifikojë dhe të shpjegojë funksionin e saj.

◀ Është e paqartë se çfarë do të thotë Duma lidhur me ngjashmërinë e pozicionit të Bashkimit Europian.

“Është problemi i mjekëve nëse ata flasin vetëm gjuhën e disa prej komuniteteve të minoritetit, sepse atëhere ata rrezikojnë të mos kuptohen nga pacienti, por edhe pacienti duhet të jetë i ndërgjegjshëm që në qoftë se nuk flet gjuhën zyrtare të vendit ai e vendos veten e tij në rrezik. Që dikush të tregojë që është qytetar i një vendi duhet të demonstrojë që i përket atij vendi dhe një prej shenjave më të qarta është gjuha,” thotë Duma. Sipas mendimit të tij, është e pakuptueshme që dikush të kërkojë nënshtetësinë nëse nuk flet gjuhën zyrtare. Në Britaninë e Madhe, si edhe në Slloveni, një mjek është i detyruar të përdorë gjuhën zyrtare, shton ai.

Punonjësit e poliklinikës “Bit Pazar” thonë se ata vazhdimisht ndeshen me pacientë që nuk flasin maqedonisht.

“Gratë shqiptare zakonisht vijnë tek mjekët së bashku me burrat, që ndonjëherë na thonë të mësojmë shqipen, sepse gratë e tyre nuk flasin maqedonisht. Ne jemi të detyruar të trajtojmë qytetarët e jo të mësojmë shqipen apo ndonjë gjuhë tjetër, kur të gjithë e dimë se gjuha zyrtare në vend është maqedonishtja,” thotë një punonjësi i poliklinikës.

Bajram Nuredinovski, një specialist i mjekësisë së brendshme dhe pronar i një klinike private në Debar, thotë se ai nuk ndeshet me probleme të tilla.

“Kur fillova të punoja në qendrën mjekësore në Debar 27 vjetë më parë unë nuk flisja shqip, por infermieret më ndihmonin dhe unë komunikojta me pacientët,” thotë ai. Ai vë në dukje se në Debar nuk ka maqedonas që nuk flet shqip dhe anasjelltas.

Sipas Amendamentit të Pestë të kushtetutës maqedonase, gjuha zyrtare në vend është maqedonishtja me alfabetin e saj cirilik. I njëjti amendament thekson se një gjuhë zyrtare në vend flitet nga 20% e popullsisë, por përdorimi i saj drejtohet nga ligje të ndryshme.

Pozicioni i tij për çfarë konkretisht? Nëse pacientët duhet të flasin gjuhën e mjekëve? Thjesht pse mjekët maqedonas janë konsultuar me ata të Bashkimit Europian për zhvillimin e kodit të sjelljes nuk do të thotë në asnjë mënyrë se politikat që ata kanë përcaktuar janë të njëjta. Kjo duket se është një shembull i gazetarit që i lejon Dumas të thotë çfarë të dojë pa bërë disa pyetje të qarta.

Çështja e nënshtetësisë duket se është jashtë pikës që diskutohet këtu. Çështja është si të garantohet që të gjithë njerëzit të marrin kujdesin dhe trajtimin e duhur shëndetësor pavarësisht nga etnia apo gjuha që flasin. Kur ngre pyetjet e të provuarit të etnicitetit, Duma del si jashtëzakonisht jodashmirës dhe pa dëshirë për të kërkuar mënyra për zgjidhjen e problemit. Në fakt në Britaninë e Madhe si edhe në vendet e Bashkimit Europian spitalet që në mënyrë rutinë trajtojnë njerëz të popullsisë të ndryshme të minoritetit shpesh kërkojnë të punësojnë anëtarë nga këto komunitete të cilët mund të komunikojnë me pacientët.

Këta punonjës, thotë Duma, ndeshen pak a shumë pa ndjenja me vështirësinë e njerëzve që duhet t'i trajtojnë. Gazetari duhet të kishte hulumtuar ndonjë hap të ndërmarrë nëse ndonjëri ishte përpjekur për t'u marrë me këtë problem, si për shembull të punësonte mjekë me dy gjuhë ose edhe shqiptarë etnikë.

Është mirë që gazetari përfshiu edhe Nuredinovskin, që jep një mendim pak a shumë të ndryshëm. Natyrisht disa profesionistë janë me dy gjuhë dhe e kanë njohur rëndësinë e të mësuarit si të komunikojnë me pacientët që nuk flasin maqedonisht dhe nuk i janë përmbajtur të mendimit që ata (pacientët) nuk kanë të drejtë të presin nënshtetësinë për shkak të mungesës së gjuhës.

Nëse ky amendament është i vërtetë, a do të thotë se edhe shqipja është gjuhë zyrtare? Natyrisht edhe gjuhët e tjera mund të njihen si zyrtare. Kjo minon kushtet e nenit të sipërpërmendur, që do të thotë se shqiptarët që kërkojnë kujdes shëndetësor duhet të mësojnë të flasin maqedonisht. Do të ndihmonte shumë artikullin nëse gazetari do të jepte informacion tjetër lidhur me të drejtat e garantuara për ata që flasin gjuhët e minoriteteve në Maqedoni.

Nesër Ministria e Drejtësisë do të rishqyrtojë versionet e punës të disa prej ligjeve ndihmës kryesorë që merren me përdorimin e gjuhëve të komuniteteve të minoriteteve.

Dnevnik, Shkup, 2002.

Konkretisht çfarë ligjesh do të rishikojë ministria? A do të kenë ato ndonjë ndikim në rezultatin e një situatë si ajo e përshkruar në këtë artikull? Përse janë duke u rishikuar? Cili është afati i vendimeve ose i rezultateve që ngrihen nga ky rishikim? Kjo deklaratë është tepër intriguese, por edhe aq e mjegullt sa që lexuesit praktikisht nuk i jep ndonjë informacion shtesë.

Ky artikull është një shembull i mirë se si kërkohet komenti në një ndarje etnike, por në të njëjtën kohë ai nuk mundet të japë komente politike kundërshtare. Gazetari përfshin dëshmitë e studentëve rumunë dhe hungarezë që kritikojnë vendimin për të ndarë shkollat sipas gjuhëve, por nuk lejon që udhëheqësit politikë dhe arsimorë që mbrojnë vendimin e tyre.

3. f) Nxënësit kundërshtojnë ndarjet etnike

Bukuresht – Nxënësit në shkollën e mesme të përzier etnikisht Bolyaj Farkas, nga fshati rumun Targu Mures, dhanë një leksion të vërtetë duke nxitur autoritetet vendore dhe prindërit e tyre të jenë tolerantë: ata nuk pranuan të pranonin një vendim që mësimet të zhvilloheshin ekskluzivisht në hungarisht gjatë këtij viti shkollor, duke nënkuptuar që nxënësit me etnicitet rumun të shkonin në një shkollë tjetër.

“Nuk duam të ndjehem si i huaj në vendin tim,” thotë Ioan Pop, 16 vjeç, rumun, ndërkohë që shoqja e tij e klasës, Verestoy Erica, 17 vjeç, hungareze, mendon se e drejta për shkollim në gjuhën e nënës për dikë mund të jepet nën një çati të vetme, me lëndën mësimore të tanishme.”

“Asnjëri nuk mund të më thotë përse shokët e mi duhet të dalin nga shkolla vetëm sepse ata janë rumunë. Ne nuk kemi patur një incident të vetëm në shkollë, as i kemi kushtuar vëmendje nëse dikush është rumun apo hungarez. Dhe çfarë do të arrijmë duke e kthyer shkollën vetëm në njëgjuhëshe hungareze? A do të mësojmë më shumë?” pyet Erica.

Si nxënësit rumunë ashtu edhe ata hungarezë janë kundër vendimit për ta kthyer shkollën e tyre ekskluzivisht vetëm në hungarisht dhe protestuan për ditë me radhë duke i detyruar autoritetet të shtyjnë ndryshimin deri në fund të vitit. Protestat shkaktuan reagime dhe ndarje në mbarë vendin, duke provokuar edhe një mosmarrëveshje midis Partisë Social Demokrate në fuqi dhe aleates së saj të vetme politike në parlament, Aleancës Demokratike të Hungarezëve në Rumani.

Gjithçka filloi kur u konkludua një protokoll bashkëpunimi në nivel vendor midis dy partive në Targu Mures. Marrëveshja, që u pranua menjëherë nga autoritetet vendore të arsimit,

◀ Ky është një titull efikas sepse përcakton qartë, pa emocionalizëm të theksuar, pikën thelbësore të shkrimit.

◀ Si protestuan ata? Si u shfaqën ndarjet kombëtare? A pati protesta edhe në shkolla të tjera? Veç kësaj, shkrimi nxjerr sikur çdo student ishte kundër propozimit, por sigurisht që disa ishin në favor të tij. Nëse po, përse? Edhe ata duhet të kenë të drejtë të shfaqin mendimin e tyre.

◀ Kjo duket sikur ishte një vendim vendor, por më pas shkrimi tregon se e njëjta politikë do të ndiqej në të gjithë vendin. Pra, si është?

parashikonte që shkolla e mesme etnikisht e përzier Bolyaj Farkas të fillonte vitin e ri shkollor si një objekt mësimor vetëm në gjuhën hungareze. Gjithashtu u planifikua edhe që klasat e tjera rumune të zhvendoseshin në dy shkolla të tjera të mesme që do të ishin ekskluzivisht në rumanisht. Meqë edhe dy shkollat e tjera janë të përziera, klasat e gjuhës hungarishte prej tyre do të transferoheshin në shkollën Bolyaj Farkas.

Në fillim vendimi u kundërshtua nga nxënësit rumunë. Megjithatë shpejt me ta u bashkuan edhe kolegët e tyre hungarezë, të cilët gjithashtu nuk arrinin të kuptonin përse shokët e tyre nga e njëjta shkollë tani duhej të largoheshin në një ndërtesë tjetër. Kështu nxënësit e shkollës së mesme Targu Mures së bashku refuzuan të ishin viktimat të një marrëveshjeje ndërpartiake.

Protestat alarmuan shkollën si edhe autoritetet politike.

Politikanët në fillim u përpoqën të shpjegonin arsyet e vendimit të tyre. Por nxënësit kundërshtuan të gjitha shpjegimet dhe me vendosmëri kundërshtuan ndarjen etnike të planifikuar.

Problemi doli përtej shkollës dhe tërhoqi vëmendjen e opinionit publik rumun e madje edhe nga presidenti Ion Illiesku dhe kryeministri Adrian Nastasse, të cilët bënë deklaratat lidhur me këtë çështje. Presidenti Illiesku tha se nxënësit kishin të drjetë dhe se një shoqëri demokratike shumëkulturore dhe shumëetnike nuk mund të ndërtohej me sukses me ndarjen e njerëzve në geto etnike.

Megjithatë Aleanca Demokratike e Hungarezëve në Rumani këmbënguli që protokoli për ndarjen e shkollave e të nxënësve duhej të respektohej.

U arrit një kompromis që parashikonte që të gjithë nxënësit të regjistruar në shkollat e përziera etnikisht do të përfundonin shkollën ku e filluan, pas presionit të madh nga nxënësit dhe nga publiku. Pas protestës publiku ishte më i dhënë të mendonte se e drejta për arsimim në gjuhën amtare nuk nënkupton ndarjen etnike të shkollave e të nxënësve.

◀ Si u alarmuan ato? Përse nuk citohet asnjë prej tyre?

◀ Përsëri, shkrimi duhet të ketë deklarata nga partitë politike ose nga zyrtarët vendorë lidhur me faktin përse e arritën atë marrëveshje. Në qoftë se shkrimi nuk përfshin këto deklarata është e vështirë që lexuesit të përcaktojnë nëse ndonjë prej tyre kishte kuptim apo jo.

◀ Kjo do të ishte më efektive me një citim të drejtëpërdrejtë nga presidenti. Për shembull, në perifraksim, gazetari përdor fjalën “geto,” që mund të ketë kuptime të posaçme kulturore dhe historike. Por nuk është e qartë nëse presidenti e përdori këtë fjalë apo u shpreh në një gjuhë jo kaq të ashpër.

◀ Përsëri, cila është logjika e saktë e partisë lidhur me këtë protokoll? Do të ishte mirë të bëhej e ditur një gjë e tillë.

◀ Mbi çfarë baze ka përcaktuar gazetari që publiku ka ndryshuar mendje? A mbështetet kjo në anketime, të dhëna anekdotike, apo thjesht në një mendim të tij personal? Nuk na jepet informacion i mjaftueshëm për të gjykuar.

Pavarësisht nga kjo, nuk ka patur ndryshime në politikën e regjistrimit. Nxënësit e etniciteteve rumune e hungareze do të drejtohen në ato shkolla ku mësimet do të zhvillohen në një nga dy gjuhët e tyre. Në Rumani, në përputhje me rregullat e BE-së, ka tashmë shkolla ku mësimet zhvillohen vetëm në gjuhët e minoriteteve. Kështu, tani ekzistojnë 55 shkolla ku mësimi zhvillohet në hungarisht, gjermanisht, serbisht dhe në gjuhë të tjera të pakicave.

Jula Ilona, 18 vjeç, hungareze, pyet si është e mundur që njerëz të rritur të mbështesin një “çati të vetme europiane” për të gjithë vendet dhe popujt në kontinent, ndërkohë që në të njëjtën kohë kundërshtojnë një “çati të përbashkët” në shkollën e mesme Bolyaj Farkas. Kontradikta të tilla, sipas shokut të saj të klasës, Aurel Neamtu, 18 vjeç, rumun, do të vazhdojnë derisa brezat më të rinj do të marrin përsipër drejtimin në vendet e tyre, në mbarë Europën. Protesta tregoi gjithashtu se të rinjtë janë aq të fortë sa të kundërshtojnë vendimet e dëmshme e pa kuptim të politikanëve.

◀ Përsëri, është jashtëzakonisht e dobishme të përfshihen citime nga studentë të të dy etniciteteve. Por gazetari e mbyll duke iu referuar “vendimeve të dëmshme e pa kuptim” të politikanëve duke mos i dhënë lexuesve informacion që do ta ndihmonte të gjykonte të vërtetën e asaj deklaratë.

Beta/MDI, Beograd/Londër, 3 shtator 2002.

3. g) Romët si bizelet, të tjerët i shesin si lëng

Ushqimi në kuzhinën e ndihmës në Smederevo është bërë objekt tregtie.

▲
Titulli menjëherë bën të ditur se është një artikull kundër Romëve, por vetë artikulli ofron pak të dhëna për të mbështetur këtë pretendim dhe nuk jep përgjigje, reagim nga vetë Romët.

► Si e di ai këtë? Cili ia ka dhënë këtë informacion? A ndodh kjo gjithnjë, apo ai po e zmadhon thelbin e problemit me qëllim që të denigrojë Romët?

► Nëse kjo ndodh kaq shpesh, përse Kryqi i Kuq nuk është në gjendje të identifikojë ata persona?

Smederevo – Ankesat lidhur me cilësinë e ushqimit në kuzhinën e ndihmës në Smederevo i janë adresuar organizatës së Kryqit të Kuq të qytetit dhe përqëndrohen kryesisht në menunë acaruese, gjë që ka çuar në një lloj tregtie të pazakontë e tepër të çrregullt.

Radmila Brankovic, sekretare e organizatës së Kryqit të Kuq, shpjegon që rumunët u shesin fermerëve që merren me derra ushqimin që marrin si ndihmë humanitare.

“Romët hanë fasule, kurse gjithë ushqimet e tjera me makarona, që ofrohen më shpesh, shiten nëse kanë përm-bajtje të tillë si peshk.

“Më e rëndësishmja për ta është të marrin bukë. Ata persona që janë në disavantazh shoqëror nuk mund të marrin bukë nëse nuk marrin edhe një ushqim të gatuar”, na tha Radmila Brankovic.

Mësuam që njerëzit e përfshirë në këtë tregti do ta humbasin të drejtën për kuponat e ndihmës nëse punonjësit e Kryqit të Kuq do të mund t'i identifikojnë.

Kryqi i Kuq nuk mund të kujdeset për nevojat e të gjithë njerëzve që duan ta përdorin kuzhinën dhe, në këtë mënyrë, ndihma do të mund t'i arrinte ata që me të vërtetë kanë nevojë për të.

Blic, Beograd, 20-21 janar 2001.

◀ Është e paqartë se çfarë ankesash ka për cilësinë e ushqimit dhe si lidhet ajo me çështjen se çfarë shesin Romët. Në fakt gazetari nuk i kthehet më çështjes së ushqimit të dobët, gjë që shpjegon përse e shesin Romët e jo që e përdorin ata për ushqim.

◀ Nëse kjo është e vërtetë, ndoshta ata po e shesin ushqimin që të mund të blejnë diçka më të mirë për veten e tyre. Një pyetje e goditur që duhet të bënte gazetari është nëse Kryqi i Kuq jep atë lloj ushqimi që shumica e atyre që e përdor e pranojnë. Nëse jo, përse?

◀ Kjo sugjeron që Romët nuk kanë nevojë për ndihmë dhe se, në fakt, është faji i tyre që familje të tjera nuk marrin një gjë të tillë. Efekti është të rritet pakënaqësia që ndjejnë familjet e tjera ndaj Romëve.

Humori i kësaj barcalete merr shkas nga stereotipet klasike të Romëve. Duke bërë kështu, ajo sugjeron se nënat Rome jo vetëm që dëshirojnë t'i përdorin fëmijët e tyre të gjenerojnë simpati duke lypur, por edhe se ato duan t'i shesin ata për një shumë të mirë. Pra, shakaja shfrytëzon një situatë tragjike për të përforcuar paragjykimin kundër një grupi të tërë etnik. Ka shumë faktorë ekonomikë e kulturorë që i shtojnë disa Romë të merren me lypje, por një arsye që ata marrin edhe fëmijët me vete është se ata mendojnë se është skandaloze që nënat t'i lenë ata në vende ku ka persona që kujdesen pa qënë i pranishëm një pjesëtar i familjes për t'i mbrojtur.

3. h) Barcaletë

Dobriila

Një burrë del nga një ndërtesë dhe takohet me një grua cigane me një fëmijë të vogël.

“Je i mirë zotni, më jep pesë dinarë për Dobrilan e vogël,” lyp ajo.

“Zhduku,” i përgjigjet ai me zemërim.

Ditën tjetër në të njëjtën kohë ai del nga ndërtesa dhe ndeshet me të njëjtën grua cigane me të njëjtin fëmijë...

“Je i mirë, zotni, më jep pesë dinarë për Dobrilan e vogël,” lyp ajo përsëri.

Burri ndjeu keqardhje dhe i dha një pesë dinarsh.

“Ja, merre Dobriila,” tha ciganja, duke ia dhënë fëmijës.

Publika, Podgoricë, 22 dhjetor 2001.

4. Feja

Mosmarrëveshjet fetare mendohet se kanë çuar në konflikt, në Europën juglindore si edhe në mbarë botën, si paragjykime etnike. Në fakt është e vështirë të dallosh midis këtyre të dyjave, sepse palët ndërluftuese janë, mjaft shpesh, pjesëtarë të feve të ndryshme. Në Kosovë, për shembull, a ka tensione midis serbëve dhe shqiptarëve mbështetur në etnicitetin ose fenë? Të ndash këto të dyja është shumë intriguese. Pa dyshim, përgjigja është që të dy faktorët luajnë rolin e tyre.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për anti-semitizmin. Urrejtja për izraelitët natyrisht ka komponentë fetarë dhe etnikë. Izraelitët shpesh konsiderohen si pjesëtarë të një race jashtëtokësore, të cilët përcaktohen nga disa stereotipe të personalitetit dhe të fizikut, si hunda me kurriz dhe mundësia për të fituar para në mënyra që mund të vihen në dyshim. Në të njëjtën kohë, anti-semitët gjithnjë e kanë tallur judaizmin si fe dhe kanë përhapur thashetheme për praktikat dhe bindjet e asaj feje, si nocioni se izraelitët kërkojnë bebe të krishtera për t'i sakrifikuar.

Situata në Europën juglindore është bërë më e ndërlikuar në vitet e fundit përse i përket fesë. Jo vetëm ish-shoqëritë e mbyllura më parë janë duke u përpjekur të ruajnë një ndjenjë bashkësie midis anëtarëve të grupeve fetare që është vendosur prej kohësh në rajon, por misionarët që mbërrijnë nga perëndimi e që kërkojnë të kthejnë njerëzit në tradita të tjera shpirtërore e kanë ndërlikuar edhe më shumë këtë pamje.

Më poshtë po japim disa sugjerime se si të shkruhet për fenë në një mënyrë të tillë që do të ndihmojë tolerancën e jo konfliktin:

★ Për të identifikuar dallimet në mbulim, shihni prapa se si është marrë institucioni juaj i medias me çështjet e dasive fetare në qytetin apo rajonin tuaj. A ka patur ndonjë material që përfshinte edhe perspektivën e atyre që nuk janë pjesë e fesë mbi-zotëruese? Kur është shkruar për fetë e tjera, a ka qënë paraqitja e drejtë dhe e balancuar, apo janë paraqitur stereotipe që kanë pak lidhje me realitetin?

★ Kur shkruhet për fenë, kushtojini vëmendje gjuhës që përdorni për të përshkruar njerëzit. Ju mund të mos i mendoni se disa fjalë janë fyese, por ato mund të jenë shumë lënduese për anëtarët e grupit për të cilin po shkruani. Nëse nuk jeni i sigurt nëse një fjalë është fyese, sigurohuni për të para përdorimit.

★ Gjeni kohë për të gjetur fe të reja në rajonin tuaj. Qëndroni një ditë me misionarët mormonë ose me Dëshmitarët e Jehovait. Vëzhgoni kontaktet e tyre me njerëzit me të cilët ata flasin dhe përpiqen t'i kthejnë besimin fenë. Nuk është e nevojshme që ju të ndani të njëjtat bindje me ta me qëllim që ta raportoni saktë dhe me dashamirësi.

★ Shkruani për ligjet që drejtojnë fenë në rajonin tuaj. A i ofron privilegje shteti besimit mbizotërues dhe e diskriminon përkundrejt të tjerëve? Nëse të gjithë fetë supozohet se duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga ligji, a veprojnë në këtë mënyrë autoritetet, apo ato ende favorizojnë traditat e veta shpirtërore?

★ Jini të kujdesshëm që të mos përsërisni stereotipet e zakonshme për njerëzit e feve të tjera. Kur është fjala për fenë shumë të ashtuquajtur “ekspertë” do të thonë gjithçka që duan për traditat e tjera shpirtërore pa e ndjerë që duhet të vërtetojnë deklaratat e tyre me fakte. Për shkak se gazetaret shpesh kanë të njëjtat paragjykime, ata duhet që të kujtojnë veten që detyrë e tyre është t’i sfidojnë këto deklaratat e jo t’i pranojnë ato pa i pyetur më tej.

★ Zbuloni nëse ndonjë universitet në zonën tuaj ka departamente për studime fetare. Nëse po, kultivojini profesorët e tyre si burime të mundshme. Nëse ata kanë bërë një ekspertizë të vërtetë në më shumë se një traditë shpirtërore, ata mund të jenë personat e përshtatshëm që t’i përgjigjen pyetjeve të vështira për marrëdhëniet ndërfeetare.

★ Kujdes me burimet që i mbështesin argumentet e tyre për tema fetare në citime nga Bibla, Kurani, apo tekste të tjerë të shenjtë. Ekzistojnë gjithnjë mospërputhje të ligjshme në interpretimet e fjalëve të shkruara shumë shekuj më parë. Kjo është arsyeja, për shembull, përse ka kaq shumë përcaktime të krishtera, ose tradita islamike që ndryshojnë shumë nga njëra tjetra. Nëse një politikan kërkon të përdorë një tekst fetar si bazë të politikës së tij publike, kërkonte se si e interpretojnë të tjerët të njëjtin tekst dhe bëjini politikanit pyetje të ashpra lidhur me të.

★ Çështjet fetare gjithnjë lidhini me kuadrin e zhvillimeve ose rrymave ekonomike, politike e shoqërore. Për shembull, nëse papunësia ndër anëtarët e një grupi fetar është e lartë, kjo gjë mund të pasqyrojë kohë të vështira për biznesin në përgjithësi e jo thjesht për atë grup. Nëse një fe e re duket se po tërheq shumë besimtarë, kërkonte se çfarë po i ofron njerëzve nga ajo që atyre u mungon.

★ Kur shkruani artikuj keni parasysh nëse stereotipet standart pasqyrojnë realitetin dhe nëse po, përse është një gjë e tillë. Për shembull, është e vërtetë që historikisht izraelitët kanë punuar në mënyrë specifike si huadhënës, sepse profesionet e tjera kanë qënë të mbyllura për ta, një situatë që sigurisht ka përforcuar përshtypjen se ata kanë qënë shumë të dhënë ose të paktën kanë ditur ta administrojnë paranë.

★ Shkruani për ditët e festive të traditave të tjera fetare njëlloj si të shkruanit për fenë tuaj. Merrni pjesë një një meshë, shërbim, apo lloj tjetër akti fetar, për shembull. Kalojeni ditën me myslimanët që mbajnë ramazan.

★ Mos e trajtoni një anëtar të një grupi fetar si përfaqësues të të gjithë atyre. Fakti që një budist mediton përballë diellit nuk do të thotë që të gjithë bëjnë të njëjtën gjë. Secili person është një individ dhe duhet të lejohet të shprehë mendimet dhe idetë e veta individuale. Cilido mund ta trajtojë besimin e tij në një mënyrë pak të ndryshme.

★ Kur intervistoni njerëz të besimeve të ndryshme, mos merrni me mend se jeta e tyre fillon e mbaron me fenë e tyre. Bëjini pyetje edhe për fusha të tjera të jetës. Ashtu si edhe ju që keni nevoja, shqetësime, probleme dhe gëzime që nuk kanë të bëjnë fare me besimin tuaj, po ashtu janë edhe ata. Pyetini ata për familjet, interesat, profesionet dhe aspektet e tjera të jetës së tyre. Nuk është e thënë që do të përfshini gjithçka, kuptohet, por kjo do të ndihmonte që të kuptoni më mirë perspektivën e tyre.

Raste për studim

Ky artikull është një shembull i shumë të tillëve anti-muslimanë e të dhunshëm që dolën në shtypin amerikan pas 11 shtatorit 2001. Meqë ai është shkruar si një artikull opinion e jo si një raportim, nuk është çudi që autorja do të shprehë këndvështrimin e saj. Por të jesh një gazetar që shkruan opinione nuk do të thotë se ke të drejtë të shpërfillësh gjithë normat e civilizimit. Toni agresiv dhe ekstremist e bën këtë pa dyshim një shembull të gjuhës së urrejtjes-edhe duke marrë parasysh tmeririn e sulmit terrorist. Autorja, një gazetare dhe komentatore e djathtë, sigurisht që nuk përpiqet fare të paraqesë ndonjë bazë që do të shpjegonte ose do të jepte prapaskenën e nevojshme që qëndron prapa armiqësisë muslimane ndaj perëndimit në përgjithësi dhe SHBA-së në veçanti.

4. a) Kjo është luftë: Duhet të pushtojmë vendet e tyre

Barbara Olson qëndroi e qetë. Në hysterinë dhe terrorin e ushtruar nga rrëmbyesit e avionit që i shtynin pasagjerët në fund të aeroplanit, ajo nxori telefonin e saj celular dhe u lidh me burrin, Ted, prokuror i përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara. I tha atij që do të bënte mirë të lidhej me FBI-në se aeroplani ishte rrëmbyer. Sipas njoftimeve, Barbara ishte ende në telefon duke folur me Ted kur aeroplani u rrëzua në një shpërthim me flakë drejtëpërdrejtë e në Pentagon.

Barbara rrezikoi që t'i ikte edhe koka duke paralajmëruar vendin për një sulm terrorist. Ajo ishte patriote deri në minutën e fundit.

Kjo nuk është një përpjekje për t'u përfshirë në deklaratat e tepruara të medias për cilindo që është viktimë e një tagjedie të tmerrshme. Thirrja nga telefoni celular ishte një akt i një guximi tejet të madh. Nëse nuk do të kishte ardhur ajo telefonatë, do të kishim dëgjuar raportime nga njëqind thirrje të tjera nga telefonët celularë. (Edhe njerëzit që thonë se i urrejnë telefonat, përsëri i marrin ata me vete në udhëtimet në ajër.)

Hera e fundit që unë e takova Barbarën ishte tre javë më parë. Ajo me shumë bujari vlerësoi një nga kolonat e mia të fundit dhe më tha se me të vërtetë kisha gjetur atë pikën kyçe. Ted, më tha ajo, ia lexonte kolonat e mia me zë të lartë gjatë mëngjesit.

E përmenda këtë për të thënë tre gjëra për Barbarën. Së pari, ajo ishte me të vërtetë e këndshme. Shumë njerëz në television duken të këndshëm, por në të vërtetë nuk janë të tillë. (Dhe disa që nuk

◀ Barbara Olsen ishte një shkrimtare e shquar konservatore dhe vëzhguese politike që shpesh dilte në emisione televizive për të mbështetur Presidentin Bush. Ted, bashkëshorti i saj, është një zyrtar i shquar në administratën e Bushit.

◀ Në fakt, brenda pak ditëve që nga thirrja e telefonit celular u bë e qartë se shumë nga pasagjerët në katër avionet e rrëmbyer i përdorën telefonat e tyre celularë për t'u lidhur me të afërmit e tyre.

◀ Kjo shprehje e vlerësimit për veten nuk shërben aspak për të mbështetur argumentin e autores. Në fakt merret kaq shumë me veten sa të largon vëmendjen nga pikat që përpiqet të të japë në shkrim.

duken të këndshëm, në të vërtetë janë.) Por Barbara ka qënë gjithnjë shumë e këndshme, e dashur, entuziaste. “E këndshme” është një fjalë me disa cilësi të rralla ndërmjet shkrimtarëve. Në biznesin e opinioneve, urrejtja xheloze dhe e thartë është një normë. Barbara kishte arsye përse ishte e sigurt.

Së dyti, praktikisht ishte e lehtë të imagjinoje Tedin duke lexuar kolonat politike me zë të lartë për Barbarën në tryezën e mëngjesit. Marrëdhënia e tyre ishte e tillë që mund të imitohej lehtësisht nga Bill dhe Hillary, dhe kjo e fundit ishte subjekti i librit shumë të shitur therës të Barbarës “Djall për të Paguar”. Hillary pretendoi me mendjemadhësi në intervistën në revistën *Talk* që ajo diskutonte për politikën me Billin ndërkohë që hanin mëngjesin. Ted dhe Barbara flisnin me të vërtetë për politikë dhe me të vëretetë hanin mëngjesin së bashku.

Këtu është “Ted she Barbara” ashtu si edhe Fred e Ginger, dhe George e Gracie.

Ata ishin në mënyrë kaq perfekte së bashku, gjë që dukej kaq shumë, sa që miqtë e tyre ishin aq të gëzuar sa edhe ata vetë në ditën e dasmës. Kjo është diçka më shumë se cdekja e një personi të madh apo e një amerikani patriot. Është një shkëputje e një pjese njerëzore.

Së treti, komplimenti i Barbaras, se unë i kam shkruar kolonat e mia për Ted e Barbara. Unë gjithnjë i shkruaj dikujt në kokën time. Tani unë nuk di se për cilin të shkruaj. Ted-e-Barbara ishin një muzë e mirë.

Veç asaj që do të thotë që kjo dritë e bukur është zhdukur nga bota, vetëm një lajm tjetër shkon më tej tmerrit tepër mbresëlënës të gjithë asaj dite. Atë mbrëmje CNN raportoi se bomba po hidheshin në Afganistan dhe pastaj e pasuroi raportin duke thënë se ato nuk ishin bomba.

Ato duhej të ishin tonat. Unë do të doja që ato të ishin tonat.

Nuk është koha për të vlerësuar vendin se ku ndodhen saktësisht individët që u morën drejtpërdrejtë me sulmin terrorist. Përgjegjësit mund të jenë kudo në botë duke buzëqeshur për poshtërimin e patriotëve si Barbara Olson.

Nuk kemi nevojë për investigime të gjata të provave faktike për të përcaktuar me saktësi shken-core personin ose personat që urdhëruan këtë sulm të veçantë. Nuk kemi nevojë për “koalicionin

Ka qënë një artikull shumë i besuar ndërmjet konservatorëve se martesja e Bill dhe Hillary Clinton ishte më shumë me ambicje më të mëdha të përbashkëta politike dhe për karrierë se sa mbështetje në dashuri ose afekcion për njëri tjetrin. Të kthesh Clinton-ët në diskutim këtu duket më shumë si një funksion i një obsesioni me ta se sa një mënyrë për të çuar më tej argumentin.

Aktorët valltarë Fred Astaire e Ginger Rogers bënë shumë filma së bashku në vitet 1930-të. George Burns e Gracie Allen ishin një ekip popullor i komedisë televizive në vitet 1950-të. Të krahasosh këta çifte jashtëzakonisht të famshëm e të talentuar me Barbara e Ted Olsen është një pretendim kaq i ekzagjeruar sa që ngre dyshime serioze mbi besueshmërinë e autores.

Përsëri kjo lloj dëshire për luftë, që ishte një reagim i zakonshëm amerikan ndaj sulmeve terroriste, është një shembull i qartë se si vepron ndonjëherë media për të nxitur opinionin publik e jo për të kërkuar zgjidhje të ligjshme.

ndërkombëtar.” Nuk na duhet një studim për “terrorizmin.” Sigurisht që nuk na duhet një rezolutë e Kongresit për të dënuar sulmin këtë javë.

Kombi është pushtuar nga një kult vrastar fanatik. Dhe ne i mirëpresim ata. Jemi aq të mirë e aq të pastër sa nuk përfshihemi asnjëherë në profilizim diskriminues racial ose “fetar”.

Njerëzit që duan që vendi ynë të shkatërrohet jetojnë këtu, punojnë për linjat tona ajrore, dhe i nënshtrohen të njëjtit kontroll në aeroport si edhe një punëtor nga Idaho. Kjo është njësoj sikur të kishim Vehrmahtin të emigronte në Amerikë dhe të punonte për linjat tona ajrore gjatë Luftës së Dytë Botërore. Me përjashtimin që Vehrmahti nuk ishte kaq i etur për gjak.

“Gjithë jetët tona” nuk është e nevojshme të ndryshojnë siç vazhdojnë të predikojnë në televizion. Çdo herë që ka një sulm terrorist ose një rrëzim aeroplani për shkak të një gabimi të pilotit amerikanët lejojnë që të drejtat e tyre të shtrëngohen për asnjë qëllim.

Teatri që luhet në aeroport me magnetometrat, pyetjet e kota nëse pasagjerët i “kanë paketuar bagazhet” dhe mezmorfat armiqësore që shqyejnë bagazhin tonë në njëfarë mënyre lejuan një dyzinë rrëmbyes avioni të hyping në katër aeroplanë amerikanë në të njëjtën kohë të Martën e Përgjakshme. (A ndaluan atë ditë këto procedura të famshme të sigurisë një rrëmbyes të vetëm diku në Amerikë?)

Aeroportet në mënyrë skrupuloze zbatojnë të njëjtin ngacmim joefikas qesharak si si për Suzy Chapstick ashtu edhe për rrëmbyesit myslimanë. Është absurde të mendosh se cilido pasagjer është një maniak potencial vrastar i çmendur. E dimë që ka maniakë vrasës. janë pikërisht ata që po gëzojnë e vallzojnë pikërisht tani.

Duhet t’i pushtojmë vendet e tyre, të vrasim udhëheqësit e tyre dhe t’i shndërrojmë ata në të krishterë. Nuk ishim të saktë për të lokalizuar e ndëshkuar vetëm Hitlerin dhe oficerët e tij të lartë. Ne i mbuluam qilizëm me bomba qytetet gjermane; ne vramë civilë. Ajo është luftë. Edhe kjo është luftë.

National Review, Universal Press Syndicate, Washington D.C. 13 shtator 2001.

◀ Ajo përdor sarkazëm për të kritikuar njerëzit që janë kundër profilizimit racor, gjë që është një largim nga kjo paraqitje e veçantë etike për shkaqe sigurie. Natyrisht kjo shkel idealin amerikan të trajtimit të barabartë para ligjit.

◀ Pavarësisht nga sulmet e 11 shtatorit, vështirë të pranosh dikë që kërkon të ulë tonin për etjen për gjak të Vehrmahtit.

Çka synon të thotë ajo ka të bëjë me faktin që cilido në Shtetet e Bashkuara që duket se mund të jetë arab ose mysliman duhet të trajtohet si fajtor përderisa nuk provohet se është i pafajshëm, por kujtdo tjetër duhet t’i jepet lejkalimi. Autorja sigurisht që ka harruar se ShBA ka edhe terroristë në gjirin e vet, apo “maniakë vrastarë,” si ai që vendosi bombë në Oklahoma, Timothy Mc Veigh.

Vështirë të mendohet se sa seriozisht duhet të merret ajo që thotë. A mendon me të vërtetë se duhet t’i pushtojmë e t’u ndërrojmë fenë? Nga toni duket sikur e thotë me të vërtetë. Natyrisht ajo që po mbështet nuk do të thotë vetëm të largohen terroristët përgjegjës për sulmet, por kryerja e një sulmi të gjerë në të gjithë fenë dhe civilizimin, që sigurisht do të shkelte ligjin ndërkombëtarë.

Ky është një shembull i mirë i medias që lejon një udhëheqës fetar të dënojë një kategori të tërë njerëzish me termat më të ashpër pa i ofruar anëtarëve të këtij grupi një mundësi për t'u përgjigjur. Mitropoliti ka të drejtë të shprehë mendimin e tij, por njerëzit homoseksualë kanë gjithashtu të drejtë t'i përgjigjen akuzave kundër tyre.

4. b) Mitropoliti Dënon Homoseksualitetin

Cetinje – Mitropoliti i Malit të Zi e Littoral, Amfilohije, tha se në Malin e Zi homoseksualiteti konsiderohet “më i turpshmi” i gjërave. Homoseksualiteti është diçka “që ne malazezët gjithnjë i jemi shmangur ta mendojmë, e jo më për të folur për të,” deklaroi ai në programin “Fëmijët e Apokalipsit – Fëmijët e Zbulimit,” të transmetuar nga Radio Svetigora me rastin e botimit të një fotografie të një “akti të hapur homoseksual” në të përditshmen e Podgoricës “Pobjeda”.

Mitropoliti e vlerësoi këtë si një “shtrirje e Bienialit 1997 që ngriti një paturpësi që tani konsiderohet si normale” dhe se “është diçka në kufijtë e Satanizmit që Kishës i është dashur të luftojë që prej kohëve të hershme”. Mitropoliti Amfilohije paralajmëroi se qëllimi i amoralizmit në propagandën homoseksuale që u shfaq në “Pobjeda” ishte të “tallej me shenjtërimin e ekzistencën njerëzore dhe, si analizë të fundit, të sillte njerëzimin në prag të shkatërrimit e të vetë-shkatërrimit”.

Blic, Beograd, 24 korrik 2000.

◀ Frazja “akt i hapur homoseksual” është fyese. A ishte në fakt një foto e dy burrave që bënin seks, apo ishte thjesht një foto e dy burrave që putheshin ose shtrëngonin duart?

◀ Reporterët duhet të pyesin Mitropolitin se si saktësisht homoseksualiteti tallet me shenjtërimin e ekzistencës dhe e sjell njerëzimin në prag të shkatërrimit.

5. Gjinia

Me ndryshimin e shoqërive në Ballkan gjatë 10 viteve të fundit, po ashtu kanë ndryshuar edhe rolet e grave. Por nëse do të gjykosh nga disa revista të kohëve të fundit dhe botime të tjera që merren me gratë, do të mendoje se interesat e tyre kanë të bëjnë vetëm me veshjet, kozmetikën, zbukurimet dhe gatimin. Sigurisht pas mungesave që kanë vujatur ato-dhe gjithë të tjerët-gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është e kuptueshme që mundësia dhe sasia për një sërë mallrash që të zgjedhin ato është shumë interesante, megjithatë pa dyshim që shumë gra kanë shumë interesa të tjera përtej tyre.

Nëse një grua nuk portretizohet si perëndeshë e punëve shtëpiake dhe e modës, ajo ka shumë të ngjarë të shfaqet në media si prostitutë ose viktimë e ndonjë lloji. Megjithëse prostitucioni dhe trafikimi i grave janë probleme serioze, është e rëndësishme që jeta e grave të mbulohet në të gjithë shumëllojshmërinë e saj, po ashtu siç bëhet edhe me jetën e burrave. Ja disa tregues që mund t'ju ndihmojnë për ta bërë një gjë të tillë:

★ Gratë nuk duhet të dalin vetëm në shkrimet që kanë të bëjnë thjesht me problemet ose çështjet e grave. Sigurohuni të përfshini gratë si burime kurdoherë që është e mundshme. Nëse je duke shkruar për një rrymë artistike, gjeni një artiste ose dy për të komentuar për to. Nëse je duke shkruar për një debat politik në qytetin ose rajonin tënd, përpiku të glesh për të cituar një politikane. Çështja është që gratë të mos përfshihen vetëm në mënyrë artificiale, por të paktën të jenë të ndërgjegjshme për vlerën që u ofrohet atyre duke i dhënë mundësinë të kenë zërin e tyre për fatin e një sërë çështjesh.

★ Rishikoni listën e burimeve e kontakteve të rregullta që i merrni në telefon në mënyrë rutinë kur keni ide për shkrime ose kur shkruani. Nëse lista është pothuaj e mbushur me burra, ndërmerrni përpjekje për ta zgjeruar atë me gra. Megjithëse burrat priren të jenë më shumë të pranishëm në shumë fusha si akademia, jeta politike e kulturore, biznesi, është më e lehtë se sa e mendoni që të identifikoni edhe gra që të mund të përmbushin kërkesat tuaja po aq mirë.

★ Kur përfshini gra, përshkruajini ato në të njëjtën mënyrë si edhe burrat. Nëse në përgjithësi nuk shkruani për veshjen ose stilin e flokëve të një biznesmeni, atëherë mos diskutoni edhe për veshjet ose stilin e flokëve të një biznesmeneje, vetëm në rast se ato kanë të bëjnë me shkrimin. Shmangni fjalët e paqarta si “femërore” që kanë shumë nënkuptime dhe që mund të interpretohen në mënyra të ndryshme nga cilido. Përdorni detaje specifike për të shpjeguar atë që doni të thoni. A ecën ajo në mënyrë të hijshme? A flet me butësi?

★ Tregohuni të kujdesshëm në arritjen e vlerësimeve në shkrimet tuaja lidhur me rolin e grave. Shpesh gazetarët shkëmbejnë stereotipet e shoqërisë lidhur me gratë e burrat dhe i përforcojnë ato edhe kur nuk kanë ndërmend të bëjnë një gjë të tillë. Jo të gjitha gratë janë të interesuara për modën. Shumë gra janë të përfshira në problemet politike e sociale që shqetësojnë shoqërinë. Disa gra menaxhojnë biznese tepër të suksesshme. Kërkoni gra jeta e të cilave është në kundërshtim me perceptimin e zakonshëm se çfarë janë e si duhet të jenë gratë.

★ Takohuni me anëtare të organizatave të grave dhe pyetini për shqetësimet e tyre. Mund të ketë çështje që ato i konsiderojnë si të rëndësishme për të cilat as ju dhe as redaktorët tuaj nuk janë të ndërgjegjshëm. Nxitini ato të lidhen me ju, kur mendojnë se kanë diçka që mund të shërbejë si njoftim e ta diskutojnë. Por mos merrni ato që ju thonë si fjalët përfundimtare dhe mos mendoni që të gjithë organizatat e grave do t'ju tregojnë të njëjtën gjë. Të tjera ka mundësi të kenë mendime të ndryshme dhe materiali tuaj duhet të marrë parasysh edhe këto ndryshime.

★ Merrni parasysh të shkruani lidhur me çështje-si dhuna familjare dhe ngacmimet seksuale-të cilat janë mbuluar gjerësisht në perëndim por që nuk kanë tërhequr shumë vëmendje në shoqëritë post-komuniste. Ato janë probleme serioze të cilat janë shpërfillur ose u është kushtuar pak vëmendje nga sistemi ligjor si edhe media. Dhuna familjare shpesh konsiderohet si një çështje private e familjes e jo si krim, edhe kur rezultoni në dëmtime serioze. Hulumtoni se si trajtohet ajo në qytetin apo rajonin tuaj. A i mbron ligji gratë që rrihen nga burrat ose shoqëruarit e tyre? Si reagojnë policia dhe autoritete të tjera? A ka streha ku gratë e fëmijët mund të kërkojnë ndihmë?

★ Ngacmimi seksual në vendin e punës është një çështje tjetër që ka tërhequr vëmendje të madhe në perëndim. Ndërkohë që disa përpiqen ta konsiderojnë si një çështje të vogël, fakti është që gratë në të gjitha shoqëritë ndonjëherë përballen me kërkesa për joshje seksuale nga punonjësit e tjerë dhe zyrtarë më të lartë meshkuj në shkëmbim të ngritjes në detyrë ose të pagës, ose përndryshe ndodhen nën kërcënimin se do të pushohen nga puna. Ndonjëherë ngacmimet marrin formën e kërkesës së drejtëpërdrejtë për seks me një gjuhë seksuale tepër vulgare, të ulët që u drejtohet grave, dhe kjo mund ta bëjë të padurueshëm qëndrimin në punë. Zbuloni se çfarë ligjesh sundojnë në rajon. Sa i madh është ky problem? Si e luftojnë atë gratë?

★ Çështja e prostitucionit është shumë e madhe kur vjen me portretizimet e grave në media. Natyrisht që është e rëndësishme të mbulohet kjo temë, por kur bëhet një gjë e tillë është tepër vendimtare të përpiqeni të mos bëni gjykimin e grave për të cilat kjo mund të jetë mënyra e vetme për të jetuar. Edhe nëse një grua ka zgjedhur të jetë prostitutë dhe nuk është detyruar të shkojë drejt saj, përpiquni të kuptoni botën nga këndvështrimi i saj. Dhe bëni përpjekje të shihni përtej stereotipeve. Jo të gjitha prostitutat janë edhe drogmenë. Jo të gjitha janë nëna të tmerrshme.

★ Në disa vende prostitutat cilësohen me termin “punonjëse të seksit” si një mënyrë më pak fyese kur flitet për to. Pyetini ato përse preferojnë atë frazë dhe bëni një shkrim se çfarë do të thotë ky ndryshim. A përpiqen prostitutat, ose punonjëset e seksit, të krijojnë organizatat dhe shoqatat e tyre? A bëjnë përpjekje për shëndet më të mirë për vete ose kërkojnë të përhapin informacion se si të mbrohen nga HIV dhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme?

★ Trafikimi i grave është bërë gjithashtu një çështje e rëndësishme gjatë viteve të fundit. Hulumtoni situatën në rajon. Nga vijnë gratë? Si joshen ato nga shtëpitë e tyre dhe si detyrohen të qëndrojnë? Flisni me organizatat joqeveritare që merren me këtë çështje dhe kërkojuni atyre t'ju lidhin me gra që janë ndodhur në këtë situatë.

Raste për studim

Shpesh gazetarët tallen me gratë që e quajnë veten feministe, kështu që ky artikull është një shembull i mirë si të paraqiten shqetësimet e grave pa u tallur me ato që përmenden. Çështja se si paraqiten gratë në fushata reklamuese është e rëndësishme sepse ajo ndikon perceptimet sociale të grave dhe atje gazetari i merr seriozisht ankesat dhe veprimet e protestës.

5. a) **Feministet mbulojnë posterat me grafite**

Posterat që tregojnë gra të zhveshura janë mënyra më e keqe për të reklamuar prodhimet e mishit, thotë një pjesëmarrëse në një “operacion grafiti”

Reagoni ndaj shijes së keqe të Gavriloviçit

“Kush do të donte një të dashur nëse do të kishte Gavriloviçin,” “Kafshoje, e dashur,” “Pedofilia nuk është art,” “Dimitrije, a është kjo nëna jote?” si edhe disa të tjera që në mënyrë të hapur përmendin organin seksual mashkullor janë grafitet e feministëve të Zagrebit që nën fshehtësinë e natës “zbukuruan” posterat që reklamonin prodhimet Gavriloviç-vepër e artistëve të shquar kroatë.

Posterat me gra të zhveshura kanë tërhequr vëmendje të madhe të publikut dhe komente si positive ashtu edhe negative. Grupi i feministëve të Zagrebit përdori prej për të shprehur pakënaqësinë për këtë shfrytëzim seksist të trupit të gruas.

“Tre nga artistët tanë më të mirë kanë zgjedhur, nën petkun e artit, rrugën më të keqe të reklamimit të prodhimeve të mishit dhe e kanë portretizuar trupin e gruas si një lloj mishi. Firmat e famshme në postera ndoshta ishin vënë me qëllim nga ata që nisën fushatën për të dhënë besueshmërinë e reklamave, sepse cili do të vinte në pikpyetje kryeveprat e artistëve të famshëm? Natyrisht që autorët nuk e menduan se reklamat e tyre do të merreshin kaq drejtëpërdrejtë,” thotë një studente 25-vjeçare që mori pjesë në “operacionin grafiti,” duke shtuar se posterat do të ishin në rregull nëse do të vendoseshin në një galeri arti, por si reklama të vinte të pështirë.

◀ Artikulli do të dilte më mirë me një përshkrim më të saktë të posterave dhe çfarë reklamojnë ato. Përveç kësaj, duke iu referuar posterave si “ky shfrytëzim i trupit të një gruaje”, gazetari në fakt ka shfaqur një pajtim me feministet e nuk ka përshkruar pikëpamjen e tyre. Në fakt, gazetari duhej të intervistonte një ose më shumë artiste si edhe dikë nga Gavriloviç dhe t’i pyeste lidhur me akuzën që fushata reklamuese ishte seksiste.

Do të ishte më mirë të vendosej emri i saj, sepse përndryshe duket sikur ajo ka turp nga veprimet e saj. Nëse ajo nuk dëshiron që t’i përmendet emri se ka frikë mos persekutohet, gazetari duhet të shtojë disa informacione se çfarë përmban ligji lidhur me këtë çështje dhe çfarë ndëshkimi ka për një gjë të tillë.

Gratë e reja donin të tërhiqnin vëmendjen e publikut sepse mendojnë se njerëzit nuk i kushtojnë vëmendje faktit që gratë paraqiten si objekte.

“Ky nuk është vandalizëm. Ne duam të tregojmë se asnjëri nuk ka të drejtë të reklamojë në këtë mënyrë primitive,” tha gazetarja.

Jutarnji list, Zagreb, 16 maj 2002.

Ky artikull ngre zërin e grave që nuk shfaqen shpesh në media. Ai nënkupton që një gjë e tillë pa u treguar më emocional apo dramatik se ç'duhet, duke lejuar që gratë të shfaqen, në shumicën e rasteve, si individë me probleme e dilemma specifike e jo si stereotipe. Megjithatë ky artikull do të ishte me shumë fitim nga këndvështrimi i disa detajeve shtesë lidhur me vetë qendrën, përvojat e grave dhe një kontekst social më të gjerë të dhunës familjare.

5. b) Gratë – Viktima të Dhunës Familjare dhe Martesore: Trupa të Rrahur dhe Shpirtra të Goditur

Shkup – Kur Rizida Bekirova nga Shkupi u martua tetë vjetë më arë, ajo ishte një grua e lumtur dhe e kënaqur që nuk mund ta imagjinonte që do të përfundonte në një Qendër të Grave të Shkupit, e vetmja e llojit të saj në Maqedoni.

“U martova në moshën 17 vjeç. Dy muajt e parë ishin bukuri. Megjithatë kur lindi fëmija i parë burri fillio të pinte e të luante bixhoz. Nëse humbte do të vinte i inatosur dhe do të më rrihte. Më godiste në të gjithë trupin, unë pështyja gjak e do të villja.” 25-vjeçarja Rizida na e tregon historinë e saj në një prej dhomave të vogla të mobiluara thjesht në qendër. Një qilim jo shumë i bukur mbulon dyshemenë.

“Disa ditë më parë ai më rrahu përsëri, godiste në trup vazhdimisht, stomaku më dhembi, trupi rridhte gjak për disa ditë. Pas disa ditë mbylljeje unë mund atë shpëtoja nga shtëpia dhe të vija në Qendër,” thotë ajo.

Qendra u hap një vit më parë, por qeveria maqedonase nuk e financon atë fare. Donatorët kryesorë janë ambasadat e huaja. “Kushtet janë jo të mira sepse kemi financim minimal,” thotë manaxherja Daniela Dabevska. Qendra ka tre punonjës, që më par kanë qënë vullnetarë. Tani marrin disa paga të vogla.

“Mbi 60 gra në vit nga e gjithë Maqedonia kërkojnë ndihmë. Backgroundi i tyre etnik, gjendja sociale, arsimimi dhe mosha ndryshojnë. Na marrin në telefon në çdo kohë, telefoni ynë është i njohur përmes medias. Vendndodhja e qendrës

Si titulli ashtu edhe nëntitulli transmetojnë me sukses thelbin e artikullit, pa gjuhë nxitëse dhe të bujshme. Dikush që lexon vetëm titullin dhe jo të gjithë artikullin e kupton se gazetari po e trajton këtë temë në mënyrë serioze dhe e konsideron atë një problem të madh social.

◀ Cili është buxheti vjetor? A ndihmon qeveria me ndonjë shumë? Sa japin ambasadat e huaja? Si u krijua në fillim qendra?

◀ Ajo përmend background të ndryshëm nga vijnë gratë, por do të ishte mirë të dinim disa detaje më shumë se çfarë janë

jepet jo shumë hapur sepse nuk duam që burrat ta dinë se ku qëndrojnë gratë e tyre. Burrat na kanë kërcënuar se do të na vrasin të gjithave kur vijnë për gratë e tyre,” thotë Dabevska.

Qendra mund të strehojë vetëm 20 gra me fëmijë. Atje ato ushqehen duke gatuar vetë, si edhe kanë ndihmë mjekësore e atë të psikologëve, punonjësve socialë e të juristëve. Qendra ka dhoma të thjeshta deri me tre krevatë. Dabevska thotë se shumica e grave që kanë ardhur në qendër, 72%, janë abuzuar nga burrat e tyre. Pjesa tjetër janë viktima të dhunës prindërore ose nga të dashurit e tyre. 61% e grave janë abuzuar fizikisht, 10% seksualisht, ndërsa pjesa tjetër nga tortura psikologjike.

Duke treguar historinë e saj herëpashere Rizida fillon të dridhet e të qajë. “Burri im është pijanec dhe bixhozçi, ai nuk e çan kokën për fëmijët. Unë nuk punoj dhe burri nuk do të ma lejonte një gjë të tillë. Gjithçka që fiton e shpenzon dhe fëmijët e unë nuk kemi çfarë të hamë. Nuk kemi ku të shkojmë, as të afërm dhe jetojmë me nënën e tij që nuk mund të bëjë gjë, sepse edhe ajo rrihet prej tij. Më e keqja është se ai rreh edhe fëmijët. djali më i vogël, tre vjeç e gjysmë, Dzaner, e ka hundën të thyer prej babait të tij. E përplasi në mur dhe në tokë, e hodhi nëpër dhomë, dhe nuk e kam idenë se si jeton fëmija pas asaj,” tha ajo përmes lotëve. Pastaj na tregon shenjat dhe plagët nga rrahjet.

“Jam larguar disa herë dhe jam kthyer përsëri. Nuk kam para, nuk kam arsim, nuk kam apartament, nuk di ku të shkoj dhe ja përse jam kthyer. Nuk dua që fëmijët të dalin e të lypin në rrugë,” thotë ajo.

Gratë mund të qëndrojnë një vit në qendër, sipas rregullave. Kjo për shkak të numrit në rritje të grave që kërkojnë ndihmë dhe të mundësive të kufizuara për t’i përballuar ato. Rizida ka ardhur në qendër për herë të dytë këtë vit. Ajo shpreson se do të gjejë një punë që do t’i sigurojë të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe tre fëmijët. “Nuk do të kthehem kurrë tek ai më,” betohet ajo.

Andrijana M. është 23 vjeç. Si fëmijë ajo u abuzua seksualisht nga njerku i saj, dhe pastaj u bë

këto gra, si edhe më shumë informacion për dhunën familjare në përgjithësi. A ka statistika që tregojnë sa e zakonshme është kjo në Maqedoni? A mendohet se është më e zakonshme në disa grupe sociale? A ka punuar qendra me OJQ ndërkombëtare që merren me çështjet e të drejtave të grave?

◀ Çfarë është tortura psikologjike? Këto shifra tregojnë sikur asnjëra prej grave nuk i nënshtrohet tre lloj formash të dhunës njëkohësisht, gjë që mund të mos jetë e vërtetë.

◀ Sa vjeç janë dy fëmijët e tjerë të saj? Si ka ndikuar dhuna tek ata, psikologjikisht si edhe fizikisht? Si mundën konkretisht të largoheshin? Sa larg nga shtëpia është ajo? A e ka idenë burri i saj se ku mund të jetë ajo? Si e mësoi ajo ekzistencën e qendrës? Këto lloj detajesh shtesë do të ndihmonin ta bënin këtë shkrim edhe më të gjallë për lexuesin.

viktimë e dhunës familjare. Ka një shenjë në fytyrë dhe disa dhëmbë i mungojnë. Duart i ka të nxira.

“Isha vetëm nëntë vjeç kur njerku filloi të abuzonte seksualisht me mua. E bëri këtë gjë për vite me radhë në mënyrën më brutale. Nëna nuk donte të më besonte kur i thashë se çfarë po kaloja. Mendoj se ajo nuk guxoi të përmendte gjë, pjesërisht për shkak të turpfit, dhe pjesërisht se njerku e rrihte edhe atë. Kur u bëra 14 vjeç munda të shkoj në një qendër për fëmijë. Katër vjetë më pas u martova dhe atëhere jeta ime u shndërrua në një ferr tjetër. Në katër muajt e parë martesë ishte e mirë. Pastaj burri filloi të pinte e të më ofendonte, të abuzonte me mua e të më rrihte nëse nuk pranoja t’i jepja para dhe alkool. Unë nuk kam fëmijë e nuk do të kem kurrë. Kur isha pesëmuajsh shtatzënë ai më goditi kaq fort sa humba fëmijën dhe mundësinë për të patur fëmijë,” thotë ajo.

“Jetoj në një fshat ku të gjithë e njohin njëri tjetrin ose janë të lidhur me njëri tjetrin dhe asnjëri nuk do të merret krahun tim. Asnjëri nuk do të donte të ishte kundër burrit tim. Nuk kisha ku të shkoja. Të kthehesha tek nëna e njerku ishte një opsion. Por mendoj se tani do ta kasha vvarë atë. Nuk mund të qëndroja në shtëpi, sepse burri do të më rrihte. Kjo është arsyeja përse erdha në qendër,” shpjegon Andrijana. Ajo pretendon se policia e dinte që atë e rrihte burri, por kurrë nuk e arrestoi atë.

Jeta ka qënë e vështirë për Andrijanan, gjithçka duket se ka shkuar keq. Veç që është rrahur dhe abuzuar, ajo nuk ka më as siguracionin e jetës e atë shëndetësor sepse ligji thekson se vetëm një pjestar i familjes mund ta ketë atë. Natyrisht që gjithë paratë shkojnë tek burri i saj. “Kur më rreh burri unë duhet t’i kërkoj para dhe kartën mjekësore që të provoj se kam siguracione. Ai kurrë nuk m’i jep ato. Kurrë, edhe kur jam dëmtuar më shumë, kur më ka rrjedhur gjak për një kohë të gjatë. Isha lënë pa para, me shenja dhe dëmtime, dhe pa mundësi për kujdes mjekësor,” thotë Andrijana.

V.N. ishte e martuar prej 20 vjetësh. Na kërkoi anonimitet të plotë, sepse kishte frikë se burri do

◀ Dhëmbët i mungojnë për shkak të rrahjeve? Shumë njerëz në rajon kanë mungesa dhëmbësh për arsye që nuk kanë lidhje me të. Nëse dhëmbët e munguar nuk kanë të bëjnë me rrahjet, kjo është pak keqdrejtuese që të përfshihet si detaj në përmbajtje.

A është i saktë përshkrimi i Andrijanas lidhur me gjendjen e saj të siguracionit social e shëndetësor? Apo është interpretimi i situatës nga ana e saj? Kjo kërkon një shpjegim nga gazetari ose një ekspert që do të thotë se çfarë thotë ligji me saktësi.

ta gjente. Nuk dëshiron të ndërmarrë ndonjë rrezik pas asaj që ka kaluar dhe gjithashtu nuk dëshiron që njerëzit të dinë se çfarë ndodhi me Martesën e saj. Ajo ka tre fëmijë dhe burri është një bixhozçi i rangut të lartë.

“Ai merrte 50,000 marka gjermane dhe do të më çonte në kazino. Unë duhej të thoja një numër mbi të cilin ai do të vendoste bastin. Nëse fitonte, ishte i lumtur. Problem ishte kur unë nuk gjeja numrin e duhur. Atëhere fillonte tmërri. Do të më godiste, do të më priste me një thikë ose brisk, do të më shkulte flokët. Në disa vende flokët nuk do të mund të dalin më,” thotë ajo.

Vajzat trajtoheshin prej burrit në të njëjtën mënyrë. “Më e tmerrshmja ishte kur isha shtatzënë, ai më godiste në stomak, nuk e di se si doli në dritë djali. Një vit më parë mund atë largohem diku. Kur mbërrita atje rashë në krevat dhe nuk munda të ngrihem për tre muaj. Pasi punonjësi social ushtroi presion, burri nënshkroi një letër që më jepte mua të drejtën e pronësisë të gjysmës së pasurisë dhe më premtonte se nuk do të më rrihte më. U ktheva për shkak të fëmijëve. Ai nuk e mbajti premtimin. Herën e fundit që më rrahu unë i kërkova divorc. Unë dua të filloj një jetë të re,” thotë ajo.

Qendra thotë se V.N. është një prej pak grave që mund të largohen prej burrave të tyre dhe të shkëputen plotësisht prej tyre. “Nuk mund t’i themi një gruajë të qëndrojnë ose jo me burrin e saj. Është e drejta e tyre të vendosin se çfarë do të bëjnë në jetën e tyre. Mua do të më pëlqente t’u thoja të mos ktheheshin kurrë tek burrat, por unë nuk kam të drejtë të ndërhyjë në jetën e tyre. Edhe më shumë kështu për shkak se ne nuk mund t’i premtojmë e sigurojmë atyre një vend pune ose para,” thotë Dabevska. Ajo mendon se problemi më i madh është se vetëm një numër i vogël grash të tilla shkojnë në qendër. të tjerat qëndrojnë në agoninë e tyre familjare.

Psikologja Tamara Markovska thotë se dhuna fizike kundër grave është sidomos e zakonshme në Ballkan. “Shpesh gratë varen financiarisht nga burrat. Nuk kanë strehim më vete dhe nuk mund të kthehen tek prindërit e tyre. Veç kësaj, çështjet familjare ende konsiderohen si diçka që duhet të

◀ Vallë ai e goditi kaq fort në kokë në disa vende sa flokët nuk mund të dilnin më? Ky është një shembull i një burimi që bën një deklaratë që mund të jetë ose jo e vërtetë. Nëse gazetari ndjen se dikush po e tepron ose po e çon shumë larg një thënie, do të ishte mirë që personi të pyetej pak më shumë për të qartësuar e kontrolluar saktësinë me një ekspert, ose pretendimi i dyshimtë të lihej pa u përdorur, gjë që do të ishte më mirë se sa të pranohej drejtëpërdrejtë ashtu siç thuhet pa e kontrolluar.

◀ Sa përqind e vizitoreve të qendrës kthehen tek burrat? Çfarë përqindje mund të gjejë punë, të vendosen të kënaqura diku, të rimartohen e kështu me radhë? Cilat janë ligjet lidhur me divorcin, ndarjen e pasurisë e kështu me radhë? A e bëjnë ligjet veçanërisht të vështirë që gratë të arrijnë pavarësinë e tyre? Nëse po, a ka ndonjë politikan apo OJQ që punon për të ndryshuar ligjet?

jetë private në Ballkan. Ekziston edhe kulti i mashkullit. Në ish-zonat e luftës ose të konflikteve, që janë të mbushura me krime, policia bën pak për rastet e dhunës familjare. Gjithnjë mendon se ka çështje më të rëndësishme që të merret," thotë Markovska.

Markovska thotë se burrat që rrahin gratë e tyre në të shumtën e rasteve janë neurotikë dhe persona jo normalë që kanë nevojë për ndihmë mjekësore. "Gratë që janë ngacmuar nuk duhet të presin që ndonjë prej tyre të përmirësohet pa një kurim psikologjik. Duhet ta kuptojnë se ato janë të vetmet që mund ta thyejnë zinxhirin e dhunës," thotë ajo.

Qendra e Shkupit është tepër e vogël për të ndihmuar të gjitha llojet e grave që janë viktime të dhunës e që kanë nevojë për ndihmë. Administratat e qendrës thotë se ka plane për të hapur streha të reja në qytete të tjerë në Maqedoni. Megjithatë për momentin thjesht nuk ka fonde.

Beta/MDI, Beograd/Londër, 17 shtator 2002.

A punon Markovska në qendër? Ajo nxjerr disa pika të mbrekullueshme, të cilat mund të shtjelloheshin më tej. Dhuna kundër grave është e zakonitë kudo. A ka ndonjë provë për të mbështetur pretendimin e saj se ajo është veçanërisht e zakonitë në Ballkan? Përse gratë nuk mund të kthehen tek prindërit e tyre? Çfarë do të thotë ajo me 'kultin e mashkullit'? Cilat janë ligjet lidhur me dhunën familjare?

◀ Pretendimi i saj që burrat që rrahin gratë janë të gjithë neurotikë dhe jo normalë duket pak i tejthjeshtuar si arsye që i shtyn burrat të sillen në një mënyrë të tillë. Ka shumë arsye psikologjike të ndërlikuara prapa një sjelljeje të tillë dhe një shpjegim më i hollësishëm e i menduar do të hidhte më shumë dritë për këtë problem. Çfarë lloj ndihme mjekësore mendore duhet për gratë? A ndjejnë ato njëfarë "sindrome të grave të poshtëruara" në Maqedoni? Cilat janë presionet sociale dhe psikologjike që e bëjnë të vështirë për gratë lënien e burrave ose të të dashurve?

◀ A i ka zhvilluar qendra planet për streha të tjera, apo do t'i bëjnë grupe të tjera ato? Cila është kostoja e një qendre të tillë? Çfarë përpjekjesh janë bërë për të gjetur fonde nga burime ndërkombëtare ose joqeveritare? Nëse tani nuk mund të hapen qendra të tjera, kur mund të ndodhë një gjë e tillë? Si e mësojnë gratë lidhur me qendrën ose si të kontaktojnë me të? Do të ishte mirë të përfshihej një numër telefoni ose ndonjë mënyrë tjetër që të theksohej në artikull si do të kontaktohej qendra.

Ky është një shembull i mirë si hulumtohet një problem social përmes një shqyrtimi të thellë të përvojës së një personi. Gazetari i jep Marianës një shans të tregojë sa më shumë detaje që të mundet, gjë që i jep besueshmërinë shkrimit. Natyrisht gjithnjë është e mundshme që Mariana të ekzagjerojë ose edhe të gënjejë dhe që gazetari duhet të jetë tepër i sigurt që t'ia atribuojë tregimin personit që e tregon atë. Megjithatë në këtë rast fuqi e grumbulluar e tregimit të saj na shtyn t'i besojmë ato që thotë.

5. c) **Mariana dhe shenjat që nuk kurohen: Varfëria ka shndërruar shtetin sovjetik dikur në lulëzim në një burim kryesor prostitutash**

Një raport i trafikut në rritje të grave të reja

Mariana gjithnjë do të kujtojë muajt e tmerrshëm që duroi si skllave seksi – shenjat e nxira në parakrahët e saj, ku një burrë i panjohur e priste vazhdimisht me një thikë kasapi.

“Është e pamundur të harrohet dhimbja. Edhe tani që jam e sigurt, është shumë vështirë të flej gjatë natës,” thotë gruaja 24 vjeçare në një kafene në periferi të Çisinaut, kryeqytet i Moldavisë. Ndërkohë që flet, duart e saj dridhen dhe syri i lëviz në mënyrë nervoze sikur është në pritje të rrezikut. Dëmi psikologjik në të është po aq i dukshëm sa edhe shenjat në të. Mariana është një prej qindra, në mos mijëra, grash të reja modave që çdo vit merren jashtë vendit, kryesisht në ish-Jugosllavi, dhe vihen të punojnë si prostituta. Ajo është nga ato pak që ka mundur të shpëtojë nga Ballkani dhe të kthehet në mëmëdheun e saj.

Varfëria mund t'i çojë gratë drejt prostitucionit në mbarë botën, por moldavet janë veçanërisht të prekshme nga një gjë e tillë. E ndodhur midis Ukrainës dhe Rumanisë, vendi i tyre është më i varfri në Europë.

U nda në fillim të viteve 1990-të nga një luftë civile që e ka lënë të tillë midis një qeverie zyrtare në Çisinau në perëndim dhe një administrate jozyrtare në Tiraspol në lindje. Korrupsioni dhe krimi i organizuar janë kudo. Si gratë e reja, ashtu edhe gjithçka tjetër është në shitje – armë, drogë, kontrata vrasjesh e madje edhe pjesë trupi.

◀ Ky detaj specifik është një shembull se si vëzhgimi nga afër i jep një fuqi më të madhe shkrimit. Lexuesi mundet t'i krijojë në mendje shenjat, sepse e dimë që janë të nxira dhe se parakrahët e saj janë të zbehtë dhe ne na thuhet se është një thikë kasapi e jo ndonjë lloj tjetër thike.

◀ Do të ishte mirë që këtu gazetari të jepte disa statistika të vlefshme nga OJQ-të ose të tjerë që punojnë për këtë çështje. Dhe a ka ndonjë vlerësim më të saktë se si shumë kanë mundur të shpëtojnë e të kthehen në shtëpi?

◀ Gazetari duhet ta mbështesë këtë pretendim. Në ç'mënyrë është më i varfri? A është më i varfër në të gjitha përmasat se sa Shqipëria, për shembull, që gjithashtu është cilësuar si vendi më i varfër i Europës?

Kur Mariana rritej në kohërat sovjetike në një fshat në Moldavinë jugore askush nuk e parashikonte një tmerr të tillë. Me tokën e saj pjetlore Moldavia ishte e njohur në bllokun sovjetik për ushqimin dhe verën e saj. Oficerët e KGB-së dilnin në pension në Moldavi, sepse jeta atje ishte kaq e mirë. Ata së bashku me gratë e tyre u pëlqente të vinin vërdallë parqeve elegante të qendrës së Çisinaut, qyteti më i blertë në Europën lindore, sipas banorëve të tij. Që prej ndarjes së ish-Bashkimit Sovjetik u shkatërrua edhe qëndrueshmëria e Moldavisë duke e futur popullin në një varfëri të thellë. Fabrikat u mbyllën. fermat dhe vreshtat u braktisën. Të paktën 600,000 vetë nga popullsia katër milionëshe e Moldavisë kanë shkuar jashtë vendit për të punuar. Në disa distrikte gati gjysma e popullsisë së aftë për punë është larguar.

Vetë Mariana u largua nga fshati i saj për në Çisinau në mesin e viteve 1990-të duke kërkuar punë, të cilën ajo e gjeti në një fabrikë tekstilësh. Takoi një burrë, u martuan dhe ajo mbeti shtatzënë. Kur lindi djali ajo filloi lejen e gjatë të lindjes me një pagesë prej më pak se 30 dollarë në muaj. Paratë nuk i dilnin për të jetuar; burri nuk i jepte asgjë dhe pastaj e braktisi. Në kërkim të parave në fund të vitit 2000 ajo iu përgjigj një reklame për punë në *Makler*, një gazetë. Reklama premonte, thotë ajo, një pagesë të mirë në një punë jashtë vendit. Ajo telefonoi numrin e reklamës, foli me një grua, dhe rregulloi një takim.

“Kurrë nuk do ta harroj atë. Ajo kishte një shenjë përgjatë fytyrës sikur të ishte prerë me thikë. Duhej të kishte shërbyer si një paralamërim për mua. Por unë nuk parashikova se çfarë do të ndodhte,” thotë Mariana.

Gruaja me fytyrën me shenjë i premtoi asaj një pagesë prej 300 dollarësh në muaj në rast se ajo do të vallzonte në klube në Jugosllavi. “I thashë se nuk dija të vallzoja. Gruaja tha se nuk kishte rëndësi, do të mësoja.”

Mariana nuk mendoi shumë. E la fëmijën me prindërit dhe pak ditë më pas u bashkua me tre gra të tjera të reja në një makinë që shkoi nga Çisinau në kufirin rumun. Atje priste të takonte

një jugosllav, por në vend të tij u përshëndet nga një rumun trimosh. Mariana filloi të shqetësohej ndërkohë që kalonin qindra kilometra me makinë, duke ndaluar vetëm për t'u mbushur me karburant.

Më në fund, ndaluan në Turnu Severin, një qytet i bukur, por i shkatërruar, në Danub. Në anën tjetër të lumit ishte Serbia. "Këtu më në fund e kuptova se ç'po ndodhte me mua. I thashë burrit se doja të kthehesha në Moldavi. Ai më tha: "Kam paguar për ty dhe nuk të le," thotë Mariana. Vuajtjet fizike të udhëtimit u shtuan edhe me frikën. gratë u morën matanë në Serbi, Mal të Zi e në Kosovën e administruar nga Kombet e Bashkuara për në kufirin maqedonas, ku u detyruan të ecnin tetë orë përgjatë rrugëve malore për të shmangur rojet. Rreth 10 ditë pasi lanë Çisinaun gratë u vendosën në një apartament në Shkup dhe u vunë në punë nga trimat e tyre. Mariana asnjëherë nuk ishte e sigurt se cilët ishin këta burra. Ndonjëherë urdhëroheshin nga maqedonas, ndonjëherë nga shqiptarë. Kur flitej maqedonisht ajo mund të kuptonte, meqë ajo ngjante me rusishten, që mësohej në Moldavi gjatë periudhës sovjetike. Herëpashere burrat që dukeshin si policë do të vinin në apartament e do të flisnin me trimoshat, ndonjëherë për seks. Njëherë policia kontrolloi apartamentin kur ajo ishte jashtë duke blerë ushqime. Tha që ajo u mor larg prej trimoshave dhe u fsheh në një qilar për dy javë. Mariana thotë se gjatë kësaj kohe ajo nuk pranoi të punonte në seks.

Në vend të kësaj, ajo gatuante e pastronte për gratë e tjera. Por në fillim të janarit ajo u shit në një bandë shqiptarësh etnikë në Tetovë, qyteti maqedonas perëndimor i dominuar nga shqiptarët etnikë.

Ajo u strehua me gra të tjera në një apartament mbi një bar në periferi të qytetit. Këtu ajo nuk rezistoi më dhe ra dakord t'i shërbente vetë klientëve. "Ishte e tmerrshme. Më vinte pështirë," thotë ajo.

Por nuk kishte kthim prapa. Ajo trembej nga trimoshat dhe po ashtu të shkonte edhe në polici. "Nëse flisje keq për padronin tënd, do të rriheshe e ndoshta edhe vriteshe."

Për ta bërë edhe më keq gjendjen, tensionet që prej kohësh kishin ndarë maqedonasit me shqiptarët në Maqedoni u shndërruan në dhunë. Në fillim të pranverës guerrilasit shqiptarë filluan të luftonin në dhe përreth Tetovës.

Policia dhe trupat maqedonase u kundërpërgjigjën me disa përpjekje të dëshpëruara për të vrarë ose kapur luftëtarët. Momenti më i frikshëm i Marianës ishte kur në apartament u fut një grup burrash. Ajo ishte vetëm me një grua tjetër moldave. Burrat nuk ishin me uniformë, por ajo mendoi se ishin policë maqedonas nga mënyra si silleshin dhe nga gjuha zyrtare që përdornin.

“Ata donin të dinin për padronët tanë shqiptarë. Ata kërkonin UÇK-në (ushtria çlirimtare shqiptare). Ne nuk thamë asgjë. “Papritur njëri prej burrave nxori një thikë kasapi. Ishte aq e mprehtë sa mund të të priste nëse prekje vetëm presën. më preu në të dy krahët. Gjaku u shpërnda kudo.”

Burrat u larguan aq shpejt sa edhe erdhën, thotë Mariana. Për të provuar tregimin e saj, ajo ngriti mëngët dhe tregon shenjat që thotë se u bënë me thikë. Ishin katër a pesë shenja të nxira në të dy krahët mbi kyçet e dorës, të cilat mjekët thonë se nuk do të zhduken kurrë. Mariana dhe shoqja e saj fashuan me rroba plagët dhe pushuan për të marrë veten nga shoku. Por nuk kishin kohë për të marrë veten. Ndërkohë që lufta midis guerrilasve dhe forcave maqedonase të sigurisë vazhdonte, ato mbaheshin zgjuar natën nga zhurmat e të shtënave të topave. “Ishim në luftë,” thotë Mariana. Por megjithatë vajzat duhej të vazhdonin të punonin. Mariana thotë se përveç shqiptarëve ashtu edhe maqedonasve, klientët të tyre ishin edhe ushtarët europianoperëndimorë nga forcat e drejtuara nga NATO të vendosura në Maqedoni.

Pastaj ajo u sëmur në mëlci, thotë ajo. Kur e mori veten refuzoi të kthehej në prostitucion dhe punoi në bare. Shpëtimi i saj erdhi në një vend të papritur. Një shqiptari që jetonte aty përreth i erdhi keq për të dhe për një moldave tjetër të quajtur Zana. Një ditë nga fundi i pranverës ai i ofroi asaj ta fshihte në një apartament bosh, larg trimoshave të tyre. Mariana thotë se ato dyshuan se

◀ Akuzat e bujshme, që ndër klientët ishin dhe ushtarët e NATO-s, është e përsëritur. Do të ishte mirë që gazetari të jepte ndonjë informacion lidhur me këtë problem, sa dihet për të, e kështu me radhë.

ai donte të bënte seks. Por ai nuk kërkoi asgjë. “Ai ishte shumë i mirë.”

Mariana thotë se ajo dhe Zana jetuan në apartament për disa muaj ku ushqimi i vinte nga Samaritan i tyre i Mirë. Gjatë konfuzionit të luftimeve trimoshat nuk mundën t'i gjenin në vendin e fshehjes. Në verë luftimet në Maqedoni përfunduan me një armëpushim jo të lehtë dhe bamirësi i grave shqetësohej gjithnjë e më shumë se ato do të kapeshin.

Ai shkoi në Shkup për të kërkuar mbështetje nga ambasada rumune, që kujdeset për interesat moldave në Maqedoni. Ambasadori ra dakord të ndihmonte. Në 3 shtator gratë hypën në një autobus nga Tetova në Shkup. Mariana thotë se ato u tmerruan se do të ndaloheshin nga trimoshat gjatë udhëtimit të tyre njëorësh përgjatë autostradës me dy korsi midis dy qyteteve. Por ato mbërritën në ambasadë, ku ambasadori thirri një zyrtar të lartë të policisë maqedonase, i cili organizoi një shoqërim në zyrat e UNICEF-it, organizata e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët. Një javë më pas ato ishin në shtëpi në Moldavi.

Mariana ishte tepër e emocionuar kur pa prindërit dhe djalin e saj. I tregoi babait dhe nënës se kishte punuar jashtë vendit, por jo se çfarë kishte bërë. Ajo nuk e di nëse ata e kanë kuptuar tani. Ajo thotë se nxori një mësim të mirë. “Nëse dikush më pyet, unë do të thoja ‘Kurrë, kurrë, mos bë atë që bëra unë’.” Përshkrimi i tregimit të Marianës konfirmohet nga La Strada, një organizatë ndërkombëtare joqeveritare që shpëton prostitutat dhe që tani kujdeset për Marianën në Çisinau.

Jana Costachi, drejtore e Qendrës për Parandalimin e Trafikimit të Grave, një tjetër OJQ që merret me çështjen e prostitucionit me bazë në Çisinau, thotë se nuk ka mundësi të mësohet se sa gra punojnë jashtë si prostituta – ose sa prej tyre mbahen kundër vullnetit të tyre. “Ato janë të reja dhe naëve. Vështirë të mësohet sa dinë ato para se të largohen.” Vladimir Voronin, presidenti moldov, këmbëngul se qeveria po bën të pamundurën. Ne po luftojmë kundër mafias në të gjitha drejtimet.” Kohët e fundit shteti futi në fuqi një ligj të ri që nxjerr jashtë ligjit rekrutimin e

◀ Si kujdesen ata? Çfarë shërbimesh ofrojnë?

punëtoreve të seksit dhe përpiqet të godasë agjencitë e udhëtimit të dyshimta që japin bileta e dokumente për gratë e reja.

Por zyrtarët e qeverisë moldave thonë se pak mund të bëhet nëse nuk dot ë ketë një veprim të përbashkët kundër prostitucionit në vendet ku punojnë këto gra, përfshirë edhe në Kosovën e administruar nga Kombet e Bashkuara. Me kaq shumë kërkesa për mundësitë e tyre, qeveritë e ish-Jugosllavisë po bëjnë pak për të ndihmuar, thonë zyrtarët në Çisinau.

Tregtia vazhdon me gra të reja të rekrutuara çdo ditë. Një numër i fundit i *Makler* reklamonte vende pune në Austri për gra. Një thirrje telefonike e përcaktoi shpejt se ato që kërkoheshin ishin gra të reja “që të ishin të paktën 160 cm të gjata, jo më të mëdha se 24 vjeç dhe që duhet të jenë të bukura . . . Këtu po kërkohet marrëdhënie intime,” tha personi që iu përgjigj telefonatës në numrin e reklamuar.

Policia ka patur disa suksese të dukshme. Disa muaj më parë ata kontrolluan zyra të ndryshme të aeroportit të Çisinaut dhe arrestuan një trafikante moldave që po merrte tetë gra jashtë vendit. Detektivi që drejtoi sulmin tha: “Pati zhurmë. Katër nga gratë e reja u shqetësuan sepse ato donin të largoheshin nga vendi dhe ne i ndaluam. Katër të tjerat duket sikur u çliruan.”

Por njësisia e policisë që merret me prostitucionin merret edhe me krimin e organizuar dhe ka mungesë fondesh që të përqëndrohet në ndalimin e trafikimit të qënieve njerëzore. Drejtuesi i saj, një shef policie i ashpër i quajtur Constantin Clipa, thotë se ndërsa njësisia e tij bën të pamundurën, përsëri ajo nuk mund të bëjë gjë tek rrënjët e problemit, që është “varfëria dhe mungesa e vendeve të punës në Moldavi”.

Financial Times, Londër, 12 janar 2002.

◀ Informacioni i ofruar në paragrafet e fundit është kritik për të kuptuar situatën e përgjithshme. Megjithatë lexuesit mund të mos e vënë re atë sepse shumë nuk i lexojnë artikujt deri në fund. Do të ishte më mirë që një pjesë e saj të përfshihej diku më sipër me qëllim që të jepej një kuadër më i mirë për të kuptuar historinë e Marianës.

6. Njerëz me paaftësi

Njerëz me paaftësi

Njerëzit me paaftësi, fizike ose mendore qofshin ato, shpesh shpërfillen nga media. Kur nuk shpërfillen, zakonisht për ta shkruhet ose për t'i tallur ose për të shprehur keqardhjen. Gazetarët shpesh i diskutojnë problemet e tyre me mjekët, autoritetet qeveritare e të tjerë pa folur fare me vetë njerëzit e paaftë, kështu që kanë pak idera se si ndikohen ndjenjat e tyre e të menduarit kur flitet për ta.

Kjo ka të ngjarë të ketë të bëjë me faktin se mund të jetë e vështirë të gjesh njerëz me paaftësi që mund të intervistohen. Njerëzit me skizofreni, të vonuar dhe me vështirësi të tjera mendore dhe emocionale qëndrojnë ose mbahen të fshehur ose në shtëpi ose në institucione, sepse familjet e tyre kanë turp për ta ose janë përpjekur t'i mbrojnë nga diskriminimi social. E njëjta mund të thuhet edhe për personat që nuk kanë ndonjë gjymtyrë ose që vuajnë nga probleme cerebrale, skleroza ose paaftësi të tjera fizike, veçanërisht meqë shoqëria bën pak përpjekje për të përshtatur nevojat e tyre me arsimim, vend pune dhe infrastrukturë fizike si rrugë dhe ndërtesa publike.

Një tjetër vështirësi është se njerëzit me ndonjë lloj forme paaftësie janë shpesh edhe anëtarë të grupeve të tjera sociale që kosniderohen në mënyrë negative nga shoqëria më e madhe. Megjithëse çdokush mund të infektohet me HIV dhe AIDS, të bëhet drogmen, prostitutë e homoseksual-që në përgjithësi nuk pranohen si anëtarë të vlefshëm të shoqërisë—ata shpesh konsiderohen se janë në rrezik më të madh.

Ja disa gjëra që duhet të mbahen parasysh kur shkruhet për njerëz me paaftësi:

★ Së pari, duhet të shkruani për ta. Dhe kur shkruani për ta, sigurohuni të flisni me ta. Ato që ju thonë të tjerët për ta—edhe nëse flasin me simpati—duhet të shërbejnë vetëm si pikënisje për materialin tuaj. Duhet t'i kontaktoni vetë njerëzit e paaftë dhe t'i pyesni nëse ato që ju kanë treguar të tjerët për ta përkojnë me ato që vetë ata mendojnë për gjendjen e tyre. Nëse ka ndonjë kontradiktë në ato që dëgjoni, mund të kthehesh tek mjekët e të tjerët që e kosniderojnë veten si ekspertë e t'i pyesni përsëri.

★ Mos shkruani për njerëzit me paaftësi vetëm lidhur me paaftësitë e tyre. Njerëzit e paaftë kanë interesa, karrierë dhe familje si gjithë të tjerët. Nëse gjeni njerëz që kanë arritur sukses si artistë, politikanë, ose profesionistë pavarësisht nga të qenit të paaftë, ajo mund të shërbejë si një shkrim i mirë. Kaloni pak kohë me ta për të zbuluar se si i kapërcyen vështirësitë në rrugën drejt suksesit. Pyetini ata se çfarë këshille do të jepnin për të tjerët në të njëjtën situatë.

★ Kujdes me gjuhën që përdorni. Çdo gjuhë ka grupin e vetë të fjalëve—disa fyese, disa jo-për të përshkruar njerëzit me paaftësi. Mund të mendoni se një fjalë apo një shprehje e veçantë nuk është e dëmshme, por nuk jeni gjyqtari më i mirë për këtë. Nëse njerëzit me atë paaftësi ju thonë se do të pëlqenin të thirrreshin në një mënyrë tjetër, kërkesa e tyre duhet të merret parasysh me seriozitet.

★ Një aspekt i rëndësishëm i mbulimit gazetaresk të njerëzve me paaftësi është çështja e mundësisë për të arritur diçka. Bëni një shkrim lidhur me faktin nëse shoqëria është duke bërë ose jo përpjekje për të lejuar njerëzit me paaftësi të marrin pjesë në aktivitete të rëndësishme sociale. Nëse nuk po e bën një gjë të tillë, përse jo? A është për mungesë fondesh, mungesë e dëshirës politike, paragjykime të rrënjosura thellë, apo ndonjë arsye tjetër? Çfarë lloj arsimimi dhe mundësish profesionale janë të hapura ose të mbyllura-për njerëzit me paaftësi?

★ Hulumtoni çështjen nëse, dhe si, njerëzit me paaftësi krijojnë grupe ose punojnë me organizata joqeveritare për të promovuar të drejtat e tyre. Në shumë vende në Europën lindore, për shembull, njerëzit me HIV dhe AIDS kanë krijuar shoqatat e tyre, si për të gjetur një mënyrë për të mbështetur njëri tjetrin, po ashtu edhe për të ushtruar presion ndaj qeverisë e shoqërisë për të pranuar nevojat e tyre. Në disa zona njerëzit me paaftësi mendore e fizike, dhe familjet e tyre, kërkojnë mundësi më të madhe për një kurim efikas. Shihni se çfarë ndodh në rajonin tuaj.

★ Sigurohuni që dini se për çfarë po flisni. Për shembull, nëse po shkruan për njerëz me HIV, sigurohuni që e kuptoni ndryshimin midis infektimit me HIV dhe të paturit të AIDS. Sigurohuni që kuptoni si transmetohet HIV-i-dhe si nuk transmetohet. Gazetarët kanë një mundësi të mrekullueshme për të informuar njerëzit, por ata kanë po ashtu edhe përgjegjësi që të mos i keqinformojnë ata.

★ Për një gazetar ka ndryshim midis ndjenjës së keqardhjes për njerëz me paaftësi dhe mëshirës për ta. Nëse ndjen keqardhje, kjo do të thotë se i respektoni si individë sepse ke folur me ta, ke kaluar kohë me ta, ke ndjekur jetën e tyre nga afër. Mëshira është shpesh e lidhur me faktin që ju mendoni se i dini nevojat e tyre më mire se ata vetë. Nëse mendimi yt për njerëzit me paaftësi mbështetet në opinionin e njerëzve, e jo në atë të vetë të paaftëve, ka shumë të ngjarë që të ndjeni mëshirë dhe nuk jeni ende të përgatitur të shkruani për çështjet e tyre.

★ Për shkak se njerëzit e paaftë shpesh fshihen nga shoqëria, mund të jetë e vështirë që të gjenden njerëz prej tyre për të biseduar. Qëndrimi më i mirë është të kontaktohen grupet dhe OJQ-të që i përfaqësojnë ata. Flisni me organizatorët për të arritur një kuptim të përgjithshëm lidhur me shqetësimet e tyre dhe kërkojuni atyre t'ju vënë në kontakt me disa prej anëtarëve. Gjithashtu duhet të siguroheni të flisni me të tjerë që nuk janë të përfshirë në grup, të cilët mund të kenë një mendim të ndryshëm ose shumë të drejtëpërdrejtë.

★ Shpesh është e vërtetë që stereotipet kanë një element të së vërtetës. Mund të ketë shumë lypës ose të pastrehë ndërmjet atyre që nuk kanë gjymtyrë, por ajo ka shumë të ngjarë të jetë sepse shoqëria nuk u ofron atyre ndonjë zgjidhje tjetër. Drogmenët kanë më shumë mundësi të infektohen nga HIV, por kjo mund të ndodhë sepse ata nuk dinë si të mbrohen nga infeksioni ose nuk kanë mundësi të kenë gjilpëra të pas-tra. Arsyet e krijimit të shoqatave shpesh kanë rrënjë të thella në problemet e shoqërisë vetë dhe fajësimi i vetë njerëzve nuk është roli i gazetarit.

Raste për studim

Ky është një artikull i rëndësishëm, sepse ai merret me çështje që shpesh anashkalohen në media. Merret me respekt me të paaftët dhe i trajton seriozisht shqetësimet e tyre. Gjithashtu interviston si përfaqësues të të paaftëve ashtu edhe të qeverisë. Megjithatë artikulli përfshin edhe lapsuse gazetareske dhe ngre disa pyetje të cilave nuk i përgjigjet. Për shembull, cilët janë konkretisht të paaftët që përmenden në artikull? A janë ata vetëm të paaftët fizikisht, apo edhe të paaftët mendërisht? A janë ata njerëz që kanë sëmundje natyrale, apo janë shumë që kanë pësuar ndonjë dëmtim gjatë luftërave të viteve 1990-të?

6. a) **Të paaftët jetojnë mes nesh, jo të ndarë nga ne**

Beograd – Të paaftët në Serbi praktikisht nuk janë në gjendje të lëvizin e të ndërveprojnë me njerëzit e tjerë, ndërkohë që sistemi i tanishëm arsimor i kufizon ata në disa punë të caktuara që korrëojnë pak training. Serbia nuk është toka e premtuar për njerëzit e paaftë. Me fjalë të tjera, edhe Beogradi, kryeqytet i Republikës Federative të Jugosllavisë, nuk ofron kushte që do të lejonin njerëzit e paaftë të gëzonin të njëjtën cilësi jete si njerëzit e tjerë. Nuk ka ndërtesa qeveritare me hyrje ose ashensorë për të paaftët dhe sistemi i papërshtatshëm i transportit i qytetit u jep atyre pak mundësi për të lëvizur.

Në Shoqatën serbe të Studentëve të Paaftë i thanë *Beta-s* se integrimi i plotë social i të paaftëve do të kërkonte eliminimin e të gjitha paragjyqimeve dhe ngritjen e ndërgjegjshmërisë sociale për njerëz të tillë, si edhe miratimin e disa ligjeve.

Koordinatori i shoqatës, Vladimir Chuk, thotë se ka rreth 150,000 njerëz të paaftë në Beograd, por Kompania e Transportit e Qytetit ka vetëm katër vagonë me mundësinë për të transportuar karriket me rrota, ka vetëm pak vende me sinjale rruge me zë në qendër të qytetit, ndërkohë që “paradoksi” i disa ndërtesave publike është se kanë vende kalimi për ta të pasuar me shkallë...

“Kur studentët me karrike me rrota duan të marrin pjesë në leksione, ata menjëherë përballen me një sërë vështirësish. Për shembull, ashensori shpesh është jo në funksionim dhe nëse munden të shkojnë

Ky titull është efikas sepse menjëherë e bën të qartë se qendra e vëmendjes së artikullit është për nevojat që duhet t'i ofrohen të paaftëve për t'i dhënë mundësinë të integrohen në jetën e përditshme të komunitetit.

A duhet të mendojmë se edhe vetë Chuk është i paaftë? Nëse po, në ç'mënyrë? Çfarë problemesh ka patur ai? Çfarë diskriminimi ka ndjerë ai? Kjo do të ndihmonte për të personalizuar shkrimin dhe do t'i lejonte lexuesit të ndjenin keqardhje për dikë. Përndryshe të paaftët mbeten thjesht një statistikë.

në Universitet ata duhet të bisedojnë se çfarë do të bëjnë, sepse ka pak vende kalimi për ta dhe disa salla leksionesh ende nuk kanë një infrastrukturë të tillë që të lejojnë karriket me rrota,” vazhdon Chuk.

Ai shton se “teksti i fundit në Braille u botua më shumë se 10 vjetë më parë, se Serbia nuk ka qendër trainimi për qentë udhërrëfyes, ose ndojë institucion që do të ofront ndihmë personale për të paaftët.”

Chuk dhe anëtarët e tjerë të shoqatës mendojnë se përmirësimi i kushteve të jetesës për të paaftët nuk do të kërkojë domosdoshmërisht shpenzime të mëdha.

“Sinjalet e trafikut me zë kushtojnë më pak se 10 marka gjermane, pjesët ndihmëse të trotuareve kushtojnë asgjë, ashensorët e përshtatur me butona të posaçëm për të verbërit janë të lirë, ndërsa ndihmësit personalë mund të punojnë edhe mbi baza vullnetare si në Belgjikë,” sugjeron Chuk.

Ai mendon se miratimi i ligjeve të reja është më urgjentja. Sistemi duhet të njohë nevojat e posaçme të njerëzve të paaftë dhe të fillojë të ndër-marrë ndryshimet e domosdoshme në shoqëri.

Chuk vë në dukje se Ligji ekzistues për Arsimin e Mesëm e të Lartë nuk përmban termin “person i paaftë” dhe se kjo do të ishte thelbësore nëse mendohet që e drejta për arsimim është e barabartë për të gjithë.

Një prej problemeve më të mëdhenj në system është se shkolla të veçanta, të cilat, sipas anëtarëve të shoqatës, nuk ekzistojnë në botën e zhvilluar, ndërsa këtu janë ato që do të përcaktonin fatin e njerëzve të paaftë.

“Autoritetet përkatëse rekomandojnë shkolla të posaçme për studentët e paaftë dhe ata pastaj bëhen berberë, portierë ose operatorë telefonash”, thotë Chuk, duke shtuar se kjo bën më shumë “getoizimin” e të paaftëve.

Duke theksuar se kjo shoqatë, e cila ndihmon njerëzit me të gjitha llojet e paaftësive, është kundër shkollave të posaçme, ai vë në dukje se “shkollimi në shtëpi për të paaftët funksionon edhe më keq dhe për të nuk ka një program të përshtatshëm”.

Nëse fëmijët e paaftë kanë mundësi të ndjekin shkollat e rregullta ata do të zhvillonin aftësitë e tyre deri në maksimum dhe do të merrnin pjesë aktive në jetën e komunitetit, thotë Chuk.

A është kjo diçka me të cilin atij i është dashur të merret?

◀ Nëse jo, do të ishte mirë që gazetari të gjente dikë për ta përshkruar, në terma më personalë, se si ndjehet kur përballlet vazhdimisht me këto lloj problemesh.

◀ A ka kontrolluar gazetari që këto deklarata janë të sakta? Nëse jo, përse jo? Ata që mbrojnë këtë çështje shpesh e tejkalojnë masën kur flasin për rastin e tyre. Edhe nëse shkaku është i mirë, gazetari përsëri duhet t'i verifikojë të gjitha pretendimet, veçanërisht një kaq përfshirës sa ky.

◀ Përsëri, këto pretendime duhet të verifikohen. S'duket aq e thjeshtë që të rregullosh trotuaret; nuk do të kushtonte asgjë. Dhe me siguri që instalimi i sinjaleve me zë të trafikut kushtojnë më shumë se sa thotë gazetari.

Përveç arsimimit, çfarë ligje të tjera të reja do të donte ai të bëheshin? Elementët specifikë do të ishin të dobishëm në këtë pikë. Edhe në qoftë se ligji për arsimin nuk përmend njerëzit “e paaftë”, çfarë të drejtash do të garantonte ai?

◀ Është mirë që gazetari ia atribuon këtë pretendim drejtpërdrejt shoqatës, por është gjithashtu krejt e pasaktë dhe nuk duhet të përsëritet pa u cilësuar më tej. Vendet e zhvilluara shpesh kanë shumë shkolla të posaçme për të paaftët, në varësi të paaftësisë së tyre. Nëse gazetari do të thotë se të paaftët në shumë vende të zhvilluara nuk detyrohen automatikisht të ndjekin shkolla të specializuara e jo ato të zakonshmet, atëherë kjo është një çështje tjetër.

Chuk thekson se Ligji ekzistues për Arsimin e Mesëm e të Lartë nuk përmend “njerëzit e paaftë” dhe ligjet e tjerë që e përmbajnë këtë term nuk merren shumë parasysh.

“Pengesat arkitekturale mund të kapërcehen nëse leksionet që do të ndiqeshin nga një person do të zhvilloheshin në katin përdhës, por kjo varet nga drejtori i shkollës,” Chuk shpjegon.

Duke menduar se paragjykimi është problemi më i vështirë, Chuk thotë se shoqata shpreson se fushtat e zhvilluara prej saj do të ndihmojnë njerëzit e paaftë të integrohen në shoqëri.

“Shumë probleme janë rrjedhojë e injorancës dhe indiferencës. Unë nuk mendoj se njerëzit i shkaktojnë ato me qëllim,” thotë Chuk, duke shtuar se shoferët e taksive ndonjëherë duan që të paguhet edhe për karrocën siç bëjnë edhe për bagazhin, se kamarierët ndonjëherë nuk pranojnë të ndihmojnë një të paaftë sepse “nuk është puna e tyre” dhe ndoshta profesorët e universitetit duhet të kujtohen kur kanë një student shurdh kur japin leksion me qëllim që t’i lejojnë atij të kuptojë përmes leximit të buzëve”.

Për më tepër, shoqata pati probleme për të gjetur vend për zyra, sepse njerëzit nuk pëlqenin t’i jepnin ato me qera pasi mësonin se për çfarë do të përdoshin. Shumica e hoteleve nuk pranojnë të organizojnë një konferencë ndërkombëtare për njerëzit e paaftë, ndërsa restorantet nuk lejojnë qentë udhërrëfyes në mjediset e tyre, vë në dukje Chuk.

“Një prej anëtarëve tanë, Marko, mundi të bindte Kishën e Virgjëreshës Meri në Zemun të rregullonte një kalim, që më pas u hoq nga Zyra për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore,” thotë Chuk, duke shpjeguar se njerëzit që përdorin karroca nuk kanë mundësi të shkojnë në kishat e Beogradit.

“A janë shkallët monumente?” pyet Chuk, duke shtuar se rrënojat e Carthage janë plot me kalime për karroca.

Ministritë përkatëse serbe janë dakord që njerëzit e paaftë janë në një pozitë të vështirë dhe se integrimi i tyre i plotë social është praktikisht i pamundur. Ata janë dakord me faktin që gjithnjë e më pak njerëz të paaftë shihen në rrugët e Beogradit në krahasim me qytetet e tjera europiane dhe se së bashku me pengesat teknike

◀ Përsëri, cilët ligje merren me çështjet e të paafteve? Çfarë thonë ato konkretisht?

Kur u zhvillua kjo konferencë ndërkombëtare? Sa morën pjesë në të? Cilët ishin ata dhe nga vinin? Cili ishte qëllimi i konferencës? Cilat ishin rezultatet? Meqë duket sikur kjo ka qënë një ngjarje e rëndësishme, do të ishte mirë të përmendeshin disa detaje. Veç kësaj, me sa hotele u bisedua lidhur me mbajtjen e saj në to? Sa hotele u kontaktuan? Çfarë thanë ata konkretisht? Do të ishte mirë nëse gazetari do të merrte në telefon një apo dy hotele që Chuk tha se refuzuan të organizonin konferencën e t’i pyeste lidhur me këtë.

◀ Gazetari duhet të lidhet si me Markon ashtu edhe me zyrtarët e kishës në Zemun për të gjetur se çfarë ndodhi e të mos raportojë në bazë të të tjerëve.

◀ A është e vërtetë që rrënojat e Carthage kanë vendkalime për karroca? Gazetari duhet ta kontrollojë këtë pretendim nëse është i saktë.

paragjykimi mbetet një problem i madh.

Pas ndryshimeve të tetorit ministritë përkatëse kanë ndërmarrë fushata për integrimin e njerëzve të paaftë. Megjithatë realizimi i këtyre ideve ka nevojë për fonde, të cilat qeveria nuk i ka.

Ministria serbe për Arsimin dhe Sportet ka nisur një projekt të quajtur “bëni një vendkalim”, i cili, siç thonë zyrtarët, “duhet të jetë një hap i vogël fillestar që duhet të tregojë se përmirësimi i jetës së njerëzve të paaftë është i mundshëm dhe duhet të bëhet.”

Ministria e Arsimit ka planifikuar gjithashtu një përpjekje të përbashkët me Ministrinë e Punës e të Mirëqënies që ka për qëllim të përmirësojë pozitën e të paaftëve dhe të përpunojë një strategji afatgjatë pesë deri në dhjetëvjeçare, thotë Ana Vlajkovic, korrodinatorja e projektit “bëni një vendkalim” në Ministrinë e Arsimit.

Ana Vlajkovic shpjegon se hapi i parë do të jetë të përshtaten ndërtesat e universitetit që përdoren më shumë nga studentët, si libraria dhe qendrat e kompjuterave, dhe kjo do të pasohet në ndërtesat e tjera të universitetit, që duhet të marrë parasysh edhe ndërtimin e vendkalimeve dhe përshtatjen e ashensorëve.

Ajo vë në dukje se vetëm Departamenti i Filozofisë i Universitetit të Beogradit është i përshtatur për nevojat e studentëve të paaftë, por edhe ai nuk ka një tualet të posaçëm.

Ana Vlajkovic shton se “Beogradi ka vetëm dy vende me tualetë për të paaftët, një kafene dhe hoteli “Hyatt”.”

Në punën ndërtimore duhet t’i kushtohet vëmendje departamenteve që kontribuojnë për trainimin më të mirë dhe punësimin e njerëzve të paaftë, ndërsa ministria do të nxisë shkollat dhe universitetin të organizojnë mësimin në një mënyrë të tillë që do të lejonte studentët e paaftë të merrnin pjesë në kurse që do të zhvilloheshin në katet përdehës.

Ana Vlajkovic vë në dukje se puna ndërtimore në shkollat e fillore dhe të mesme do të kërkojë më shumë fonde, sepse ato janë në një gjendje më të keqe dhe se do të duhen disa vite punë dhe investime për to.

Ministria serbe e Punëve Sociale kohët e fun-

◀ Cili zyrtar e tha këtë? Gazetari duhet të citojë një individ të veçantë. Nëse ky është citim nga një deklaratë zyrtare e ministrisë, kjo duhet të thuhet nga gazetari.

Në ç’mënyrë është përshtatur ai? Përse ka ndodhur një gjë e tillë në Departamentin e Filozofisë dhe jo në departamente të tjerë?

◀ Mund të jetë e vërtetë, por edhe mund të mos jetë. Do të ishte më mirë të theksohej se Vlajkovic “mendon” se ka vetëm dy vende të tillë, gjë që i sinjalizon lexuesit se ka mundësi që kjo të mos jetë kaq e saktë.

◀ Cilat janë këto departamente që do të ndihmonin për një trajnim më të mirë dhe punësim të njerëzve të paaftë?

dit organizoi një fushatë mediatike të quajtur “Jeta pa Pengesa”.

Mesazhi i fushatës ishte se të paaftët jetonin me ta, jo të ndarë prej tyre, shpjegon zëvendësministria Danica Todorovic.

Ajo thekson nevojën për të shkatërruar pengesat që kemi “në kokat tona” si edhe “paragjykimin në ndërgjegje” që shtyjnë indiferencën në përgjithësi për të paaftët.

Danica Todorovic thotë se ministria e saj i ka dhënë përparësi masave që synojnë të ndihmojnë për të patur një jetë të pavarur dhe të ndihmojë familjet e tyre në kuadrin e reformave të mirëqënies sociale.

Një jetë e pavarur për të paaftët do të thotë fonde që mund të përdoren prej tyre, përmirësimi i pozitës së tyre me mjete jointucionale, shkatërrim i pengesave fizike që i pengojnë të lëvizin përreth, futja e ndihmëtarëve personalë për të paaftët, krijim i kushteve për një arsimim normal dhe për zhvillimin e të gjithë formave të mirëqënies, vë në dukje Danica Todorovic.

Ajo ankohet se ministrisë i mungojnë fondet e stafi, por shton se kjo nuk është arsye për të ndaluar reformat dhe se mund të gjenden zgjidhje alternative.

Si të paaftët ashtu edhe zyrtarët shtetërorë janë të mendimit se pozita e njerëzve të paaftë është jashtëzakonisht e keqe. Të paaftët po përpiqen shumë të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre përmes shoqatave dhe fushatave, ndërsa zyrtarët shtetërorë thonë se janë të gatshëm të ndërmarrin e të marrin pjesë në procese të tilla. Ka shumë vullnet të mirë, por jo fonde. Ndryshimet e kërkuara janë shumë të shtrenjta, ashtu si edhe në të gjithë vendet e tjerë në tranzicion.

Pasi të zgjidhen çështjet shtetërore më të mëdha, do t’u vijë koha edhe atyre më të vogla, shpresohet. Ndërkohë njerëzit e paaftë do të vazhdojnë paragjykimin social dhe do të ndërgjegjësojnë njerëzit e medias, të atyre në rrugë me fushata educative. Procesi duhet të përfshijë edhe faktin që shumica e të paaftëve të jenë të ndërgjegjshëm se kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjithë aktivitetin social.

Beta/MDI, Beograd/Londër, 18 janar 2002.

◀ Si u bë kjo fushatë? Tabela? Reklama televizive?

◀ Cilat janë konkretisht këto paragjykime? Artikulli nuk i specifikon kurrë. A është e thënë që të paaftët nuk duhet të punojnë? Që nuk duhet të shihen në publik? Do të ishte mirë që artikulli të përfshinte dikë që do të shprehte mendimin e atyre që kanë paragjykime.

◀ Kjo është në kundërshtim me vlerësimin e mëparshëm të Chuk që disa prej ndryshimeve kërkojnë shumë pak para. Cila është e saktë?

◀ A ka të paaftë që nuk e kuptojnë se ata i gëzojnë këto të drejta? Ndoshta gazetari duhet të intervistojë disa prej tyre. Ky paragraf i fundit nisët nga qëllime të mira, por është një deklaratë editoriale e nuk mbështetet në një informacion të raportuar në mënyrë objektive.

Ky shkrim lidhet me një incident me një gjuhë krejtësisht të papërgjegjshme të përdorur në një artikull lidhur me një zjarr në një spital psikiatrik. Titulli-”Të çmendurit e Pjekur”-jo vetëm luan me stereotipet për ata që vuajnë nga sëmundje mendore, por edhe teknikisht është i pasaktë, pasi asnjëri nuk u dëmtua nga flakët.

6. b) Të çmendurit e pjekur

Botuesi kërkon falje për titullin

Botuesi i një gazete tabloid në një qytet kërkoi falje në numrin e së martës për një titull të një shkrimi në gazetë lidhur me një zjarr të kohëve të fundit në një spital psikiatrik.

Shkrimi në Trentonian për një zjarr në 9 korrik në ndërtesën administrative të Spitalit Psikiatrik të Trentonit doli nën titullin “Të çmendurit e Pjekur.” Në ndërtesë nuk pati pacientë dhe asnjëri nuk u dëmtua.

Në një editorial të firmosur, botuesi David B. Bonfield e quajti atë një “titull të ashpër, të pamenduar që mizorisht fliste për sëmundjen mendore. Për më tepër, ai ishte i pasaktë.”

Bonfield vuri në dukje se lexuesit e së përditshmes me një tirazh prej 47,526 e kishin përmbetur gazetën me telefonata ankimore dhe letra për redaktorin.

“Kjo gazetë është krenuar gjithnjë se ka mbështetur të pafuqishmit kundër të fuqishmëve – një stil që e bëri të fitojë çmimin lidhur me disa shkrime për korrupsionin politik në New Jersey. Nuk duhet të na befasojë përse lexuesit tanë mbështetën të pafuqishmit – kundër nesh – dhe prandaj e meritojmë. Dhe ja ku i kemi. Të gjitha goditjet,” shkruante Bonfield.

Ai tha se gazeta do të “përpiqej të bënte rregullime jo thjesht duke qënë më e ndjeshme ndaj fatkeqësisë të të sëmurve mendore, por duke u bërë një mbështetëse agresive për interesat e tyre.”

Autori i titullit, Tony Persichilli, kishte kërkuar më parë falje në gazetë një ditë më pas botimit. Redaktori i kolonës dhe korrektues shkruajti se titulli ishte i pasaktë dhe i pandjeshëm dhe mori përgjegjësinë e plotë.

Duke kërkuar falje për incidentin, botuesi pranon se sa fyese është gjuha e përdorur dhe menjëherë iu përgjigj ankesave si nga lexuesit ashtu edhe nga organizatat që përfaqësonin të paafëtë mendore. Veprimi i tij është një provë se organizatat e mediave ndonjëherë reagojnë ndaj presionit të publikut dhe kjo është arsyeja përse ato duhet të jenë të përgjegjshme për lapsuset në gjykim.

◀ Duke tërhequr vëmendjen tek një incident i këtij lloji mund, në fund të fundit, të jetë me përfitim për të gjitha palët. Organi i medias mund të detyrohet të jetë më i përgjegjshëm në raportimin e çështjeve të ndryshme, që nga ana e saj ndihmon publikun të marrë më pak informacion të njëanshëm lidhur me çështje sociale të rëndësishme.

Por Alenaca Kombëtare për të Sëmurët Mendorë tha javën e kaluar se kërkesa për falje nga ana e Persichillit nuk ishte e përshtatshme, raportoi Philadelphia Inquirer. Grupi tha se titulli ishte “një prej shembujve më të këqinj të paragjyimit institucional e diskriminimit me sa mund të kujtohej kohët e fundit” dhe bëri thirrje për “veprime afirmuese dëmshpërblyese.”

The Associated Press, Trenton, N.J., 23 korrik 2002.

◀ Organizatat joqeveritare mund dhe duhet të luajnë një rol kryesor në dokumentimin e njoftimeve jo të ndjeshme, duke ushtruar presion ndaj operatorëve të lajmeve dhe duke nxitur publikun t'i kushtojë vëmendje çështjeve të tilla. Gazetarët dhe redaktorët duhet ta pranojnë se grupe të tilla mund të jenë një burim shumë i vlefshëm këshillimi lidhur me mbulimin e komuniteteve të pakicave të gjitha llojeve.

7. Grupet shoqërisht në disavantazh

Grupet shoqërisht në disavantazh

Në shoqëritë komuniste grupet shoqërisht në disavantazh, si drogmenët, të burgosurit, të pastrehët e të papunët zyrtarisht ose nuk ekzistonin ose konsideroheshin si armiq të shtetit. Si rrjedhojë, jeta, shqetësimet e problemet e tyre nuk konsideroheshin si me interes dhe mbeteshin të pazbuluara nga media, sikur mbulimi i tyre do të mund t'u jepte atyre njëfarë legjitimiteti dhe do të gjeneronte simpati për fatkeqësinë e tyre.

Megjithatë që prej asaj kohe është bërë e qartë se shpërfillja e pranisë së grupeve të tillë është një e metë për shoqërinë. Çdo shoqëri që më parë e konsideronte veten si të imunizuar nga të këqijat sociale që shoqëroheshin me kapitalizmin kanë zbuluar se padituria e qëllimtë bën shumë pak lidhur me zhdukjen e problemeve të ndërlikuara. Në fakt, prania e një numri të madh qytetarësh në disavantazh sugjeron të kundërtën: që duke pretenduar se diçka nuk ekziston në fund të fundit veçse i keqëson gjërat.

Më poshtë janë disa mënyra për të përmirësuar mbulimin e grupeve shoqërisht në disavantazh:

- ★ Identifikoni cilat grupet në disavantazh ndodhen në qytetin apo rajonin tuaj. A keni ndonjë problem të veçantë lidhur me papunësinë për shkak se një fabrikë aty pranë u mbyll? A ka ndonjë numër shumë të madh të pastrehësh për shkak të shkatërrimit të pronave nga konflikti ose ndonjë arsye tjetër? Po veteranët e luftërave rajonale? Po drogmenët? Atëhere shqyrtojini si-ose edhe nëse-organi juaj i medias i ka mbuluar këto grupe, vlerësoni materialin dhe përcaktoni se çfarë ka mbetur e pambuluar.

- ★ Sigurohuni që të intervistoni të papunë, drogmenë, pjesëmarrës në luftë e të tjerë për të cilët po shkruani. Anëtarët e grupeve në disavantazh zakonisht dalin në media, nëse dalin, të lidhur me krimin dhe, shumë shpesh, as nuk intervistohen. Në përgjithësi zyrtarët e drejtësisë dhe “ekspertë” të tjerë lejohen të paraqesin pa sfide mendimin e tyre. Dhe për shkak se edhe gazetarët kanë të njëjtat mendime për këto stereotipe, ata thjesht mund t'i transmetojnë tek lexuesi pa i cilësuar.

- ★ Kontaktoni organizatat joqeveritare, misioni i të cilave është të ndihmojnë të papunët, drogmenët, të pastrehët e anëtarë të tjerë të grupeve shoqërisht në disavantazh. Mbajini këta njerëz si burime të besueshme. Inkurajojini ata t'ju tregojnë historitë e tyre. Pyetini se cilat janë çështjet kryesore për të cilat po punojnë. Kërkojuni t'ju rregullojnë takime me anëtarët e grupeve që ata mbështesin.

- ★ Kur intervistoni të papunët, drogmenët e të tjerë, mos i kufizoni pyetjet vetëm në këto tema. Përpiquni të merrni një vështrim të përgjithshëm të jetës së tyre, të zbuloni se për çfarë kanë pasion. Pyetini për interesat, hobit, pjesëtarët e familjeve të tyre, sendet apo kafshët që pëlqejnë të përkëdhelin, çdo gjë që mund t'ju bëjë të ndjeni keqardhje për gjendjen e tyre dhe jo t'i konsideroni vetëm përmes prizmit të të metave

apo disavantazheve. Përpiquni të paraqisni se cilët janë ata si njerëz të vërtetë, me histori të pasura dhe me pjesë të ndërlukuara të jetës së tyre të brendshme e jo thjesht si përfaqësues të një grupi shoqërisht të privuar.

★ Shqetësimet sociale shikojini nga ky këndvështrim. Nëse mania për drogë është bërë problem kohët e fundit, eksploroni faktorët që kanë çuar tek ajo. Rënia ekonomike? Mundësia më e madhe për të patur narkotikë? Nëse papunësia është në rritje, përpiquni të zbuloni përse. A po mbyllen fabrikat? A ka patur rënie në eksport? Nëse je duke shkruar për ish-të dënuar që kryejnë përsëri krime, eksploroni sa e lehtë ose sa e vështirë është që ish-të burgosurit të gjejnë punë. Gjithashtu ajo do t'i ndihmojë lexuesit të kuptojnë gjendjen e të tjerëve nëse atyre u paraqitet një pamje e plotë e ngjarjeve.

★ Profilizoni një anëtar të këtyre grupeve i cili ka bërë diçka të vështirë ose të jashtëzakonshme. A ka mundur dikush, i cili nuk ishte në gjendje të gjente punë, të arrijë shumë e të bëhet i suksesshëm në një fushë tjetër? A ka hequr dikush dorë nga droga dhe ka krijuar një organizatë për të ndihmuar të tjerët që ndodhen në të njëjtën pozitë si ai? A është reformuar plotësisht një ish-i burgosur dhe tani ka arritur të njihet si artist?

★ Është e domosdoshme të kalohet kohë me njerëzit për të cilët po shkruan, megjithëse kjo nuk do të thotë që duhet të pranosh çdo gjë që ata thonë. Natyrisht që do të dëgjosh shumë historira depresive prej tyre, por nëse nuk konfirmon të vërtetën për secilën prej tyre në shkrim duhet ta bësh të qartë që këto tregime i takojnë si burim personave që ke takuar. Për shembull, nëse një drogmen thotë se ai përdor vetëm një herë në javë, duhet ta raportosh se ai thotë që merr drogë vetëm një herë në javë, pasi nuk mund të jesh i sigurt nëse ajo është e vërtetë apo jo. Nëse një i papunë thotë se nuk është pranuar në 10 vende pune, duhet ta thuash që vetë i papuni tha që nuk është pranuar në 10 vende pune e jo se ajo ka shkruar atje.

Raste për studim

Ky artikull merret me një çështjen të rëndësishme, por ka shumë pak të dhëna specifike. Natyrisht që veteranët kanë vështirësi, por nuk mësojmë fare se cilat janë këto vështirësi.

7. a) **Veteranët e luftës në gjendje alarmuese: një vetëvrasje në ditë**

◀ Ky është një titull i goditur sepse është një statistikë e tillë kaq tërheqëse.

Më e fundit u krye nga Faik Delalic, president i Organizatës së Veteranëve të Çmobilizuar të Tuzlas.

Çdo ditë në Federatën e Bosnie Hercegovinës një ose dy luftëtarë të çmobilizuar vrasin veten.

◀ Sa veteranë ka në përgjithësi? Do të ishte mirë të dihej.

Të dhënat mbështeten në një shkëmbim informacioni midis Organizatave kantonale të Veteranëve të Luftës, thotë Nijaz Hodzic, president i Organizatës së Veteranëve të Çmobilizuar të Tuzlas.

◀ Këtu ka konfuzion sepse artikulli thotë se personi që vrau veten ishte president i grupit të Tuzlas. Po ky person e mori këtë post pas vdekjes së Delalic?

Vetëvrasja e fundit u krye nga Faik Delalic, emri i të cilit Hodzic përmendej shpesh me përkushtim – anëtarët e Organizatës së Tuzlas e thërrisnin atë “Baba.”

◀ Kur e kreu vetëvrasjen ai?

Pas kthimit nga gjyqi i një prej luftëtarëve të akuzuar se kishte dëbuar me forcë banorët nga shtëpitë e tyre, ai shkroi një mesazh lamtumire- “Më falni, nuk duroj dot më”-dhe pastaj i dha fund jetës.

◀ Si e vrau veten? A ka më shumë informacion lidhur me të? A kishte depresion? Si ishte gjendja e tij personale? A ka lënë njeri pas?

Veteranët e çmobilizuar nuk u kërkojnë më shumë autoriteteve dhe popullit të Bosnie Hercegovinës se sa vendin e tyre në shoqëri të cilin e meritojnë, ky është mesazhi i konferencës të posaçme të shtypit të mbajtur nga Organizata e Veteranëve të Çmobilizuar të Luftës Mbrojtëse dhe Çlirimtare 1992-95.

◀ Kur u mbajt kjo konferencë shtypi? Dje? Javën e kaluar? Dhe ku u mbajt? Cili ishte i pranishëm?

Presidenti i saj, Mehmed Focic, thotë se Partia e Aksionit Demokratik e humbi pushtetin sepse nuk mundi të kalonte ligje që do t’u siguronin veteranëve nevojat e tyre bazë. “Si një makineri e fuqishme elektorale, ne kontribuam për ndryshimin e qeverisë,” tha Focic. “Autoritetet e

Cilat janë nevojat e tyre? Cilat janë kërkesat e tyre? Në çfarë kushtesh ndodhen? Do të ishte mirë të përfshihej ndonjë informacion se si jetojnë ata tani dhe një ose dy intervista me veteranë. Veç kësaj, do të ishte mirë të flitej me analistë politikë ose vëzhgues të zgjedhjeve për t'i pyetur nëse pakënaqësia ndërmjet veteranëve çoi me të vërtetë në humbjen e partisë, siç pretendon Focic.

Cili është reagimi i ministrit për këto akuza?

pazonja nuk kanë bërë shumë për popullsinë veterane,” shtoi Focic.

Veteranët janë veçanërisht të zemëruar me Ligjin për Invalidët e Luftës dhe të Afërmit e të Vrarëve, sepse, sipas Focic, ai mohon arritjet e luftës ndërkohë që nuk përmend fare veteranët e çmobilizuar.

Organizata e veteranëve fajëson autorin e ligjit, ministrin për Çështjet e Veteranëve në qeverinë e Federatës së Bosnie Hercegovinës, Suada Hadzovic, dhe bën thirrje për “largimin e ministrit arrogant e të paaftë të çështjeve të veteranëve.”

Ajo paralajmëron Aleancën për Ndryshim ashtu siç bëri edhe me Partinë e Aksionit Demokratik se duhet të mbajë parasysh interesat e veteranëve dhe jo vetëm të tyre, ose përndryshe nuk do të qëndrojnë në pushtet për një kohë të gjatë. Gjithashtu ata shfrytëzuan mundësinë t'i uronin të gjithë qytetarëve, veçanërisht mbrojtësve të vendit, Ditën e Shtetësisë.

◀ Çfarë thotë ligji? Si i mohon ai arritjet e luftës? Çfarë ligji do të propozonin veteranët në vend të tij? Sa veteranë janë të paaftë për shkak të dëmtimeve në luftë?

◀ Çfarë thonë njerëzit e tjerë lidhur me kërkesat e veteranëve? A ka ndonjë grup që i kundërshton ose se mendon që kërkesat e tyre janë të paarsyeshme?

Oslobodjenje, Sarajevë,
25 nëntor 2001.

Ky artikull ofron një portret simpatik të drogmenëve që e kanë marrë veten duke i portretizuar si punëtorë dhe që dëshirojnë të ndër marrin hapa të guximshëm për të kapërcyer problemet e tyre. Gazetari ka bërë një përpjekje të vërtetë duke intervistuar disa prej tyre dhe duke paraqitur opinionin e tyre me qëllim që arrihet të kuptohet një gjë e tillë. Megjithatë shkrimi lë shumë pyetje pa sqaruar dhe përsëri paraqet një portret pak a shumë naiv se si zhvillohet mania e drogës dhe se si duhet të merren me të. Do të ishte mirë të futej më shumë informacion se çfarë bën ky trajtim më me saktësi. A ka psikologë, mjekë e administratorë që vëzhgojnë të strehuarit? Apo drogmenët janë banorët e vetëm? Shkrimi asnjëherë nuk e bën atë të qartë.

7. b) Për disa njerëz bashkësia e drogmenëve është një ishull shpëtimi

Njerëzit vijnë këtu vullnetarisht. Për më tepër, për të qëndruar këtu ata duhet të nënshkruajnë një marrëveshje, e cila ndalon të gjitha materialet psikotropike, kafënë, Coca-cola, pije alkoolike, cigare dhe para. Ata nuk mund të shohin as televizor, të dëgjojnë radio ose të lexojnë gazeta. Faktikisht lejohet shikimi i e televizionit, por vetëm një herë në muaj.

Anëtari më i ri i komunës është 16 vjeç, më i vjetri 30 vjeç. Emri i tij është Bisser dhe ai është shefi i banorëve. Ai ndodhet këtu prej dy vjetësh, pothuaj që nga fillimi i qendrës. Anëtari më i ri mbërriti një ditë më parë dhe më i varuri nga droga është një djalë i gjatë me flokë me bisht. Vetëm 10 ditë më parë kur e sollën prindërit ai me zor ecte. Qëndroi në krevat dhe megjithatë dy herë kapërdiu gjuhën dhe për të duhej të tregohej kujdes sikur të ishte fëmijë. Asnjëri nuk e pyeti si ndjehej pasi të gjithë e dinin shumë mirë. Fakti inkurajues ishte se tani ai mund të ecte, madje edhe të punonte.

Ajo që i bashkon banorët e komunës është se të gjithë janë drogmenë. Të gjithë e kanë nisur rastësisht, me idenë që thjesht ta provonin njëherë. Të gjithë kishin menduar se mund të hiqnin dorë njëherë, por pas dy muajsh panë se ishte tepër vonë dhe se ndërkohë ishin të mbërthyer prej saj.

Disa vjetë më parë prindërit e këtyre fëmijëve kanë qënë në gjendje të mirë. Tani të gjithë janë

◀ Është pak konfuze. A ka, apo jo, një televizor atje? Cili e kontrollon mundësinë për të parë televizor?

Sa banorë ka atje? A foli gazetari me të gjithë ata? Nëse jo, atëherë është e vështirë të thuhet se të gjithë e kanë nisur rastësisht. Se të gjithë mendonin që me kohë do të hiqnin dorë, se pas dy muajsh ata panë që qenë mbërthyer prej saj. Fjala “të gjithë” duhet të përdoret në përgjithësi kur gazetari e di se diçka mund të thuhet për të gjithë njerëzit me të cilët ka biseduar. Në kushte të tjera fjala “shumë” ose “shumica” është e preferueshme.

të varfër. të gjitha pasuritë e tyre, kursimet dhe mobiljet kanë shkuar. Për më tepër, të gjithë ata tani janë thellë në borxhe. Të gjithë kanë shkuar tek mjekët më të shquar, por më kot. Qendra është shpresa e fundit për të shmangur vdekjen.

Rreth dy vjetë më parë Vladimir Kachakliev organizoi komunën e parë për drogemenët në Belmeken, një vendndodhje në lartësi malore në Malin Rila për të shpëtuar djalin e tij. Ai përdori vetëm paratë e veta. Ai mendon se përpjekjet e tij nuk kanë qënë të kota dhe ai po ndihmon edhe fëmijët e njerëzve të tjerë. Tani në vend ka dy qendra si kjo. Ato dallohen nga cilësia e bukës-është e butë dhe e shijshme, e bërë nga vetë banorët e qendrave.

Është 6.30 e mëngjesit dhe djemtë e komunës po zgjohen. Ata që përgjigjen për gatimin zgjohen një orë më parë për të përgatitur mëngjesin. Dita fillon me disa ushtrime fizike, një dush të shpejtë dhe pastaj në punë. Dreka shërbehet në 1.15. Pastaj përsëri punë deri në 7 të mbrëmjes. Ora e darkës është 8.30 dhe fiks në 11.00 të gjithë shkojnë në krevat. Gjashtë ditë në javë, katër javë në muaj. Gjysma e së dielës është e lirë për të luajtur futboll, bodybuilding dhe libra.

Dhe të gjithë djemtë më komunë e dinë se për të arritur sukses ata duhet të jetojnë këtu një ose dy vjetë, ose edhe më shumë. Disa që menduan se ishin kuruar dhe u larguan më shpejt tani janë ndër 30,000 drogmenët që varen shumë nga droga. Ata nuk lejohen të kthehen në qendër, që është edhe një pjesë e marrëveshjes.

Njerëzit në komunë e dinë se ilaçi më i mirë është puna dhe ata vullnetarisht punojnë për më shumë se 10 orë në ditë.

V.H. është 24 vjeç dhe vjen nga Sofia. Ai filloi drogën tre vjetë më parë. që prej tetë muajsh është në komunë dhe tani ndjehet krejtësisht mirë. Megjithatë ai ende nuk është i sigurt nëse është aq i fortë sa t'i rezistojë drogës. Prandaj ai qëndron këtu duke u kulesur për rreth 40 lepuj nga Zelanda e Re. Shumicën e kohës e kalon me lepujt, i ushqen dhe i pastron, edhe i ndihmon të lindin. Këto aftësi i ka përftuar nga përvoja dhe nga librat, të cilat ai i porositi me shumë dëshirë për të mësuar sa më shumë për rritjen e lepujve.

A është e vërtetë që të gjitha familjet kanë qënë në gjendje të mirë dhe tani të gjitha janë të varfëra, të zhytura në borxhe dhe nuk kanë asnjë pasuri të mbetur? Të gjitha familjet kanë vizituar mjekët më të shquar? Duket pak si e pamundur që gazetari të dijë kushtet e familjes së çdo banori.

Këtu do të ishte një vend i mirë për të dhënë disa detaje lidhur me qendrën. Si i zhvilloi Kachakliev planet e tij? A kishte ai ndonjë përvojë në këtë fushë? A u konsultua me mjekët, psikologët, ose specialistët? Sa i kushtoi? Cili është buxheti vjetor? Sa larg fshatrave ose qyteteve ndodhet? Si është pamja e bashkësisë? Sa ndërtesa ka dhe a u ndërtuan ato për këtë qëllim apo më parë përdoreshin për diçka tjetër? Sa banorë ka në këtë dhe në qendrën tjetër? Si e matin suksesin? Sa vetë e kanë lënë qendrën dhe sa prej tyre kanë hequr dorë plotësisht nga droga? Të gjitha këto janë pyetje jetësore, por gazetari i lë jashtë këto fakte.

Ky plan i detajuar është një mënyrë efektive për të na treguar cila është jeta gjatë ditës në bashkësi. Do të ishte mirë të përfshiheshin shembuj se çfarë lloj pune bëjnë ata.

Numri 30,000 i drogmenëve i përket të gjithë vendit? Sipas kujt? A është kjo një shifër zyrtare apo jozyrtare? Përse duhet të qëndrojnë një ose dy vjetë, ose edhe më shumë? Cila është arsyeja që nuk lejohen më ata që janë larguar dhe kanë filluar përsëri të marrin drogë?

Puna është trajtimi i vetëm? A zhvillojnë edhe mbledhje mbështetëse në grup? A janë ata larg qyteteve sa që nuk kanë mundësi të fusin drogë brenda?

Është e rëndësishme që gazetari ka përfshirë V.H. dhe persona të tjerë. Por shumë pyetje mbesin pa përgjigje. Cila është jeta e tij e mëparshme? A është i arsimuar? Si dhe përse filloi të merrte drogë? Si vendosi që kërkoi ndihmë? A ka punuar më parë në bujqësi ose duke rritur kafshë? Si është pamja e tij? A duhet të paguajë që të jetojë këtu, apo e subvencionojnë?

Dobromir është po ashtu nga Sofia. Ai ndodhet në komunë që prej 14 muajsh. Punon si kuzhinier dhe bukëpjekës. “Edhe nëse nuk vazhdoj me këtë profesion kur të largohem, aftësitë që kam fituar këtu do të më duhen shumë,” thotë ai në mënyrë filozofike.

Zlatko, që është 18 vjeç, e provoi drogën për herë të parë kur ishte 11 vjeç. Kaloi në heroin në moshën 13 vjeç. Tani e kalon kohën në dhomën e bodybuilding. Atë e thërrasin “Rocky-man”. Kur erdhi në qendër dukej si skelet. Megjithatë për shtatë muaj ai ka vënë 18 kile.

Vetë banorët në komunë prodhojnë shumë gjëra që u duhen. Lepuj, pula, disa derra dhe një lopë që kohët e fundit lindi, të gjithë jetojnë në fermë. Ka edhe një dhi që e sollën prindërit e një prej djemve. Këtë dimër u vodh një derr. “U kujdesëm për të për muaj me radhë dhe ata e goditën,” ankohen djemtë.

Por ka edhe njerëz të mirë, thonë djemtë. Disa kanë ardhur e kanë sjellë mobilje dhe pajisje të tjera shtëpiake. Djemtë kanë bërë shumë që ta bëjnë jetën në komunë më të rehatshme. Ata janë krenarë për banjën, të cilën e kanë zbukuruar vetë. Ka një orar të caktuar për përdorimin e makinës së re larëse, që ishte një dhuratë e kohëve të fundit nga ana e Vladimir Kachakliev, njeriut që themeloi qendrën.

Liria e fjalës është një parim kyç në qendër. Djemtë këmbëngulin për të dhe flasin lirisht për përvojat e tyre të mëparshme, duke mos kursyer detaje të tmerrit që kanë kaluar para se të vijnë këtu. Në këtë mënyrë do të jetë më e lehtë të ndahen me jetën e tyre të mëparshme, mendojnë ata.

Prindërit e banorëve nuk lejohen të vijnë në gjashtë muajt e parë. Më pas ata mund të vijnë çdo tre muaj. Dhe pastaj ata e bëjnë gjithnjë e më shumë me dëshirë duke shpresuar se herën tjetër ata do të jenë në gjendje ta marrin fëmijën e tyre, këtë radhë njëherë e përgjithmonë.

Standart Daily, Sofia, 30 gusht 2002.

◀ A do të ishte mirë të jepej informacion për Dobromir dhe Zlatkon. Cilët janë ata? Si e nisën drogën? Si e zbuluan qendrën? A ka ndonjë kriter për t'u futur në të, apo cilido mund të vijë e të qëndrojë?

◀ Kjo deklaratë për derrin duket se kundërshton veten. Derrin u vodh apo u godit? Nëse u vodh, si e dinë banorët e bashkësisë a u godit?

◀ A krijohen grupe të organizuara për të folur për këto probleme, të drejtuar nga dikush me përvojë në trajtimin e drogmenëve? Apo gazetari po i referohet vetëm diskutimeve të thjeshta ndërmjet banorëve?

◀ Cila është arsyeja që prindërit nuk lejohen të bëjnë vizitë në gjashtë muajt e parë? Ose që lejohen të vizitojnë më pas çdo tre muaj? Cili e vendosi këtë rregull?

8. Të moshuarit dhe pensionistët

Të moshuarit dhe pensionistët

S shumë të moshuar në shoqëritë post-komuniste janë gjendur në situata të dëshpëruara. Dikur, pensionet e tyre ishin të mjaftueshme për t'u siguruar atyre të paktën një nivel bazë për mbijetesë, por me ndryshimet ekonomike dhe sociale janë detyruar që të kërkojnë mundësira për të siguruar para të tjera për të ushqyer veten. Inflacioni i ka tejkaluar kaq shumë mundësitë e tyre për të blerë mallra dhe shërbime sa shpesh ata duhet t'i drejtohen lypjes në rrugë.

Megjithëse fatkeqësia e tyre është mirë e njohur, gazetarët rrallë përqëndrohen tek ta. Kur dalin në raportet e medias duken gjithnjë si persona babushka, të kërrusur dhe të mbuluar me një rrobë të rrekosur, duke u ankuar se si gjërat tani nuk janë më siç kanë qënë më parë. Rrallë të moshuarit portretizohen si të plotë, tërheqës, luftëtarë të të drejtave të tyre, ose diçka tjetër në krahasim me pamjen e viktimave pasive të kushteve.

Më poshtë janë disa pika që mund të krijojnë një imazh më të shumëllojshëm për të moshuarit:

★ Kërkoni nëse ka ndonjë organizatë që merret me ndihmën e të moshuarve në qytetin apo rajonin tuaj. Flisni me ta për çështjet që përballen të moshuarit. Vizitoni një qendër komuniteti ose një park që frekuentohet shpesh nga të moshuarit. Pyetini ata se me çfarë çështjesh përballen. Mund të mendoni se dini gjithçka me të cilat përballen të moshuarit. Por nëse kaloni kohë duke shqyrtuar këtë çështje, do të shihni se do të çuditëni sa do të mësoni.

★ Natyrisht që shqetësimet financiare janë të rëndësishme, por ato nuk janë aspekti i vetëm për të nxjerrë në pah. Për shembull, mund të zgjidhni të përqëndroheni në çështjet shëndetësore me të cilat përballen të moshuarit. Cilat sëmundje i prekin ata më shumë dhe ku mund të marrin ndihmë mjekësore? Si trajtohen në klinika e në spitale? A ndikojnë problemet ekonomike në mënyrën e të ushqyerit të tyre?

★ Marrëdhëniet midis të moshuarve e fëmijëve dhe nipërve e mbesave kanë ndryshuar në mënyrë dramatike gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Shumë të rinj janë larguar në kërkim të një jete më të mirë duke i lënë pas prindërit. Në disa raste familjet janë ndarë nga lufta ose po luftojnë me paaftësitë ose vdekjen për shkak të zhvillimeve të vrullshme të viteve. Shkruani diçka për të shpjeguar këto çështje. Si kanë ndikuar në dinamikën e familjeve ndryshime ekonomike dhe sociale?

★ Kaloni një ditë me një ose më shumë të moshuar që lypin në rrugë dhe shkruani për ta. Si reagojnë njerëzit e tjerë? Si ndjehen vetë ata për atë që po bëjnë? Sa mbledhin në ditë? Si do t'i shpenzojnë ato? Si vendosin e përzgjedhin vendin ku qëndrojnë?

★ Bëni të njëjtën gjë me një të moshuar, burrë ose grua, që shet diçka në rrugë, çokolatë, parfum, çfarëdo. Informohuni për gjendjen e tyre ekonomike. Ku i marrin mallrat? Sa paguajnë për to? Sa fitojnë? Me çfarë problemesh ndeshen me autoritetet?

★ Profilizoni të moshuar që bëjnë punë shtesë. A ka ndonjë aktor të njohur në zonën tuaj që vazhdon të punojë edhe pse i ka ardhur mosha e pensionit? Po ndonjë jurist, mjek, ose i ndonjë profesioni tjetër? Gjeni se çfarë hobi ose aftësish të pazakonta kanë këta njerëz, qofshin të njohur ose jo, që mund të jenë angazhuar në sporte ose në ndonjë lloj tjetër aktiviteti fizik. A bën që kjo gjë t'i ndihmojë të ndjehen të rinj e të jenë të angazhuar në jetën aktive?

★ Shkruani një artikull për të zbuluar çështjen e “moshës.” Ky koncept, që i referohet paragjykitimit ose diskriminimit ndaj të moshuarve, po njihet gjithnjë e më shumë në përfundim si një problem madhor me të cilin ndeshen njerëzit e vjetër në shumë aspekte të jetës së tyre. A ka ndonjë nocion të krahasueshëm në rajonin tuaj? A përballen njerëzit e moshuar me diskriminim, për shembull, në vendin e punës ose në fusha të tjera të jetës së tyre?

Raste për studim

Ky artikull i shkurtër është shembull i medias që transmeton paragjykime kundrejt të moshuarve pa u dhënë atyre mundësi të reagojnë. Propozimi është një përpjekje e hapur e paskrupullt për të gjeneruar antagonizëm ndaj njerëzve mbi 60 vjeç duke sugjeruar se ata nuk janë në gjendje të bëjnë një zgjedhje të duhur lidhur me të ardhmen e Malit të Zi. Ky lloj informacioni nuk duhet të transmetohet pa bërë të paktën një përpjekje për të kontaktuar edhe përfaqësuesit e pensionistëve për t'i lejuar të shpjegojnë përse ata duhet të kenë të drejtën e një vote të plotë si çdokush tjetër.

8. a) Gjysmë vote për ata mbi 60 vjeç

Podgoricë – Delegatët e Aleancës Liberale Alliance Vesna Perovic dhe Labud Sljukic kanë propozuar që personat mbi 60 vjeç të kenë vetëm “gjysmë vote” në një referendum mbi të ardhmen e Malit të Zi. Media e Podgoricës njoftoi sot se delegatët e Aleancës thanë se 20 dhe 60 vjeçarët nuk mund të kenë të njëjtën peshë në vendimet mbi të ardhmen e Malit të Zi.

Danas/Beta, Beograd, 20 dhjetor 2000.

◀ Sipas ç'logjike njëzetvjeçarët kanë peshë më të madhe në referendum? Thjesht për faktin se kanë më shumë jetë përpara? A duhet të kenë 20 vjeçarët më shumë fuqi se sa 40 vjeçarët? Po 50 vjeçarët? A besojnë ata që e propozuan këtë plan se 80 vjeçarët nuk duhet të kenë fare votë?

9. Refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit

Refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit

Luftërat në Europën juglindore gjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë krijuar një valë refugjatësh. Disa kanë kaluar kufijtë dhe jetojnë në kushte të tmerrshme në vende të tjera; të tjerë janë të zhvendosur brenda vendit dhe nuk kanë shtëpi të tyre dhe jetë të pavarur. Shumë kanë mundur t'i mbajnë të bashkuara familjet e tyre, por të tjerë kanë humbur prindërit, bashkëshortët e fëmijët, ose përmes sulmeve ndaj civilëve, sëmundjeve, ose, në rastin më pak traumatik, nga imigracioni.

Në mënyrë të pashmangshme ekzistenca e kaq shumë personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatë ka shkaktuar presione të mëdha politike, ekonomike e sociale në rajonet ku kanë përfunduar. Në shumë vende banorët e vjetër, që janë vetë duke luftuar për t'u përshtatur me jetën në kushte të reja e shpesh të ashpra, nuk e kanë mirëpritur praninë e tyre. Shpesh politikanët kërkojnë të rrisin popullaritetin e tyre duke promovuar pakënaqësi ndaj tyre në popullsinë vendore.

Gazetarët mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar të lehtësohen e jo të acarohen tensionet. Ja disa mënyra si të bëhet ajo gjë:

★ Vlerësoni se si i është adresuar media juaj çështjes së refugjatëve me qëllim që të gjeni boshllëqet në këtë mbulim. Për shembull, a dalin ata vetëm në shkrime që lidhen me krime? Apo keni përfshirë edhe materiale ku tregohet si ata përpiqen të ndihmojnë veten, për mënyrat si ata kërkojnë të përmirësojnë jetën e tyre? A keni shkruar rreth ankesave të politikanëve ose të banorëve vendas lidhur me problemet që shoqërojnë refugjatët pa u dhënë atyre mundësinë të reagojnë?

★ Shumica e shkrimeve për refugjatët në mënyrë të pashmangshme përqëndrohet tek krimet. Sigurisht që krimi mund të jetë problem, por e rëndësishme është të vihet në dukje edhe konteksti kur shkruhet për një gjë të tillë. Si është gjendja e papunësisë ndërmjet refugjatëve? Çfarë traumash kanë pësuar ata? Sa fëmijë duhet të ushqejnë? Kjo nuk do të thotë se duhet të gjeni shfaqësime për aktivitetin kriminal, por që duhet të përpiqeni të përshkruani edhe gjendjen e vështirë në të cilën janë të detyruar të jetojnë.

★ Kaloni njëfarë kohe në një kamp refugjatësh ose në një zonë në rajonin tuaj që shërben si e tillë dhe flisni me sa më shumë njerëz që të mundeni. Bëni një artikull duke përshkruar atë që patë. Si janë kushtet? Çfarë shtëpish kanë për të jetuar? Si është furnizimi me ujë? A janë fëmijët e tyre në gjendje të ndjekin shkollë? Çfarë ushqimi kanë mundësi të gjejnë?

★ Kontaktoni organizata joqeveritare, qofshin vendase ose ndërkombëtare, që punojnë ose përfaqësojnë interesat e refugjatëve. Gjeneroni se çfarë bëjnë ata për t'i ndihmuar. Pyetini ata cilat janë çështjet kryesore me të cilat ndeshen refugjatët në zonën tuaj.

Kërkojuni t'ju rregullojnë një takim me një familje me qëllim që të kuptoni se si është jeta e tyre.

★ Gjeni një ose më shumë refugjatë që kanë mundur t'ia dalin vështirësive të tyre. Si kanë mundur të gjejnë punë? Po shtëpi? Ushqim? Mundësi për shkollimin e fëmijëve të tyre? Pyetini si mundën t'i kapërcejnë problemet e tyre dhe nëse kanë ndonjë këshillë për familjet e tjera.

★ Shkruani profilin e një refugjati që i kushton veten përmirësimit të jetës të tjerëve në të njëjtin vend. A ka organizuar ndokush ndonjë shkollë aty në vend? Nëse po, kaloni një ditë në një klasë dhe përshkruajeni atë. A ka ndonjë që i ndihmon refugjatët të gjejnë punë? A ka ndonjë që i ndihmon të gjejnë të afërmit të cilët mund t'i kenë humbur gjatë luftës ose kryengritjes?

★ Bëni një shkrim lidhur me çështjet psikologjike, shëndetësore, etj., me të cilat refugjatët përpiqen të riintegrohen në shoqëri. Pyetini mjekët se sa prej refugjatëve vuajnë nga stresi post-traumatik dhe vështirësi të tjera emocionale. A ka ndonjë sëmundje që është e përhapur ndërmjet refugjatëve dhe çfarë hapash janë ndërmarrë nga zyrtarët lidhur me këtë problem?

Raste për studim

Ky shkrim është shembull i një qëndrimi ksenofob të disa elementëve të shtypit britanik ndaj refugjatëve dhe atyre që kërkojnë azil. Shkrimi kryesisht jep pamjen e azilkërkuesve, të cilët në fund të fundit janë duke kërkuar me dëshpërim të gjenë një shtëpi të re për veten dhe familjet e tyre për shkak të kushteve të tmerrshme në vendin e tyre dhe ata përshkruhen si të këqinj që nuk vlerësojnë gjithçka që bën Britania për ta. Por me përjashtim të përfaqësuesit të një OJQ-je, lexuesit nuk i jepet informacion nga këndvështrimi i të ndaluarve.

9. a) **Politika e strehimit davaritet si tym – Pra, kështu na falenderojnë ne ata: Të ndaluarit kryengritës fillojnë një shkëndijë 35 milionë stërlina**

Zor se mund të ishin më mirë ndërtesat luksoze në qendrën e ndalimit që kushton 100 milionë stërlina-por azilkërkuesit megjithatë e dogjën atë deri në fund.

Një turmë, duke u përpjekur të dilte jashtë në masë, shkatërroi dy ndërtesa të cilat ishin hapur vetëm një muaj më parë.

Fatura e dëmit prej 35 milionë stërlinash është e barabrtë me një spital, ose 1,400 mjekë të rinj, 1,500 policë ose 2,400 infermiere. Dhe kjo trazirë hedh hije dyshimi ndaj politikës së Britanisë lidhur me azilkërkuesit.

Policët kundër trazirave, roje dhe zjarrfikës luftuan që nga ora 8 e mbrëmjes të enjten deri në agim dje për të vënë nën kontroll zjarrin dhe shkatërrimet në qendrën Yarl's Wood në Clapham, Beds.

Sot policia ende ishte e pasigurt se sa refugjatë ishin larguar. Pas 12 arrestimeve mendohej se 15 mungonin. Ata vodhën kyçet për të hapur dyert. Tre të ndaluar, dy policë dhe një oficer i Group Four u plagosën gjatë trazirave.

Qendra strehonte 384 azilkërkues-shumica e të cilëve prisnin të ktheheshin në vendet e tyre.

Objekti kishte tetë dhoma fetare, 10 klasa me kompjuter, dyqane e librari me libra në 40 gjuhë.

Titulli menjëherë portretizon të ndaluarit si “njerëz jo mirënjohës” që e meritojnë fatin e tyre. Përfshirja e një dëmi të vlerësuar në nëntitull është një mënyrë për të paragjykuar më tej opinionin e lexuesit kundër tyre.

◀ Dy fjalitë e para vazhdojnë me temën e mosmirënjohjes përballë bujarisë britanike, që ka ofruar një strehim luksoz në një objekt të shkëlqyer.

◀ Gazetari duhet të shpjegojë se cili e ka bërë këtë vlerësim të koston së dëmit dhe si. Llogaritja se çfarë mund të bëhej me ato para sigurisht që është një strategji efikase e gazetarit, por në këtë rast ajo çon më tej qëllimin e artikullit për të ndezur opinionin publik kundër azilkërkuesve duke i fajësuar ata për mungesën e mjekëve e të infermiereve.

Meqë ata po prisnin për t'u kthyer në vendet e tyre, është e paqartë se për çfarë arsye ata duhej t'i ishin mirënjohës Britanisë së Madhe. Një kontekst më i gjerë-cilët janë ata, nga vijnë, përse ishin larguar-do të ishte mirë të vihej këtu. Gazetari nuk duket se ka bërë përpjekje të flasë me ndonjë prej të ndaluarve lidhur me gjendjen e tyre ose kushtet në të cilat mbaheshin.

Ka vende sportive, tavolina pinpongu dhe fusha të tjera sportive. Të ndaluarit në fillim e nisën zjarrin në bllokun administrativ dhe hodhën shishe me lëndë djegëse kundër stafit të sigurimit. Policia erdhi brenda pak minutash, 20 policë e 20 zjarrfikës. Një roje u plagos duke kërcyer nga kati i parë për t'i shpëtuar flakëve. Kamerat CCTV u thyen dhe regjistrimet e tyre po ashtu. U tha se katër infermiere ishin mbyllur në një dhomë nga të ndaluarit ndërkohë që ndërtesa po digjej. Më pas zjarri u përhap në krahët Charlie dhe Delta, të cilat u përfshinë prej tyre plotësisht. Rebelët u grumbulluan jashtë prej policëve. Të dy krahët, Alpha dhe Brave-që ndahen nga një rrugë-u evakuan. Fshatarët aty pranë u paralajmëruan të kyçnin shtëpitë dhe vendet ku mund të fshiheshin pesona.

Shefi i zjarrfikësve Clive Walsh tha se Home Office nuk kishte marrë parasysh kërkesat e brigadës zjarrfikëse që duhej të instalohej një pajisje për të sinjalizuar zjarrin. Protesta thuhet se filloi pasi një gruaje 55 vjeçare iu vunë prangat ndërsa priste të shkonte në spital.

Mike Gilmour i Fushatës për të Ndaluar Ndalimet Arbitrare tha: "Të ndaluarit kishin sugjeruar se kjo do të ishte e fundit para se të fillonte protesta."

Group Four e mohoi që gruas i ishin vënë prangat. Dje të ndaluarit u dërguan në qendra të tjera.

◀ A është ky një shembull tipik se si trajtohen në qendrën e ndalimit? Do të ishte mirë të kishte më shumë detaje.

The Sun, Londër, 16 shkurt 2002.

Ky artikull është një portret i menduar se si anëtarët e një familjeje përballen me zhvendosjen pasi kanë lënë pas shtëpinë dhe vendin e tyre. Në paraqitjen e detajeve të jetës së tyre dhe një diskutimi të shpresave e të frikës së tyre-të kombinuar me një masë të konsiderueshme të kontekstit më të gjerë politik e social-shkrimi ofron një përshkrim dashamirës të dilemës së ndërlikuar të familjes. Në këtë mënyrë ai sugjeron një alternativë të vërtetë për atë lloj materiali që fajëson gjithnjë refugjatët, të cilin e ndeshim shpesh në median perëndimore apo edhe lindore. Ai gjithashtu përshkruan fatkeqësinë dhe në të njëjtën kohë nuk demonizon serbët, që është një qëndrim i zakonshëm dhe jo domosdoshmërisht i dobishëm që përdoret kur merren me këtë çështje.

9. b) **Familja e refugjatëve shqiptarë në dyzim: Të evakuarit janë në mës të dilemës për një jetë të re ose të merren me atë të vjetrën, ndërkohë që presin se si mund të kthehen në shtëpitë e tyre të përfshira nga lufta**

Ndërsa dhjetëra mijëra bashkëatdhetarë shiptarë ktheheshin javën e kaluar në Kosovë, Besnik Vlasi shihte nga një shtëpi të rrënuar në Luginën San Fernando, ku brendësia e saj e errët ishte po aq e paqartë sa edhe e ardhmja e tij.

Besnik dhe pjesa tjetër e familjes së tij, të sjellë në Shtetet e Bashkuara gjatë javëve të fundit së bashku me 7,600 refugjatë të tjerë kosovarë, po kalojnë ditët duke filluar një jetë të re këtu: gjetja e një shtëpie, të mësuarit anglisht, gjetja e vendeve të punës.

E megjithëse marrëveshja e paqes e arritur më parë këtë muaj hapi dyert për kthimin e refugjatëve në Kosovë, ajo shënoi edhe fillimin e një periudhe të re të papërcaktuar e të pasigurt për Vlashët dhe të evakuarit e tjerë.

Ndihma e fillimit për refugjatët që të mbërrinin të sigurt në Amerikë tani është zëvendësuar nga emocione të tjera, që fillojnë që nga zemërimi lidhur me nisjen së pari të jetës së tyre deri tek keqardhja që dilte ngadalë nga kujtimet e tyre të futura thellë në shpirtin e tyre. “Kur erdhëm në fillim u përpoqëm të shihnim se ku ishim dhe çfarë po ndodhte,” tha Besnik, 17 vjeç. “Tani po ngjallen prapë kujtimet.”

Citime si këto personalizojnë dilemën e refugjatit duke i lejuar të shprehin ndjenjat e tyre, zemërimin dhe shqetësimet. Shumë shkrime i diskutojnë ata vetëm lidhur me problemet e tyre që lidhen me jetën shoqërore ose krimin dhe intervistojnë vetëm autoritetet ose qytetarë të zemëruar e jo vetë refugjatët.

Pasiguria nuk do të zgjidhet kaq shpejt. Ndërkohë që Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e ndihmave po përpiqen shumë për të përballuar valën e refugjatëve që duan të kthehen në Kosovë, ato ende nuk kanë një plan përfundimtar si do të merren me transportin e 88,000 refugjatëve që janë dërguar në 29 vende.

Kjo pamje ndërlikohet edhe më shumë nga dhjetra mijëra refugjatë që dëshirojnë të vijnë në Shtetet e Bashkuara, ndërkohë që marrëveshja e paqes nuk është në gjendje që të heqë nga mendjet e tyre kujtimet e mëmëdheut të tyre të goditur nga vrasjet dhe përdhunimet.

Disa vende, përfshirë Anglinë e Gjermaninë, njoftuan javën e kaluar se nuk do të pranojnë më refugjatë kosovarë tani që fushata e bombardimit përfundoi.

Si rrjedhojë disa ekspert emigracioni parashikojnë që SHBA mund të bëhet së shpejti vendi i vetëm që pranon refugjatët kosovarë. Të paktën 5,000 të tjerë po presin evakuimin në SHBA, sipas shifrave të qeverisë.

“Po zhvillohet pothuaj një debat ditor për të diskutuar se çfarë do të bëhet,” tha Panos Moumtzis, zëdhënës i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët me bazë në Uashington, D.C..

Grupe refugjatësh po përpiqen që të sigurojnë se dera për në SHBA do të mbetet e hapur, veçanërisht për refugjatët me probleme mjekësore tepër të ndërklikuara që të mund të zgjidhen nga sistemi i shkatërruar i kujdesit mjekësor në Kosovë, si dhe për ata që janë traumatizuar shumë nga përdhunimet ose humbja e anëtarëve të familjes.

“Do të donim të siguronim që refugjatët që kanë nevojë e që janë të vendosur në vende të tjerë e kanë këtë mundësi,” tha Leonard Glickman, zëvendës presidenti ekzekutiv i Shoqatës hebraike të Ndhmës së Imigrantëve, e cila, së bashku me Federatën Hebraike të Los Angeles, ndihmoi për të sjellë Vlashët në SHBA.

Një gjë është e sigurt: Refugjatët si Vlashët që zgjodhën të shkonin në SHBA e jo të qëndronin në kampet e tejmbushura e në shtëpitë në

Maqedoni e në Shqipëri janë në fund të listës për ndihmë për rivendosje.

Ata që kanë më shumë nevojë për vëmendje janë dhjetëra mijëra refugjatë të zhvendosur brenda vendit, të cilët u fshehën në male e pyje në Kosovë duke mos patur ushqime e strehim.

Pas tyre janë qindra mijëra që kaluan muaj të tërë në kampet e refugjatëve të tejmbushur dhe jo në gjendje të mirë higjienike, shumë prej të cilëve jo larg Kosovës, një krahinë e Serbisë, republika kryesore e Jugosllavisë.

Refugjatët si Vlashët nuk mund të presin më e pakta deri në pranverë ndihmë qeveritare për t'u kthyer në atdhe, parashikojnë zyrtarët e K.B.-së e ata të emigracionit.

Teknikisht refugjatët mund të largohen nëse vendosin vetë. Por nëse presin derisa qeveria e SHBA-së ta deklarojë Kosovën të sigurt-një vendim që mund të kërkojë muaj-atyre u garantohet një udhëtim falas për në atdhe.

Nëse refugjatët vendosin të qëndrojnë në SHBA, atyre do t'u ngarkohet bileta e avionit që erdhën në këtë vend, rreth \$ 3,000 për një familje me katër vetë. Pavarësisht nga kjo shumë, shumë ekspertë parashikojnë që shumica e tyre do të qëndrojnë.

Pjesërisht kjo do të ndodhë për shkak të shërbimeve më të mira të ofruara në SHBA. Por edhe sepse në bazë të një tradite moderne në kulturën shqiptare të Kosovës ata do të punojnë jashtë vendit dhe do të dërgojnë para në shtëpi. Disa vlerësojnë se një në katër shqiptarë punojnë jashtë vendit.

“Logjika të thotë që pasi vijnë këtu e gjejnë punë dhe fëmijët futen në shkollë, gjithnjë e më shumë prej tyre do të qëndrojnë,” tha Mark Franken, drejtor ekzekutiv për shërbimet e migracionit dhe të refugjatëve për Konferencën Katolike të SHBA-së.

Vlashët thanë se ata duan të kthehen, megjithëse ata janë përgatitur të presin gjatë. Por shqetësimet janë të shumta. Kryesorja ndërmjet tyre është pavarësia e tyre. Pasi jetuan disa javë me familjen mikpritëse ata ndjejnë se janë bërë një barrë-pavarësisht nga sigurimet për të

kundërtën që u japin mikpritësit e tyre, Bobbie e Steven Black nga Calabasas.

Ata nuk e kishin të lehtë të gjenin një apartament për familjen e tyre me gjashtë pjesëtarë për \$ 1,000 në muaj. Kostoja e lartë e strehimit dhe shtëpitë e vogla në SHBA i gjetën të befasi. Ata nuk janë mësuar me idenë që të paguajnë kaq shumë për kaq pak, në krahasim me atë që mund të kenë për të njëjtën sasi parash në Kosovë.

“E dimë që jemi bërë barrë,” tha Fatime Vlasi, 47 vjeç, nëna e familjes, që ka edhe Lumnie, 22 vjeç, Ganimeten, 21 vjeç, dhe Fitoren, 7 vjeç. “Do të donim të kishim një shtëpi tonën.”

Një tjetër burim shqetësimesh është babai i familjes, Hazir Vlasi, 47 vjeç. Ai është ndarë nga familja gjatë evakuimit, megjithëse ai pritet të mbërrijë nga Maqedonia.

Dhe së fundi, janë edhe kujtimet se çfarë kanë kaluar e çfarë kanë parë.

Njëra vajzë eci përmes maleve me dëborë për 15 orë për të arritur në një vend të sigurt. Hazir Vlasi u rrah keq nga serbët, thonë anëtarët e familjes. Ata kishin humbur kontaktin me miq të shumtë.

“Jemi vazhdimisht të dëshpëruar për shkak të situatës,” tha Besniku.

Ekspertët e refugjatëve presin që ata të kenë probleme të tjera psikologjike me kalimin e kohës.

Ndryshe nga shumë refugjatë që kaluan muaj dhe madje edhe vite duke u përshtatur me situatat para se të vinin në Shtetet e Bashkuara, refugjatët kosovarë u larguan nga shtëpitë e tyre dhe u dërguan në vende të tjera brenda disa javëve.

Kalimi i traumave do të kërkojë kohë, thotë ekspertët.

“Disa probleme psikologjike mund edhe të ndodhin,” tha Glickman. “Sigurisht që do të ketë sfida në këtë aspekt.”

Los Angeles Times, Woodland Hills,
21 qershor 1999.

◀ Ky artikull duhej të kishte patur më shumë informacion lidhur me mikpritësit. Përse kishin vendosur të prisnin një familje? Cilat ishin ndjenjat e tyre lidhur me situatën? Do të ishte mirë që lexuesve t’u ofrohej pak më shumë nga bota e brendshme e njerëzve të zakonshëm që mendojnë se refugjatët si grup duhet të ndihmohen dhe për të cilët u vjen keq dhe nuk i konsiderojnë si shkakuarë problemesh të mëdha sociale.

◀ Paraqitja e disa detajeve nga përvojat e tyre do të ishte mirë të futej me qëllim që të krijohej simpatia për refugjatët dhe jo antipatia e zemërimi ndaj tyre. Shumë shkrime duket se janë bërë për të nxitur pakënaqësinë ndaj refugjatëve duke mos marrë parasysh arsyet për të cilat ata janë larguar nga vendi i tyre dhe duke i portretizuar ata thjesht si të rinj të sapoardhur që marrin shumë më tepër se sa meritojnë.

10. **Orientimi Seksual**

Orientimi Seksual

Pakicat seksuale në vendet e Europës juglindore janë bërë më të dukshme këto vite. Ato kanë organizuar shoqata, konferenca dhe parada homoseksualësh duke i detyruar gazetarët të merren me çështjet e tyre të ndërlikuara që ngrihen nga njerëz me orientime seksuale jotradicionale-homoseksualë, lezbike dhe biseksualë. Por shumë gazetarë dhe organizata të medias ende i trajtojnë në mënyrë rutinë këta individë si të jashtëligjshëm në shoqëri që nuk meritojnë dashuri, mirëkuptim dhe të drejtat bazë të njeriut.

Ja disa mjete kur mbulohen pakicat seksuale:

★ Kushtojini vëmendje të veçantë gjuhës së përdorur. Shumë raportime kanë fjalë fyese si “pederast” dhe “pervert” për të përshkruar pakicat seksuale. Çdo gjuhë ka specifikat e saj, por në anglisht, për shembull, “gay,” “lesbian,” e “bisexual” janë terma neutralë që nuk përmbajnë kuptime negative. Kërkoni terma neutralë në gjuhën tuaj.

★ Transvestitë dhe transeksualët nuk janë e njëjta gjë. Transvestitë janë njerëz që preferojnë të vishen me rroba që tradicionalisht përdoren nga gjinia tjetër. Transeksualë janë njerëz trupat e të cilëve nuk përputhen me sensin e tyre të identitetit gjinor; me fjalë të tjera, meshkujt anatomikë që e konsiderojnë veten si femra, dhe femra anatomike që e konsiderojnë veten si meshkuj. Transeksualët mundet ose jo të zgjedhin të bëjnë një operacion të shtrenjtë e të dhimbshëm për të ndryshuar seksin.

★ Kur shkruani për pakicat seksuale është e rëndësishme të siguroheni që të flisni me disa prej tyre ndërkohë që bëni gati shkrimin tuaj. Gay, lezbiket e të tjerë kanë shpresa, endërra dhe frikë si edhe cilido tjetër. Ata kanë karrierë dhe interesa e familje si edhe të tjerët. Mos mendoni se e njihni jetën e tyre ose se cilët janë ata pa folur me ndonjë prej tyre.

★ Shumë njerëz kanë ndjenja të forta lidhur me pakicat seksuale. Fakti që disa autoritete, politikanë, klerikë e të tjerë mund të përdorin terma e shprehje të rënda kur diskutojnë për gay-t dhe lezbiket nuk do të thotë që juve ju kërkohet, si gazetar, ta përfshini këtë lloj gjuhe fyese në materialin tuaj. Nëse është e nevojshme, perifrazojeni me fjalë të tjera. Nëse vendosni t’i citoni drejtëpërdrejtë, duhet të përmendni që pakicat seksuale e konsiderojnë një gjuhë të tillë si fyese dhe keqdashëse.

★ Nuk duhet të pranoni pa pyetur mendimin e mjekëve e të kërkuesve që argumentojnë se pakicat seksuale mund të rekrutojnë fëmijë, të përhapin HIV-in me qëllim ose që veprojnë në mënyra të tjera të dëmshme për shoqërinë. Nëse dikush ju thotë, për shembull, se 50% e burrave gay ngacmojnë djemtë e rinj, pyetini ata për çdo informacion të veçantë se ku e kanë gjetur atë statistikë. Njerëzit që e quajnë veten ekspertë

shpesh përdorin këtë lloj disinformimi ose shtrembërojnë studimet në përpjekje për të ndikuar ndaj opinionit publik lidhur me pakicat seksuale.

★ Shumë shkrime për pakicat seksuale shpesh përqëndrohen te krimi, sidomos tek sulmet ose vrasjet e njerëzve me orientime seksuale jotradicionale. Këto shkrime shpesh i trajtojnë viktimat si kriminelë, sikur ata duhet të fajësohen që u sulmuan sepse janë të ndryshëm nga njerëzit e tjerë. Është e rëndësishme të kihet parasysh në raste të tilla se kriminelët janë ata që sulmuan e jo ata që u sulmuan. Shpesh gazetarët vetëm raportojnë pa marrë mendimet e autoriteteve, që edhe ato kanë mendimin se viktimat në njëfarë mënyre e meritonin të sulmoheshin.

★ Ngaqë pakicat seksuale shpesh qëndrojnë të fshehura nga shoqëria, mund të jetë e vështirë të gjenden njerëz për të folur. Qëndrimi më i mirë në këtë rast do të ishte të kontaktoheshin grupe dhe OJQ që i përfaqësojnë ato. Flisni me to dhe arrini të kuptoni mirë shqetësimet e tyre dhe kërkojuni nëse mund t'ju ndihmojnë të viheni në kontakt me anëtarë të tjerë të grupit. Gjithashtu përpiquni të flisni me të tjerë që nuk janë anëtarë të grupeve, por që kanë mendime të ndryshme, ose që mund të ofrojnë mendime shumë të drejtëpërdrejta.

★ Mos i besoni të gjitha stereotipet që mund të dëgjoni lidhur me gay, lezbiket dhe pakica të tjera seksuale. Shumë mendojnë, për shembull, se burrat gay mund të ndahen me lehtësi në "aktivë" e "pasivë," ku pasiv nënkupton ata që luajnë rolin e femrës. Teorikisht kjo mund të jetë në rregull, por rolet seksuale zakonisht janë më të ndërlikuar e më me nuanca në botën reale. Gjithashtu nuk është e vërtetë që të gjithë burrat gay janë shumë artistikë, se të gjitha lezbiket ose i urrejnë ose duan të jenë burra, ose se burrat që vishen si gra janë automatikisht homoseksualë.

Raste për studim

Ky titull është një shembull i shkëlqyer për të treguar se si njëanshmëritë e pandërgjegjshme mund të sjellin deklarata që shtrembërojnë realitetin. Frazja në fillim fajëson gruan për vdekjen e saj dhe të nënës e të fëmijëve të saj, pasi ajo tregon se kundërshtimet që i bëri dëshirave të një burri “çuan” në therjen e tyre. E vërteta është që ishte natyra e dhunshme e burrit, dhe jo ajo që nuk bëri grua, që “çuan” deri te vrasjet. Një grua, qoftë lezbike ose jo, natyrisht që ka të drejtë të mos e pranojë një burrë pa patur frikë se mund të theret. Më tej titulli lë të kuptohet, pa e thënë drejtpërdrejtë, se arsyeja që ajo nuk e pranoi atë ishte pikërisht sepse ajo ishte lezbike e jo sepse ajo nuk kishte dëshirë të flinte me të.

10. a) **Kundërshtimi nga një lezbike çoi në një masakër — Aventurat seksuale të viktimës**

Një vrasës i dehur masakroi një familje pasi kërkesat e tij seksuale u kundërshtuan nga një nënë lezbike, mësoi dje gjykata.

Shitësi i metaleve të mbetura David Morris goditi Mandy Power të divorcuar me një hekur, dëgjoi juria. Pastaj ai bëri të njëjtën gjë me vajzat e saj Katie, 10 vjeç, dhe tetëvjeçaren Emily, si edhe me nënën e saj invalide Doris Dawson, 80 vjeç, për t'u siguruar që asnjë dëshmitare nuk mbeti gjallë. Patrick Harrington QC, prokuror, deklaroi në Gjykatën Mbretërore të Swansea-s se sulmet ishin kaq të egra sa kafka e viktimës ishte shtypur dhe znj. Power kishte 38 dëmtime veç e veç. “Kjo nuk ishte thjesht vrasje, kjo ishte masakër,” shtoi ai. “Në secilin rast kokat e tyre ishin goditur me kaq forcë sa dëmtimi masiv i kockave rezultonte në secilën prej tyre.” “Ashtu ndodhi edhe me nënmadhen invalide Doris Dawson edhe pse ajo ishte shtrirë në krevat.” Z. Harrington tha se Morris, 39 vjeç, po priste që 34-vjeçarja znj. Power të kthehej në shtëpi me fëmijët e saj pasi kishte shërbyer si baby-sitter për motrën e saj në qershor 1999. Ai shpërtheu në një “zemërim të dhunshëm” kur ajo nuk pranoi kërkesat e tij seksuale, tha prokurori. Ai pretendoi

Gazeta e paragjykon problemin me këtë titull duke e shoqëruar më tej me disa shpjegime për jetën e gruas. Duke theksuar “aventurat seksuale” bëhet që të tërhiqen më shumë lexues, por përsëri sugjerohet që në thelb gruaja është ndëshkuar që kaloi një kohë të mirë. Megjithatë artikulli tregon se ajo ishte edhe një nënë e dashur me marrëdhënie të qëndrueshme dhe në fakt nuk ishte aktualisht e interesuar për “aventura seksuale” të tjera.

◀ Duke shkruar për gjyqin gazetari pritet t'u japë lexuesve dëshmitë e tij edhe në qoftë se ato janë të njëanshme ose të gabuara. Megjithatë në këtë rast ka një ndryshim të lehtë midis një vrasjeje që ndodh pas një kundërshtimi, siç e thekson fjalia e parë e artikullit, dhe nënkuptimit që jep titulli se në njëfarë mënyre kundërshtimi e shkaktoi masakrën.

Nëse orientimi seksual i viktimës përmendet që në fillim të shkrimit, gazetari duhet të tregojë rolin që luajti kjo në vrasje. Përndryshe ajo shfaqet vetëm si një hollësi e rastësishme që nuk i shton asgjë informacionit për lexuesin lidhur me këtë histori.

◀ “Invalid” është një fjalë arkaike që konsiderohet fyese, sepse jep përshtypjen e dobësisë ose të mungesës së fuqisë. Mirë është që për dikë në kushte të tilla të referohet si i “paaftë” ose që ka një paaftësi.

se më pas Morris ishte pastruar në banjë para se të fillonte pesë zjarre të veçantë në shtëpi në Clydach, South Wales, me qëllim që të shkatërronte provat.

Morris akuzohet edhe për çarjen e trupit të znj. Power, që u gjet nga zjarrfikësit pasi shtëpia e saj mori flakë. Anëtarët e jurisë morën vesh që pak para vdekjes znj. Power kishte filluar një marrëdhënie lezbike me një intesitet “frikësues” me Alison Lewis, një ish-police 32-vjeçare.

Z. Harrington e pranoi se “dyshimi fals” kishte shkuar në fillim drejt së dashurës lezbike të znj. Power dhe burrit të saj, një inspektor policie.

Znj. Lewis dhe burri i saj Steven, që është ende në atë profesion, u arrestuan në qershor 2000. Shtëpitë, makinat e veshjet e tyre u kontrolluan me kujdes duke u mbështetur sipas prokurorit në “dyshime logjike të mbështetura por jo të vërteta”. Morris nuk u bë qendra e vëmendjes së hetimit deri në mars 2001.

Ai vazhdimisht gënjente kur pyetej nga policia dhe jepte dëshmi të ndryshme për lëvizjet e tij gjatë natës së vrasjeve. Por ekspertët kriminalistë zbuluan se pjesë të një ngjyre në një zinxhir floriri gjetur në shtëpinë e znj. Power përputheshin me ngjyrën e kuzhinës së Morris. Z. Harrington tha se Morris në fillim mohoi që zinxhiri ishte pronë e tij, por pak para se të fillonte gjyqi ai e pranoi se zinxhiri ishte i tij. Anëtarët e jurisë dëgjuan edhe se ditën pas vrasjeve Morris i kishte thënë një shoku se kishte patur marrëdhënie me znj. Powers dhe se kishte lënë një zinxhir në shtëpi. Ai i kërkoi shokut të tij t'i blente një tjetër që ta zëvendësonte. Morris, nga Craig-cefn-parc, Swansea Valley, i mohoi katër akuzat për vrasje dhe gjyqi, që pritet të zgjasë 14 javë, vazhdon.

Metro, Londër, 23 prill 2002.

◀ Duke patur parasysh paragjykimin ekzistues kundër njerëzve orientimet seksuale të të cilëve janë të ndryshme, nuk është çudi që policia të përqëndronte dyshimet në aspektin lezbik të jetës së tyre, meqë ekziston ideja se midis homoseksualitetit dhe vrasjes ekziston njëfarë lidhje e pashpjegueshme. Nëse prokurori do të kishte shpjeguar se mbi ç'bazë logjike mbështeteshin këto dyshime veç paragjykimit, kjo do të ishte mirë të futej në artikull.

Ky shkrim bën përpjekje për të paraqitur objektivisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen e gay-ve në Shqipëri. Megjithatë informacioni mbështetet vetëm në dy burime, të dyja gay. Do të ishte mirë të përfshiheshin edhe intervista me zyrtarë qeveritarë, psikologë e të tjerë që merren me këtë çështje. Veç kësaj artikulli nuk përmend lezbiket. Po lezbizmi është edhe ai i jashtëligjshëm? A është ndonjë grua anëtare e shoqatës gay?

10. b) Homoseksualët në Shqipëri: Të Jashtëligjshëm

Tiranë – Në 17 gusht 2002, Bashkim Arapi mori një dozë helmi. Disa orë më pas ai vdiq në një spital në Tiranë, kryeqyteti i Shqipërisë.

Personi i vetëm përkrah tij ishte partneri i tij prej 12 vjetësh. Pak njerëz morën pjesë në funeralin e tij. Asnjë nga rrethi i ngushtë familjar ose të afërm të tjerë nuk shkoi për të bërë nderimet e fundit për të vdekurin. Ai vdiq i braktisur dhe i poshtëruar nga shumica e popullsisë. Thjesht sepse ai ishte president i Shoqatës së Homoseksualëve të Shqipërisë.

“Popullsia shqiptare është tepër anti-homoseksuale. Anketimet më të fundit tregojnë se shumica dërrmuese e qytetarëve na shohin si njerëz të sëmurë.

Të deklarosh vetem publikisht si homoseksual do të thotë që nuk mund të gjesh një punë të hajrit, e gjithë familja do të të nxjerrë jashtë. Vetëm shqiptarët e dinë se ç’do të thotë që e gjithë familja të të kthejë shpinën,” thotë Naser Almalek, sekretari i shoqatës. Ai është një nga pak anëtarët e shoqatës që guxon të flasë hapur me median me emrin e tij të vërtetë.

Shoqata u përpoq të organizonte vetë një funeral normal. “U përpoqëm të bëjmë diçka vetë. Zhvilluam një pritje në shtëpinë e mikut tonë, në përputhje me traditën. Mblodhën para, me ndimën e miqve tanë italianë, dhe organizuam funeralin,” thotë Almalek.

Ai qëndron i qetë në barin La Voglia, pranë qendrës së Tiranës. Almalek, 30 vjeç, është me origjinë arabe. Ai është dentist me profesion dhe e ka marrë gradën në Prishtinë, Kosovë.

Ai qëndron atje, me flokë në të hirtë dhe nuk ka frikë të shohë çdo burrë në bar. Sheshi jashtë

Ky është një shembull tronditës i tragjedi që ndodhin kur nuk pranohen gay-t. Por mirë do të ishte të kishte më shumë detaje. A dihej se Arapi ishte në depresion para vetëvrasjes? A kishte ndonjë gjë të veçantë që e çoi atë drejt vetëvrasjes në këtë moment? Çfarë lloj helmi përdori? Cili e gjeti atë? A jetonin së bashku me partnerin? Si president i shoqatës, a e kishte deklaruar ai seksualitetin e tij? A e dinin prindërit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes që ai ishte gay? Gjithashtu është e pasaktë të thuhet se ai ishte braktisur dhe poshtëruar nga “shumica” e shqiptarëve. Pa dyshim, shumica e shqiptarëve nuk e dinin se çfarë ishte ai, kështu që ata nuk mund ta braktisnin e ta poshtëronin.

◀ Cilat janë përqindjet? Konkretisht, çfarë pyetjesh u bënë? Kur një burim i referohet një anketimi, gazetari duhet të marrë të dhëna e referenca specifike, të citojë detaje, dhe pastaj të intervistojë anketuesit për më shumë informacion.

◀ Ç’do të thotë kur ai përmend “vetëm shqiptarët” e dinë se si është kur braktisesh nga anëtarët e familjes? A do të thotë se njerëzit në kulturat e tjera nuk vuajnë kur përballen me një kundërshti të tillë? Cilat janë marrëdhëniet e Almalekut me familjen e tij? A e kanë përzënë edhe atë, apo e pranojnë orientimin e tij seksual?

◀ Nëse ai është gay i deklaruar, a është ai në gjendje të praktikojë zanatin e tij si dentist? Cilët janë pacientët e tij? Nëse ata e dinë, do të ishte interesante të intervistohen një ose dy prej tyre dhe të pyeteshin se si ndjeheshin.

është plot me djem të rinj, të cilët ai i sheh me vëmendje.

Almalek heziton të thotë se ku zakonisht takohen gayt në Tiranë. Ai ka frikë se kjo mund të rrezikojë sigurinë e tyre, sepse në të kaluarën ata janë rrahur pasi vendet e tyre të takimit ishin zbuluar. Por kryesisht ata takohen në parqe, sidomos nën errësirën e natës.

Sipas Almalek, gayt përdorin disa shenja e fraza të posaçme për të njohur njëri tjetrin e për të rregulluar takimet. Përsëri, meqë siguria është një çështje që duhet marrë parasysh, ai nuk dëshiron t'i demonstrojë ato. "Shumica e anëtarëve të familjeve tona në përgjithësi nuk e dinë se çfarë janë djemtë e tyre. Nëse homoseksualët mbajnë të fshehtë seksualitetin e tyre, prapa mureve, në përgjithësi gjërat ecin mirë. Familjet e tyre nuk i kundërshtojnë. Presioni është tejet i madh. Arapi nuk ia doli dot. Kjo është arsyeja përse ai vrau veten," thotë Almalek, duke përshkruar se me çfarë përballen gayt në Shqipëri.

Megjithatë burimet nga organizatat joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut thonë se shqiptarët e rinj shpesh mund të abuzojnë me këtë shoqatë me qëllim që të largohen nga vendi.

Almalek konfirmon se kanë ndodhur zhvillime të tilla. "Pak kohë më parë unë duhej të merrja pjesë në një ngjarje të madhe të gay në SHBA. Shpenzimet e hotelit e të biletës ishin paguar, por ishte jashtëzakonisht vështirë të merrja vizën. Arsyeja është e qartë: anëtarët tanë janë të rinj dhe ka shumë mundësi që disa prej tyre të zgjedhin të qëndrojnë në SHBA. Ky rast tregon se besueshmëria jonë ka rënë në qarqet diplomatike në Tiranë," konkludon ai.

Ndoshta shembulli më i mirë i këtij fenomeni është rasti i Arip Selimit, një ish-lojtar i klubit të futbollit Partizani Tirana. Ai nuk mund të gjente punë jashtë vendit, por nuk donte të qëndronte në Shqipëri. Kërkonte të qëndronte jashtë vendit dhe kjo është arsyeja përse ai u bashkua me Shoqatën e Homoseksualëve. "Nuk kisha zgjidhje tjetër," thotë Selimi, duke buzëqeshur ndërsa flasim në një bar në Tiranë. Ai është kthyer për

◀ A pati ndonjë ngjarje konkrete që e shtyu Arapin drejt vetëvrasjes? Apo ishte një presion i krijuar përgjatë viteve?

◀ Cilat janë këto burime të tjera dhe OJQ? Përse gazetari nuk ka përfshirë intervista dhe citime nga ndonjë prej tyre?

pushime dhe veç passportës së tij shqiptare tani ka edhe një pasaportë tjetër të huaj.

“Nëse kërkon të largohesh nga ky vend duhet të jesh i përgatitur për çdo gjë. Nuk jam i pari që bëj një gjë të tillë,” vazhdon ai. Përmes shoqatës Selimi mori një ftesë për të vizituar një grup gay jashtë vendit. Kështu ai mori një vizë. Selimi nuk dëshiron të bisedojë lidhur me anëtarësinë e tij në shoqatë. Ai vetëm buzëqesh, ndryshon temën e bisedës, dhe porositi një tjetër pije. “Ç’mund të bëjmë, janë kohëra të vështira në Shqipëri. Duhet të vendosësh-dinjitet ose vizë. nuk është një vendim i lehtë,” thotë Almalek.

Shoqata ka 30 anëtarë aktivë dhe rreth 200 aktivistë, por vetëm Almalek pranonte të fliste me median.

Kjo nuk është ndonjë çudi meqë në Shqipëri homoseksualiteti penalizohej deri në vitin 1995. Neni 137 i Kodit Penal theksonte qartë se homoseksualiteti ishte një vepër penale dhe cilido që zbulohet se ishte homoseksual dënohej deri në 10 vjetë burg.

Atë vit ndryshoi ligji në qershor menjëherë pasi Shoqata e Homoseksualëve u regjistrua zyrtarisht. “Fitorja jonë më e madhe ishte në janar 1995, kur parlamenti ligjëroi marrëdhëniet homoseksuale. Tani ligja ndalon vetëm marrëdhëniet homoseksuale me forcë dhe marrëdhëniet me të mitur,” thotë Almalek.

Disa anëtarë të shoqatës kanë marrë vlerësime ndërkombëtare për punën e tyre. “Komuniteti ynë mori njohjen më të madhe në 1995, kur Genc Xh., një prej katër anëtarëve, mori çmimin e të drejtave të njeriut Filip di Suco në Uashington,” thotë Almalek.

Por fytyra e tij ndryshoi dhe ai kujton se atëhere Xh. Vendosi të qëndrojë jashtë vendit.

“Kjo ishte një prapaktheu e fortë për shoqatën dhe motivi të rinj të ndiqnin shembullin e tij. Por ajo nuk ndodh më,” thotë Almalek.

Beta/MDI, Beograd/Londër, 25 shtator 2002.

◀ Çfarë pasaporte të huaj ka? Dhe a është ai gay, apo vetëm pretendoi se ishte gay me qëllim që të bashkohej me shoqatën, të merrte një ftesë për t’u larguar nga vendi, dhe të qëndronte jashtë vendit? Ky artikull nuk e bën të qartë.

◀ Gazetari duhet të përfshinte një informacion nga ambasadat e huaja lidhur me qëndrimin e tyre ndaj ftesave të gay jashtë vendit. A ka ndryshuar pasi disa njerëz janë përpjekur të qëndrojnë në ato vende pasi kanë marrë një vizë afatshkurtër?

◀ Çfarë dallimi ka midis njerit që është aktiv dhe të tjerëve që janë aktivistë?

◀ A ishte e njëjta edhe për lezbiket, apo vetëm për homoseksualët meshkuj?

◀ Çfarë është ky çmim më konkretisht? Kush e jep atë? Dhe kush është Genc Xh e çfarë bëri ai për të fituar këtë çmim?

◀ A qëndroi jashtë në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme? Nëse ishte në mënyrë të ligjshme, atëhere nuk do të ndodhë që edhe të tjerët të marrin ftesa. Nëse ishte në mënyrë të paligjshme, gazetari duhet të intervistonte diplomatët amerikanë në Shqipëri për të komentuar një gjë të tillë.

◀ Sa të tjerë ndoqën shembullin e tij dhe emigruan? A qëndruan shumë prej tyre jashtë në mënyrë të paligjshme pasi ftoheshin për të marrë pjesë në ngjarje të gay?

11. Opozita politike dhe disidentët

Opozita politike dhe disidentët

Një prej përpjekjeve më të mëdha në vendet post-komuniste është si të gjendej një mënyrë për të përshtatur një shumëllojshmëri të pikëpamjeve politike dhe të pranohej shprehja e mendimeve të ndryshme si një element i zakonshëm dhe i natyrshëm i shoqërisë civile. Disa kanë qënë më të suksesshëm në këtë tranzicion në krahasim me të tjerët dhe kanë bërë përpjekje të mundimshme për të nivelizuar fushën ku zhvillojnë politikën e tyre partitë e opozitës me të tjerë opinionet e të cilëve mund të mos jenë në përputhje me ato të shumicës.

Megjithatë në shumë vende e rajone procesi mbetet i papërfunduar. Edhe kur thonë se e kanë dëshirën e mirë për të toleruar pikëpamjet e tjera, shpesh qeveritë vendore dhe kombëtare përpiqen të ngrejne pengesa ligjore, politike dhe ekonomike për ta bërë më të vështirë që qytetarët në opozitë të thonë fjalën e tyre. Ndonjëherë njerëzit që nuk janë dakord me orientimin e atyre që janë në pushtet trajtohen si jobesnikë ose edhe si tradhëtarë dhe mund të akuzohen pa të drejtë për aktivitet kriminal.

Gazetarët dhe organet e medias ndonjëherë bien pre në këtë shtypje të pikëpamjeve të kundërta, për një sërë arsyesh. Vetë mund të jenë nën presion të madh si nga autoritetet ashtu edhe nga interesat e biznesit. Ose gazetarët mund të besojnë me të vërtetë se njëra ose tjetra palë në debatin e vazhdueshëm në shoqëri është e jashtëligjshme dhe nuk meriton të drejtën për të paraqitur argumentet e saj. Shpesh organet e medias mbështesin qeverinë, megjithëse ka edhe gazetarë që përfaqësojnë forca opozitare, të cilat mund të përpiqen të ndalojnë botimin e versionit zyrtar të ngjarjeve.

Lejimi i mundësisë të të gjithë pjesëmarrësve në një debat është, ose duhet të jetë, një prej roleve kryesore të shtypit në shoqëri. Më poshtë janë disa mënyra për të siguruar që të ndodhë një gjë e tillë:

★ Identifikoni boshllëqet në organin tuaj të medias në mbulimin e një teme të tillë duke rishikuar arkivat. A jeni përqëndruar vetëm në një parti politike apo keni cituar vetëm persona që mbështesin vetëm njërin anë të një pikëpamjeje? A u është dhënë mundësi të reagojnë ndaj akuzave kundër tyre udhëheqësve të opozitës dhe të tjerë që sfidojnë autoritetet? A janë lënë krejtësisht mënjanë zërat e pakënaqur?

★ Sigurohuni që të mos kufizoni mbulimin e çështjeve të rëndësishme lidhur me mendimet e shumicës ose të autoriteteve. Nëse qeveria ndërmerr veprime ose bën njoftime, gjeni njerëz që nuk janë dakord me politikën e propozuar ose të ndjekura. Këta mund të jenë politikanë të tjerë, por edhe akademikë, përfaqësues të organizatave joqeveritare, biznesmenë, ose persona në rrugë.

★ Kultivoni burime ndër udhëheqësit opozitarë. Kontaktojini ata dhe rregulloni një takim jozyrtar për të diskutuar lidhur me shqetësimet, opinionet, bindjet dhe idetë e

tyre. Mos premtoni që ju gjithnjë do të fusni mendimin e tyre, por nxitini që të lidhen gjithnjë me ju kur kanë diçka që dëshirojnë ta komentojnë.

★ Kur qeveria propozon një ligj të ri ose rregullore, analizojeni atë me kujdes. Shihni se cilët ndihmon ai dhe cilët dëmton dhe pastaj flisni me përfaqësues të grupeve të njerëzve që dëmtohen. Mos pranoni argumentat e autoriteteve që justifikojnë politikën e tyre menjëherë.

★ Mos i përshkruani njerëzit që kundërshtojnë qeverinë si “disidentë” ose të përfshirë në “të menduar si disident.” Mbani parasysh se në një shoqëri pluraliste shumëllojshmëria e pikëpamjeve dhe e pozicioneve politike është një gjendje normale. Njerëzit që nuk janë dakord, sado të ashpër të jenë, me politikën qeveritare nuk duhet të ulen në kategori të veçantë sepse ata ushtrojnë një të drejtë njerëzore bazë. Ata thjesht janë njerëz të cilët nuk janë dakord me ata që janë në krye.

★ Mos i thelloni dallimet midis pozitive të mbështetura nga individë ose parti të ndryshme. Shpesh vetë njerëzit, sidomos politikanët, do të mbiçmojnë çështjen e tyre për të fituar pikë tek publiku ose për t’u dukur sikur janë kurajozë. Kur shkruani për çështje të ndryshme ku ka mendime të ndryshme, sigurohuni që të karakterizoni pozicionet e ndryshme me saktësi dhe të shmangni retorikën nxitëse.

★ Udhëheqësit e opozitës ose të tjerë që nuk janë dakord me qeverinë mund të jenë dogmatikë dhe autoritarë po aq sa edhe ata që janë në pushtet. Fakti që ata kundërshtojnë autoritetet e momentit nuk do të thotë se ata do të sillëshin krejtësisht ndryshe nëse do të ishin në pushtet. Sfidojini që ata të dalin tej slloganeve anti-qeveritare dhe të shpjegojnë programin e tyre. Si gazetar duhet të jeni skeptik për pretendimet e të gjithëve në një debat ose çështje sociale.

Raste për studim

Në serbisht “shiptar” përdoret me kuptim përbuzës dhe gjithnjë përdoret për të gjeneruar lidhje me terrorizmin dhe ekstremizmin. Titulli dhe nëntitulli krijojnë përshtypjen se kriza ka ardhur vetëm për faj të shqiptarëve nga Kosova, sepse ata janë të pashpirt dhe nuk do të ndalojnë para asgjëje për të arritur objektivin e tyre të pavarësisë.

11. a) Çfarë ofrojnë udhëheqësit shiptarë si zgjidhje për krizën e Kosovës? – Pavarësi përmes luftës apo paqes

Serbët nuk do të heqin dorë lehtë nga territori, Rugova kërkon një Kosovë të pavarur, Thaçi ëndërron për një Shqipëri të madhe, Surroi sugjeron një skenar taivanez të trefishtë.

Beograd – Ngjarjet në jug të Serbisë tregojnë se shiptarët duan më shumë se një Kosovë të pavarur – ata duan të përmbushin ëndërrën e tyre një shekull e gjysmë të vjetër për një Shqipëri të madhe.

Ndërmjet shiptarëve në Prishtinë flitet për një luftë të re. Burime të mirëinformuara i kanë thënë *Glas* se Thaçi planifikonte të ndërmernte aksione në jug të Serbisë në shtator, por ndryshoi mendje për shkak të zgjedhjeve në Kosovë, ku ai shpreson të siguronte një fitore të lehtë. Tani që ka fituar Rugova dhe që në Beograd Milosheviçi është zëvendësuar nga Vojislav Koshtunica, një person që bota e respekton, Thaçi është bërë nervoz. Ai nuk po duron të përfundojë punën e tij para zgjedhjeve të dhjetorit në Serbi dhe të fitoj pikë ndër bashkëatdhetarët e tij para zgjedhjeve në Kosovë të planifikuara pranverën e ardhshme.

Ish-Prokurori i Tribunalit të Hagës, Richard Goldstone, mbështet atë që ai e quan si pavarësi të kushtëzuar për Kosovën. Goldstone shpjegon se ai do t'i jepte shiptarëve një afat kufi pesëvjeçar për të vendosur institucionet demokratike. Nëse dështojnë, Goldstone do të “rivendoste statusin e tyre të mëparshëm”. Kjo mënyrë e lehtësimit të tensioneve politike është e panjohur në historinë politike.

Thaçi mendon se ai mund të arrijë në majë të politikës në Kosovë duke sulmuar përsëri policët serbë e duke ndezur luftën – metoda që ai i ka përdorur për të hyrë në skenën politike në fillim.

Kjo e tejmbush këtë rast, meqë pjesa tjetër e artikullit e bën të qartë se vetëm disa shqiptarë nga Kosova duan një Shqipëri të madhe. Për më tepër, toni i gazetarit është diskreditues i çdo lloj aspirate për një Shqipëri të madhe edhe pse shumë serbë vetë ëndërrojnë për një Serbi të madhe.

◀ Cilët janë këta kosovarë që flasin për një luftë të re? Çfarë thonë ata? Dhe duhet të dimë më shumë lidhur me këto “burime të mirëinformuara” që të jemi në gjendje të gjykojmë informacionin e tyre. A janë ato shqiptarë? Serbë? Si janë vënë në dijeni lidhur me planet e Thaçit?

Ky është një pretendim tepër i gjerë dhe i paqartë. Cila mënyrë e lehtësimit të tensioneve është e panjohur, më konkretisht? Afati pesëvjeçar? Kërcënimi për të rivendosur statusin e mëparshëm? A ka bërë kërkime gazetari në të gjithë historinë politike përgjatë kohëve me qëllim që të gjejë mbështetje për pretendimin e tij? Apo është thjesht mendimi i gazetarit?

Është vështirë të mendohet se ai do të jetë në gjendje të gjejë mbështetje të huaj siç bëri dy vjetë më parë. Fakti që ka një spital shumë mirë të pajisur në Dobroshin, kështjella kryesore terroriste në jug të Serbisë, tregon se janë bërë përgatitje të kujdesshme. Kjo i shqetëson ata që mbështesin një opsion më paqësor, mbi të gjitha Rugovën, të cilët janë të shqetësuar se komuniteti ndërkombëtar mund t'u kthejë shpinën.

Udhëheqësi i të ashtuquajturës UÇK, Hashim Thaçi, mezi po pret. Mendohet se në njëfarë mënyre ai po hakmerret ndaj Rugovës pasi ky i fundit fitoi në zgjedhjet vendore. Ibrahim Rugova mendon se bisedimet me autoritetet në Beograd mund dhe duhet të zhvillohen, por vetëm për një tematikë, pavarësinë e Kosovës.

Pas kaq shumë vuajtjesh është shumë vonë të flitet për ndarje të Kosovës, ose për shpalljen e Kosovës si republikë të tretë jugosllave. Ne mbështesim pavarësinë, por ne do të përpiqemi ta arrijmë atë me mjete demokratike, bisedime dhe një referendum mbi të ardhmen e Kosovës i tha *Glas-it* një burim në Lidhjen Demokratike të Kosovës të Rugovës.

Gazetari dhe publicisti Veton Surroi mbështet një skenar taivanez të trefishtë. Ndërkohë që administrata amerikane sugjeron një marrëdhënie federative ndërmjet Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës, Surroi propozon një marrëdhënie të ngjashme me atë midis Kinës dhe Taivanit, në të cilën Serbia, Mali i Zi dhe Kosova nuk do të jenë shtete të pavarur, por do të administrojnë territoret e tyre përkatëse. Kina e konsideron Taivanin si një prej provincave të saj dhe e pranon sovranitetin e tij, por jo pavarësinë.

Megjithatë Surroi me dinakëri nuk merr parasysh faktin që Kina ka të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të KB, ku ajo mund të bllokojë çdo propozim taivanez.

Nuk ka dyshim se Kosova dhe Metohija do të mbeten, për një kohë të gjatë në të ardhmen, në rendin e ditës të Këshillit të Sigurimit, OSBE-së, BE-së... Le të shpresojmë se gjuha e forcës do të zëvendësohet me atë të diplomacisë.

◀ Mund të jetë e vërtetë kjo që thuhet, por gazetari nuk jep asnjë provë për ta mbështetur atë. Ku e mori ai këtë informacion? Me cilët foli ai? A u përpoq të fliste me vetë pjesëmarrësit?

◀ Sërisht nënkuptimi këtu është se vetëm shqiptarët në Kosovë dhe aleatët e tyre kanë përdorur gjuhën e forcës dhe se vetëm serbët kanë përdorur gjuhën e diplomacisë.

Glas Javnosti, Beograd, 27 nëntor 2000.

Titulli menjëherë sugjeron se ka diçka të paligjshme në përkujtimin e ngjarjes ku u vranë mijëra njerëz. Gazetari natyrisht që duket se është i fyer nga mënyra e mbajtjes së shërbimit përkujtimor, por ai nuk interviston asnjë mysliman se përse ata mendojnë se është e rëndësishme të marrin pjesë në të, ose ndonjë serb për të parë përse janë të shqetësuar.

11. b) Manipulimi i një përkujtimoreje

Dje në Potocari pranë Srebrenicës

Anëtarët myslimanë dhe kroatë të Presidencës së Bosnie Hercegovinës, përkatësisht Alija Izetbegovic dhe Ante Jelavic, morën pjesë në një përkujtimore myslimane në Potocari, pranë Srebrenicës që u zhvillua sot, duke i dhënë në këtë mënyrë një ngjyrim politik grumbullimit.

Për më tepër, kreu i komunitetit fetar islamik, Mustafa Cerić, foli para 3.000 myslimanëve të pranishëm në ceremoninë fetare me mesazhe që i kalonin kufijtë fetarë.

Gjarja ishte më shumë një pushtim nga forcat myslimane e ndërkombëtare të pjesës lindore të Republika Srpska e jo një predikim për ata që vdiqën në Srebrenicë.

Organizatorët e grumbullimit nuk morën parasysh rekomandimet e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë në Bosnie Hercegovinë, e cila është pranuar nga autoritetet në RS, që hapësira e kufizuar e bënte të pamundshme vendosjen e 15 autobusëve me rreth 700 myslimanë.

Në vend të kësaj mbërritën 56 autobusë dhe shumë vetura private nga Federata e Bosnie Hercegovinës.

Në grumbullimin e sotëm në Potocari mori pjesë edhe Përfaqësuesi i Lartë Wolfgang Petritsch, kryetari i misionit të KB në BiH Jacques Klein, ambasadorët e SHBA-së, Kroacisë, Turqisë, Iranit, Egjiptit, Zvicrës, Britanisë së Madhe dhe Portugalisë, presidenti dhe kryeministri i Federatës së BiH përkatësisht Ejup Ganić dhe Ethem Bicakčić e të tjerë.

Mbërritja dhe qëndrimi i myslimanëve në Potocari u zhvillua pa probleme sigurie ose të tjera.

◀ Kjo nënkupton se të dy zyrtarët nuk duhet të kishin marrë pjesë në ceremoni edhe pse ngjarja ishte një pikë kthese në luftë. Gazetari mund t'i pyeste ata, ose përfaqësuesit e tyre, përse e ndjenë të nevojshme të merrnin pjesë.

◀ Ç'do të thotë se ai kaloi kufijtë fetarë? Çfarë tha tjetër ai? Përse ishte jo e përshtatshme? Gazetari duhej të raportonte fjalët e tij e jo të bënte gjykime lidhur me to.

◀ Përdorimi i termit "pushtim" është nxitës. Krijon përshtypjen e hordhive të myslimanëve e të tjerë që vijnë vërdallë në mënyrë të shfrenuar kur në fakt atje u zhvillua një shërbim fetar.

◀ Përse gazetari nuk intervistoi organizatorët dhe t'i pyeste lidhur me rekomandimet? Dhe në qoftë se hapësira ishte e kufizuar, si ndodhi që u rregulluan 56 autobusë dhe 3000 myslimanë?

◀ Meqë ngjarja duket se është zhvilluar pa trazira ose ndërlikime të tjera duket se kjo gjë është në kundërshtim me faktin se jo më shumë se 700 myslimanë mund të vendoseshin aty dhe se kjo ishte në njëfarë mënyre një 'pushtim.'

Policë serbë u vendosën çdo 50 metra përgjatë 80 kilometrave nga Luka pranë Vlasenica deri në Potocari. Bratunac, Potocari dhe Srebrenica ishin sot plot me automjete, ushtarë të SFOR-it, policë ndërkombëtarë (IPTF), organizata dhe gazetarë ndërkombëtarë.

Tanjug/Politika, Beograd, 12 korrik 2000.

12. Fotografia dhe pamja

Fotografia dhe pamja

Në shumë aspekte fotografia që shoqëron një shkrim luan një rol vendimtar në transmetimin e informacionit po aq sa edhe fjalët. Qofshin fotografi në gazetë apo pamje të videos, elementët vizivë mund të japin mesazhe të fuqishme dhe shpesh emocionale për lexuesit dhe shikuesit. Ndonjëherë këto mesazhe nuk dallohen as nga ata që zgjedhin pamjen, që mund të mos jenë të ndërgjegjshëm për ndikimin e tyre që krijojnë në mënyrë të pandërgjegjshme.

Kur vendoset si të ilustrohet një shkrim është e rëndësishme të keni parasysh se pamjet mund t'i nguliten lexuesit dhe shikuesit për një kohë të gjatë. Ata mund edhe të mos e lexojnë tekstin, ose mund të vënë re vetëm titullin ose diçiturën e fotografisë. Prandaj është tepër kritike përzgjedhja e pamjeve që do të pasqyrojnë thelbin e materialit dhe jo ta kundërshtojnë ose të bien ndesh me atë që ju doni të shprehni.

Ja disa sugjerime si të bëhet një gjë e tillë:

- ★ Sigurohuni që pamja të përputhet me thelbin e shkrimit. Ndonjëherë fotografia ose pamja e videos më e fuqishme mund të ketë vetëm lidhje të përciptë me atë që merret shkrimi. Për shembull, fotografia e një refugjati me pamje të uritur që është duke lypur mund të ngjallë simpati tek disa dhe neveri tek të tjerë, por ndoshta nuk është e përshtatshme për një artikull lidhur me azilkërkuesit që organizohen për të kërkuar kushte më të mira jetese.

- ★ Gazetari dhe fotografi duhet ta diskutojnë shkrimin paraprakisht dhe, nëse është e mundshme, të punojnë si ekip. Në shumë gazeta, gazetarët dhe fotografët i kushtojnë pak vëmendje njëri tjetrit dhe harrojnë se përgjegjësitë e tyre, edhe pse janë të dallueshme nga njëra tjetra, janë shumë shumë të lidhura. Shkrimtarët duhet të pranojnë që një shkrim i ilustruar bukur do të lexohet më shumë. Fotografët duhet ta kuptojnë se një tekst shumë mbresëlënës jep një kontekst vendimtar për pamjet e tyre.

- ★ Është më mirë sikur gazetari që ka bërë një shkrim të thotë fjalën e tij për foton ose pamjen që duhet të përdoret, ose të paktën të informohet për përzgjedhjen e bërë. Zakonisht gazetarët janë më pranë ngjarjes. Shkrimi dhe futja e fotografive pa u konsultuar me ta mund të bartë rrezikun e shtrembërimit të kuptimit ose përmbajtjes së shkrimit.

- ★ A pasqyron ose përshkruan me saktësi diçitura fotografinë? Gjithnjë është mirë të përfshihet një diçiturë për të vendosur ilustrimin në kontekstin e duhur në qoftë se ju nuk jeni i bindur që ajo është vetë-shpjeguese. Megjithatë, sigurohuni që artikullshkruesi ta ketë lexuar dhe ta ketë miratuar diçiturën për të pakësuar mundësinë e gabimeve.

★ Jini të ndërgjegjshëm kur fusni fotografi që vetëm mund të shërbejnë për të përforcuar stereotipet. Pamje të tilla zakonisht janë të mërzitshme dhe pak shërbejnë për të ndriçuar informacionin. Të gjithë kanë parë qindra foto të prostitutave që dalin në anët e rrugëve. Një zgjedhje më interesante do të ishte një foto që e tregonte atë (prostitutën) në një kontekst tjetër ose në një situatë të papritur, për shembull, duke marrë pjesë në leksione në universitet, ose duke gatuar darkën për fëmijët e saj.

★ Mos i ndryshoni fotografitë veçse për të përmirësuar cilësinë e pamjes ose për të errësuar fytyrën e dikujt, që kërkon të mos identifikohet. Tani është jashtëzakonisht e lehtë të manipulohet teknologjikisht me pamjet, për shembull, duke hequr disa njerëz ose duke vendosur dy individë së bashku. Por të bësh një gjë të tillë do të thotë të shtrembërosh detyrimet gazetareske në transmetimin e informacionit në mënyrë të saktë e me ndershmëri.

★ Kujdes me pamjet e dhunës ekstreme ose me paraqitje të tjera grafike për to. Mund të jetë e rëndësishme që ato të përdoren për të ilustruar disa materiale, lidhur me ndodhitë fatkeqe gjatë luftërave, për shembull, ose për të nxjerrë në pah një pikë lidhur me diskriminimin ose padrejtësinë sociale. Por mund të ketë edhe një linjë të rregullt midis gazetarisë efikase dhe shfrytëzimit. Nëse ilustrimi vetëm i shqetëson njerëzit dhe në të njëjtën kohë nuk i detyron ata të mendojnë, ndoshta do të ishte më mirë që përzgjedhja e saj të mendohej edhe njëherë.

13. Modulet e trajnimit

Modulet e trajnimit

Një seksion trajnimi për raportimin mbi diversitetin mund të zgjasë disa orë, disa ditë, ose edhe një javë. Ai mund të prezantohet si pjesë e një kursi më të gjatë gazetarie ose si një seminar i vecantë. Meqë përmbajtja dhe struktura do të varen nga nevojat e vecanta të gazetarëve pjesëmarrës, është e pamundur të ofrosh rregulla të gatshme dhe të pandryshueshme për procedurën.

Megjithatë, qasja me module e paraqitur këtu iu jep mundësi trajnerëve të qëmtojnë dhe zgjedhin elementet të cilat funksionojnë më mirë për një audiencë të caktuar. Pyetjet që dalin në cdo modul mund të diskutohen shkurtimisht ose gjatë, por një rregull i mirë paraprak është të lejohet afërsisht gjysëm dite për të eksploruar në mënyrë complete çështjet e adresuara në modulën e caktuar.

Gjatë përcaktimit të diskutimeve tuaja, përpikuni të përdorni një përzgjedhje sa më të gjerë të shembujve që të jetë e mundur, përfshirë materialet e shkruara nga pjesëmarrësit, artikujt nga kopjet e fundit të gazetave rajonale, si dhe shembuj të tjerë studimi nga ky manual, nëse është e përshtatshme për subjektin në fjalë. Kini parasysh gjithashtu, që modulet janë planifikuar për t'u mbështetur te njëri-tjetri, me njërin modul që ndihmon të krijojë mirëkuptimin dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm për të zbuluar këto probleme komplekse gazetarie.

Udhëzimet e mëposhtme gjithashtu mund të hyjnë në punë.

- 1) Për një seminar gjysëm ditor përqëndrohuni në Modulën e Parë.
- 2) Për një seminar një ditor përqëndrohuni në Modulën e Parë dhe të Dytë
- 3) Për një seminar dy ditorë përqëndrohuni në Modulet nga i Pari te i Katërti
- 4) Për seminarë më të gjatë se dy ditë, përpikuni të punoni me të gjitha modulet

Pavarësisht nëse seminari është gjysëm ditor ose një javor, nxitini të gjithë pjesëmarrësit të hartojnë një plan veprimi individual, i cili do të ndihmojë në forcimin e angazhimit të tyre ndaj raportimit të diversitetit.

PËRGATITJA PARAPRAKE PËR SEMINAR

Detyra paraprake për Seminarin për pjesëmarrësit.

Udhëheqësi i seminarit duhet të kërkojë që secili nga pjesëmarrësit në seminar të sigurojë informacionin e mëposhtëm të paktën katër javë para fillimit të seminarit. Materialet duhet t'i dërgohen udhëheqësit të seminarit për kontroll dhe përgatitjen e dosjeve.

Secili nga pjesëmarrësit duhet të dërgojë materialet e mëposhtme:

- ★ Pesë numra të gazetës ku punon pjesëmarrësi.

★ Shembull të një artikulli të gjendur në gazetën e pjesëmarrësit, apo të një kronike në një emision radiofonik apo televiziv, i cili mund të duket si një raportim i mirë, i ndërtuar mirë, dhe i balancuar.

★ Shembull të një artikulli nga gazeta e pjesëmarrësit, ose nga një emision radiofonik ose televiziv, të cilin pjesëmarrësi e konsideron të jetë një shembull ku mungon diversiteti për nga mënyra e raportimit, shkrimit, dhe redaktimit.

Secili nga pjesëmarrësit duhet të sigurojë të dhënat e mëposhtme:

★ Grupet e ndryshme etnike në zonën e pasqyruar si dhe shifrat e përafërta të popullatës.

★ Përqindja e përafërt e popullatës që është nën 25 vjec, midis 25 dhe 40 vjec, midis 41 dhe 60, si dhe mbi 60 vjec.

★ Përqindja e përafërt e grave në zonën e pasqyruar.

Një vlerësim paraprak para seminarit nga drejtuesi Para hapjes së seminarit drejtuesi duhet të kalojë me kujdes gazetat dhe kasetat e dërguara nga pjesëmarrësit në seminar, si dhe informacionin demografik. Drejtuesi duhet të vlerësojë pikat e forta dhe të dobëta të gazetës. Drejtuesi i seminarit duhet të kërkojë shembuj specifikë të përdorimit të papërshtatshëm të gjuhës, të cilat mund të konsiderohen fyes për një segment të popullsisë; si dhe të kërkojë shembuj stereotipesh në brendinë e artikujve. Drejtuesi i kalon materialet e dërguara nga secili pjesëmarrës ashtu si do bënte një lexues nga zona e pasqyruar në gazetën e secilit pjesëmarrës.

Shembujt që duhet të kërkojë drejtuesi i seminarit për pikat e forta dhe të dobëta duhet të përfshijnë rastet e mëposhtme:

1. Pasqyrimin e grupeve të vecanta etnike apo racore si probleme brenda komunitetit, të bazuara mbi gjuhën e artikujve ose për tonin e vecantë të artikujve

Gazeta ka pasqyrimin e mosmarrëveshjeve që përfshijnë grupe të ndryshme racore apo etnike, por nuk ka pasqyrim të të njëjtave grupe etnike në procese pozitive, produktive, dhe kontribuese brenda komuniteteve të tyre apo në komunitetin e përgjithshëm.

2. Gjatë pasqyrimin të të gjithë javës, artikujt për krimin që janë raportuar kryesisht kanë të bëjnë me keqbërës nga një grup i vetëm etnik ose racor.

Përshkrimet e të dyshuarve për krime janë të gjithë nga një grup etnik ose racor dhe janë shumë përgjithësues në vend që të jenë specifikë. Shembull: "Mashkull zeshkan, 5'8" i gjatë, 100 kg" në vend që të ketë një përshkrim që përfshin veshjet, këpucët, etj.

3. Redaktim jokonsistent

A përdorin artikujt nëpër gazeta apo emisionet në radio ose televizione gjuhë që është fyese apo që përmban stereotipe për një grup të caktuar etnik, për të moshuarit, njerëzit me paaftësi, apo ndaj femrave?

4. Pasqyrim i varfër lokal

A paraqesin gazetatat, apo emisionet radiofonike dhe televizive artikuj dhe kronika të reja për ngjarje lokale që përfshijnë grupe të ndryshme racore apo etnike, për të moshuarit, njerëzit me paaftësi, apo femrat, në mënyrë të vazhdueshme?

5. Pasqyrim i pamjaftueshëm i komuniteteve etnike

A sigurojnë gazetatat dhe emisionet radiofonike dhe televizive pasqyrim të grupeve të vecanta etnike apo të pakicave fetare? Nëse ky pasqyrim ekziston, a përmban ai përdorimin e klisheve, stereotipeve, apo përcaktime fyese të këtyre grupeve?

6. Mospërfshirje të anëtarëve të komunitetit etnik në pasqyrimin e rregullt.

A kanë gazetatat dhe emisionet radiofonike dhe televizive pasqyrim të njerëzve të biznesit, doktorëve, avokatëve, dhe profesorëve, si burime informacioni në artikuj, të cilët janë anëtarë të grupeve të ndryshme etnike, fetare, apo racore? A

konsultohen ata në lidhje me tema që nuk kanë lidhje me racën, etninë, apo përkatësinë e tyre fetare? A përdoren femrat si burime informacioni në artikuj apo kronika rreth të gjitha elementeve të jetës në një komunitet?

Një shembull: Një artikull përqendrohet te doktorët në një spital lokal, të cilët diskutojnë nevojat shëndetësore të grave shtatzëna si dhe rëndësinë e kujdesit shëndetësor para lindjes. A ka doktorë të cituar të cilët janë femra ose anëtarë të grupeve të ndryshme fetare ose etnike?

7. Në pamjet e gazetave nuk paraqiten në masën e duhur femra, pakica dhe "të tjerë".

A paraqesin gazetatat dhe emisionet radiofonike dhe televizive foto të njerëzve të cilët janë anëtarë të grupeve të pakicave në pasqyrimin rutinë? Po përsa i përket femrave, të moshuarve, apo njerëzve me paaftësi?

Një shembull: A janë fotografitë e përdorura në artikull për doktorët, të cilët po e vënë theksin në një kujdes më të madh shëndetësor para lindjes? Kush u zgjodh për t'u fotografuar? Mashkull apo femër; doktor nga një grup etnik? Po ndonjë doktor i cili është i paafte fizikisht?

Drejtuesi i seminarit duhet të organizojë mate-

rialet e nxjerra nga shembujt e lajmeve të dërguara nga pjesëmarrësit dhe t'i përdorë ato si shembuj për modulet që do të pasojnë. Nëse nuk është e mundur që të plotësohen formularët e vlerësimit paraprak të seminarit të dërguara nga pjesëmarrësit, secili modul do të sjellë materiale shtesë të cilat mund të përdoren si shembuj.

Udhëheqësi i seminarit duhet të ndërtojë një mekanizëm për grumbullimin e materialeve për përdorim në procesin e seminarit dhe t'i përdorë ato për seminare të ardhshme sipas nevojës.

8. Nuk ekziston elementi i kontekstit historik në artikuj apo kronika ku përkatësia racore, etnike, apo fetare janë elementë të artikullit apo kronikës.

A paraqet gazeta, radioja, apo televizioni një kontekst të saktë historik në artikuj apo kronika ku përkatësia etnike, racore, ose fetare janë të rëndësishme për artikullin ose kronikën? Nqs po, historinë e kujt? Si e përcaktojmë nëse konteksti historik është i saktë dhe i përshtatshëm?

Materialet e dërguara nga pjesëmarrësit, bashkë me analizën e lexuesit, do të përbëjnë material thelbësor për ndërhyrjet e udhëheqësit dhe për diskutimet në grup gjatë seminarit ose trajnimit.

Moduli i Parë:

HISTORIA KUNDREJT DIVERSITETIT

Qëllimi:

Të sigurohet një mundësi për të diskutuar një histori përjashtimi brenda komuniteteve tona si dhe efektin që ka pasur ky përjashtim në zhvillimin e komuniteteve tona. Duke parë shkurtimisht në të kaluarën, secili pjesëmarrës duhet të jetë në gjendje të ndërtojë një model të ri përfshirjeje në punën e tij në media.

Parimi:

Mediat informative kanë mundësinë t'i japin formë diskutimit dhe të përcaktojnë hapësirat e përbashkëta nëpërmjet raportimit të saktë dhe të paanshëm.

Rezultati: Të gjitha segmentet e shoqërisë sonë do të bëhen pjesëmarrëse duke lehtësuar izolimin e vërtetë dhe atë të hamendësuar që ka përbërë një realitet historik për shumë grupe.

Roli i medias në konfliktet e vazhduara brenda një komuniteti, shteti, ose kombi, ka qenë vëmendja e studimeve dhe sugjerimeve për ndryshim për dekada të tëra. Pavarësisht nëse diskutimi ka lidhje me emigrantë të rinj apo me grupe etnike të cilat kanë qenë pjesë e peisazhit kombëtar për një kohë të gjatë, gazetarët kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur përta të përket sensibilizimit në lidhje me ndryshimet në popullsi ose ndikimin e kulturave të pakicave tradicionale në zhvillimin e kombit si duket sot ose si do të duket në të ardhmen.

Cdo komb ka një ose më shumë grupe të cilat nuk konsiderohen pjesë e tij. Në Mbretërinë e Bashkuar, emigrantë nga ish-kolonitë britanike në Afrikë, Karaibe, apo Azinë Jugore, janë ankuar dekada me radhë për përjashtimin, stereotipet, dhe urrejtjen nga ana e të bardhëve. Për shumicën e ish-kolonive të kombeve europiane ka pasur një reagim negativ atëherë kur qytetarët nga kolonitë janë transferuar në tokën që fliste të njëjtën gjuhë me ta, për shkak të rrethanave historike. Emigrantë nga kolonitë e mëparshme kanë zbuluar, për

keqardhjen e tyre të madhe, që të kesh një gjuhë të përbashkët nuk do të thotë patjetër të të presin me krahë hapur.

Në shumë vende të tjera të Europës, prania e popullsisë emigrante ka sjellë me vete konceptime të gabuara dhe mosbesim të cilat shpesh nuk janë sqaruar ose zgjidhur deri në zhvillimin e konflikteve të mëdha. Ndërkohë, në kombe të tjera hendeqet kulturore kanë ekzistuar për qindra vjet pa u gjetur një zgjidhje.

Gazetarët, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, shpesh zihen në befasi dhe janë të paaftë për të kuptuar perspektivën historike që nevojitet për të nxitur mirëkuptimin dhe tolerancën në komunitet. Përkundrazi, gazetarët janë akuzuar se kanë ndezur konflikte dhe urrejtje, si dhe kanë thëlluar ndarjet në komunitete, pasi nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë një perspektivë të vërtetë historike gjatë pasqyrit të lajmeve.

Historia e përjashtimit social ka lënë viktimat e saj në të gjithë botën. Nuk ka shtet që të ketë mbetur i paprekur nga konfliktet që lindin nga ndryshimet ekzistuese, ose që ne mendojmë se ekzistojnë dhe na bëjnë ne të ndryshëm nga fqinjët tanë.

Në këtë kohë shumë pjesëtarë të komunitetit tonë mund të mos e dinë pse filloi përjashtimi historik; megjithatë të gjithë e dinë se përjashtimi është një pjesë përbërëse e jetës në komunitet. Ata të cilët janë pakicë janë të padukshëm, ose e konsiderojnë veten të padukshëm. Herët a vonë ata të cilët janë përjashtuar do të zemërohen, do të kërkojnë përfshirje, dhe kërkesat e tyre mund të ndezin një reagim i cili shpie në një intolerancë, paragjykim, përjashtim akoma më të madh, madje edhe në konflikt të dhunshëm.

Mediat informative kanë një rol kyc në uljen e tensionit të krijuar nga përjashtimi historik. Ato iu krijojnë mundësi të gjithë njerëzve për të marrë pjesë falë rrjedhës së lirë të informacionit, janë një zonë e sigurtë për debat, dhe ndërsa debati ndizet,

ato krijojnë mundësinë që komuniteti të përfshihet në çështje që janë thelbësore për jetën e përditshme. Në fakt, hapi i parë është përfshirja e të gjitha grupeve në pasqyrimin e përditshëm të çështjeve sociale sic janë shëndeti dhe mirëqenia, ekonomia, arsimi, dhe jeta familjare e komunitetit.

Është pikërisht ky pasqyrim i jetës së përditshme me synim për të përfshirë cdokë që i siguron gazetarit mundësinë e rrallë për të ndërtuar një proces komuniteti të ndryshëm pa qenë nevoja të përdoret militantizmi.

Gazetarët janë ose bëhen kronikanët e jetës në komunitetet tona. Ata kanë mundësinë të lëvizin nëpër komunitet duke grumbulluar informacion dhe fakte të cilat mund t'i thurin së bashku në artikuj ose kronika për jetët e njerëzve të cilët përbëjnë shoqërinë. Gazetarët, pa mbajtur një qëndrim partizan, mund të krijojnë një hapësirë publike për diskutim që con në krijimin e zonës së përbashkët për komunitete të ndryshme nga njëra -tjetra.

Shembull: Një gazetar në një gazetë shkruan një sërë artikujsh rreth vështirësive ekonomike në një qytet të madh. Ai punon shumë që të gjejë burime nga grupe të ndryshme etnike, racore, ose fetare, nga banorë të moshuar, si dhe femra që kanë vështirësi ekonomike. Duke përzgjedhur me kujdes burimet që duhen përdorur, gazetari ka hedhur një hap drejt krijimit të një grupi të përbashkët si lexues të cilët kanë mundësinë të vënë re që ata kanë përvoja të njëjta me njerëz të cilët besonin se kishin ndryshime të thelbësore nga ata vetë.

Shënim për Drejtuesin

★ Sillni shembuj të tjerë artikujsh që mund të kenë dhënë mundësinë ta shohin këtë lloj pasqyrimi përfshirës nga shembujt e dhënë nga gazetaret ose kronikat e dërguara nga pjesëmarrësit para seminarit.

★ Kërkoni nga pjesëmarrësit që të vrasin mendjen për mënyrën se si artikujt mund të bëheshin më përfshirës. Cfarë do bënte gazetari për një pasqyrim më të gjerë, me diversitetin si qëllim?

★ Diskutimi i parë duhet bërë me gjithë grupin. Ndërkohë që pjesëmarrësit japin vlerësimet e tyre,

drejtuesi i seminarit duhet të fillojë t'u bëjë pyetje pjesëmarrësve në lidhje me përvojat e tyre me grupe të vecanta në kontekstin e shembullit të përdorur për të ndezur diskutimin.

Disa shembuj të pyetjeve që mund t'u drejtohen pjesëmarrësve:

★ A keni pasur ndonjëherë mundësi të punoni në një artikull me njerëz me prejardhje të ndryshme etnike, fetare, apo racore? Cili ishte reagimi i personit/presonave që kishit si burim informacioni?

★ A ishit në gjendje ta përdornit informacionin në artikull? A kishte artikulli të bënte vetëm me grupin etnik apo racor në mënyrë specifike? A do të kishte pasur më shumë efekt artikulli nëse fokusi do të zgjerohej aq sa të diskutonte realitetin ekonomik duke ndjekur linjat racore apo etnike?

Më pas, drejtuesi duhet të sjellë një shembull të dytë, të cilin pjesëmarrësit do ta diskutojnë në grupe të vegjël prej tre ose katër vetash. Secili grup duhet të hartojë një plan pasqyrimi për të përmirësuar sensin përfshirës të artikullit.

Drejtuesi i seminarit në këtë pikë duhet t'i kërkojë secilit prej grupeve të vegjël të hartojë të paktën tre përfundime në lidhje me diversitetin, të nxjerra nga diskutimet në këtë modul. "Mësimet e nxjerra" mbahen shënim dhe paraqiten në muret e dhomës ku zhvillohet seminari. Drejtuesi i seminarit duhet t'ua bëjë të qartë gazetarëve që ky ushtrim tregon se procesi i përfshirjes do t'i ndihmojë ata në rolin e tyre si shkruar të historisë dhe që krijon një mundësi për t'iu ofruar konsumatorëve të mediave informative një këndvështrim të ekuilibruar, të përgjithshëm, dhe përfshirës të komunitetit.

Duke u nisur nga shënimet, secili pjesëmarrës duhet të jetë në gjendje të përmendë një hap veprimi të cilin do ta përdorin për të shtuar një kontekst të ri historik në pasqyrimin e tyre. Cdo pjesëmarrës duhet të jetë shumë specifik për hapin e mëtejshëm. Drejtuesi i seminarit duhet të kërkojë gjëra specifike të cilat cdo pjesëmarrës mund t'i marrë me vete dhe t'i vërë në përdorim. Një formular për hapa veprimi gjendet në fund të manualit.

Moduli i Dytë: ÇFARË ËSHTË LAJMI?

Qëllimi:

Përcaktimi i lajmit duke pasur parasysh diversitetin.

Parimi:

Diversiteti dhe zërat e anëtarëve të pakicës në komunitet pasurojnë dhe gjallërojnë pasqyrimin e komunitetit si një të tërë.

Çdokush ka një histori, po jo cdo histori përbën lajm!

Për të përcaktuar se çfarë përbën lajm, duhet të fillojmë me pyetjen e mësipërme.

Drejtuesi i seminarit pyet: Cili është përkufizimi juaj për lajmin?

Shënim për drejtuesin e seminarit

★ Secilit pjesëmarrës duhet t'i kërkohet të përkufizojë lajmin me shkrim në një letër të sjellë për këtë qëllim. Atëherë kur cdokush të ketë shkruajtur përkufizimet e tyre, pjesëmarrësit duhet të lexojnë përgjigjet e tyre ndërkohë që drejtuesi i seminarit mban shënim.

★ Mbjajtja shënim e përkufizimeve mund të bëhet në copa të mëdha letre, të cilat mund të vihen nëpër dhomë, në mënyrë që mund të shihen qartë ndërkohë që pjesëmarrësit bëjnë ushtrimin. Emrat e pjesëmarrësve nuk duhet t'u bashkangjiten përkufizimeve.

Sic tregon ky ushtrim, shumë prej nesh ende e kanë të vështirë të përkufizojmë lajmin. Pse? Sepse ka shumë shtresa dhe ngjyime për përkufizimin. Secili prej nesh sjell perspektivën e vet historike në përcaktimin nëse disa ngjarje përbëjnë lajm dhe i duhen raportuar lexuesve dhe shikuesve.

Produktet e gazetarisë: përkufizimet më të përdorura:

★ Informimi i publikut rreth ngjarjeve të tashme, të cilat gazetarët dhe redaktorët i gjykojnë të rëndësishme për lexuesit tanë.

★ Sigurimi i informacionit zyrtar nga burime të shumta informacioni për komunitetin.

★ Pasqyrimi i atij të cilën gazetarët dhe redaktorët e vlerësojnë informacion të rëndësishëm, të cilin lexuesit tanë duhet ta kenë.

Shënim për drejtuesin e seminarit

★ Pyetini pjesëmarrësit: "Cilët janë disa nga elementet e reja të cilat duhen përfshirë në përkufizimin e lajmit tani që po përcaktojmë rëndësinë e diversitetit dhe përfshirjes në pasqyrimet tona?"

Secili prej nesh e përkufizon lajmin duke u bazuar në përvojën vetjake. Një gazetar që rrit një fëmijë të paaftë fizikisht do t'i konsiderojë artikujt që lidhen me këtë temë si më të vlefshëm sesa dikush që nuk ka pasur rastin të ketë përvojë me një njeri me paaftësi fizike. Dikush që kujdeset për një të moshuar do t'i përcaktojë disa tema në lidhje me të moshuarit si informacion më të vlefshëm sesa dikush që nuk kujdeset për dikë më të moshuar.

Drejtuesi i seminarit pyet: Si ndikojnë përvojat tona personale në përkufizimin tonë për lajmin? Çfarë elementesh të reja mund t'i shtohen përkufizimit tonë për lajmin duke u nisur nga përvojat personale, etnia, mosha, raca, përkatësia fetare, dhe gjinia? Diskutimi mund të bëhet në një grup të madh ose grupi mund të ndahet në grupe më të vegjël. Secili grup duhet të caktojë dikë që të mbajë shënime dhe të raportojë për përgjigjet para gjithë grupit kur të mbarojë diskutimi.

Drejtuesi i seminarit duhet të pyesë: Çfarë mendon grupi për atë që u diskutua në familjet e tyre

mbrëmë; për çfarë folën duke pirë kafe ose duke ngrënë mëngjes apo drekë dje? Cilat ishin gjërat që lanë një përshtypje të fortë te ata ndërsa kryenin aktivitetet e tyre të zakonshme si anëtarë të komunitetit – dhe jo ndërsa zhvillonin detyrat e tyre si gazetar?

Nxitni argumentet, pyetjet, dhe thëniet që ngjallin diskutim. Drejtuesi duhet të fillojë t'i redaktojë dhe mprehë gojarisht thëniet, duke u nisur nga diskutimi. Thëniet e mëposhtme mund të përdoren për të tërhequr pjesëmarrësit në një diskutim që ka të bëjë me përkufizimin e lajmit në një shoqëri me diversitet, atëherë kur ky diversitet bëhet një element në mënyrën se si e përcojmë informacionin në komunitetet tona:

★ Jo thjesht pasqyrimi i njerëzve të cilët dalin në lajme zakonisht apo janë njerëzit më të famshëm të biznesit.

Një shembull i mundshëm për artikuj këtu mund të jenë njerëzit e bizneseve të vegjël, të cilët po ndihmojnë në punësimin e banorëve, po rrisin ekonominë, dhe po sjellin dicka të re në vendin e punës.

★ Dicka personale, në mënyrë që njerëzit të gjejnë veten te lajmi.

★ Një mënyrë për të kuptuar komunitetet tona, si dhe të drejtat, detyrimet, dhe mundësitë e anëtarëve të këtyre komuniteteve.

★ Lajmi është i rëndësishëm.

Shënim për drejtuesin e seminarit

Pyetini pjesëmarrësit për domethënien e thënies së fundit dhe se si përshtatet kjo me botëkuptimin e tyre për rolin e gazetarit në një botë, rajon, komb, apo komunitet ku ata punojnë, të cilat ndryshojnë dhe bëhen gjithnjë e më të larmishme?

Drejtuesi i seminarit duhet të pyesë: Drejtuesi i seminarit duhet t'i fusë pjesëmarrësit në një diskutim për rëndësinë e lajmit. I rëndësishëm për kë? A do të ndryshojë rëndësia nëse lexuesi është femër, femër mbi 65 vjeç, apo një femër me një prejard-

hje të caktuar etnike? Nxitni një diskutim të gjallë për sfidën dhe mundësinë e përcaktimit të rëndësisë ndërkohë që më shumë shtresa diversiteti i shtohen përkufizimit të lexuesit të cilit i drejtohet kjo rëndësi e lajmit.

Drejtuesi i seminarit duhet të jetë në gjendje të thotë pikat e mëposhtme për të përmbledhur diskutimin në lidhje me atë që përbën lajmin:

★ Përkufizimet e lajmit duhet të përfshijnë rëndësinë e lajmit për jetën e njerëzve.

★ Rëndësia e lajmit është e vështirë për t'u përcaktuar sepse ka shumë lloje njerëzish me kaq shumë përkufizime të rëndësisë së tyre në lidhje me konsumimin e informacionit të dhënë nga media.

Pyetje për t'iu drejtuar pjesëmarrësve: Është kërkimi për një lajm të rëndësishëm për masën më të gjerë të lexuesve më i përshtatshëm sesa përcaktimi i lajmit duke marrë për bazë udhëheqësit dhe ata që përfaqësojnë status quo-në? Cilat janë rreziqet për gazetën, gazetarin – nëse ka – atëherë kur përqendrohesh në rëndësinë e lajmit në vend që të ruash status quo-në apo rendin e vjetër në shpërndarjen e informacionit?

Pyetje për t'iu drejtuar pjesëmarrësve: Nëse fokusi është rëndësia e lajmit, si do e trajtojmë faktin që ajo cka është e rëndësishme për ty mund të mos jetë e rëndësishme për mua? Si mund t'i përftojme të dyja perspektivat në lidhje me rëndësinë e lajmit në artikujt apo kronikat tona?

Përkufizime të tjera të lajmit që duhen marrë parasysh:

★ Ato ngjarje – të mëdha e të vogla – të cilat na tregojnë se si jetojmë, ku jetojmë, shpjegojnë kohën ku jetojmë, dhe na ndihmojnë të vazhdojmë historinë tonë njerëzore me dije, tolerancë, dhe hetim të lirë.

★ Ai informacion i cilësuar si i rëndësishëm nga individ, grupi, apo komuniteti.

★ Gjatë përcaktimit se çfarë përbën lajm, po merr parasysh në procesin e gazetës paragjykimet individuale të gjithsecilit. Kur fillohet kjo rrugë, do të përfundoni me një qasje shumë më të fragmentuar për lajmin. Secili do të paraqesë axhendën dhe përkufizimin e vet për lajmin.

★ Një pamje shumë më e gjerë dhe përfshirëse e asaj që përbën lajm është ajo cka nevojitet.

Pyetje për pjesëmarrësit: Çfarë do të përcaktonit ju si një pamje më të gjerë dhe përfshirëse të asaj cka përbën lajm në punën tuaj si dhe në gazetën, radion dhe televizionin tuaj?

Udhëheqësi i seminarit duhet të nxisë përgjigje nga pjesëmarrësit për pyetjet e bëra.

★ Në mënyrë që diskutimi të rrjedhë dhe të shkojë përpara, bëni pyetjen: Po përse i përket efektit të stafeve të larmishme: mosha, gjinia, grupet etnike, përkatësitë fetare, orientimi seksual?

Meqë lajmi përcaktohet nga njerëzit që punojnë në gazeta, për rrjedhojë edhe lajmi do të jetë më i larmishëm nëse stafi i gazetës është i larmishëm.

★ Për çfarë flasin njerëzit?

Meqë lajmi mendohet se është ai për të cilin njerëzit flasin për momentin, atëherë duhet të jemi në gjendje të përkthejmë atë për të cilin flasin njerëzit për stafin që ndodhet në gazetë. Duhet të sjellim lajme nga fqinjët tanë, nga kafenetë, mensat, dhe të ndihmojmë të vendosim nëse ka çështje të tjera për të cilat flet publiku, të cilat mungojnë në faqet tona të lajmeve.

Përmbledhja e drejtuesit: Sic mund të shihet nga diskutimi për çështjen e asaj që përbën lajm, secili gazetar arrin në çështjen në fjalë nga një këndvështrim i ndryshëm. Secili pjesëmarrës dha një përkufizim të ndryshëm për atë cka përbën lajm dhe secili prej nesh iu përgjigj ndryshe çështjeve dhe pyetjeve që u ngritën gjatë ushtrimit. Gjithsecili nga ne duhet të marrë parasysh nëse përkufizimi ynë për lajmet përputhet me përkufizimin që kanë për lajmet gazetatat, radiot apo televizionet tona. Nëse ato ndryshojnë, çfarë bëjmë ne dita-ditës për ta zvogëluar këtë hendek? Kompromis? Si mund ta trajtojmë çështjen e diversitetit në mënyrë që të funksionojë për secilin nga artikujt me të cilët merremi? Si ta cojmë çështjen e përfshirjes dhe diversitetit përtej vetes tone si individë dhe të fillojmë të ndryshojmë kulturën e lajmit në organizatat tona? Po në komunitetet tona?

Moduli i Tretë:

Ç'ËSHTË DIVERSITETI DHE PSE KA RËNDËSI AI?

Qëllimi:

T përcaktojë mundësitë e gazetarisë, të cilat do të shpien në një pasqyrim më të larmishëm.

Parimi:

Megjithë ndryshimet tona – etnike, politike, moshe, gjinie, fetare, ose ekonomike – të gjithë jemi anëtarë të komuniteteve ku jetojmë dhe punojmë; të gjithë dëshirojmë të na konsiderojnë anëtarë të një komuniteti më të madh.

Pasqyrimi i diversitetit ka për qëllim t'u drejtohet fijeve të përbashkëta të jetës tonë. Në këtë mënyrë ai lind mirëkuptim, tolerancë, dhe një strukturë të shëndoshë komuniteti, me hapësirë për debat, mosmarrëveshje, madje dhe të mos biesh dakord, të gjitha këto me një ndjenjë të përhershme respekti për ndryshimet mes individëve, grupeve, dhe komuniteteve.

Nëse njerëzit nuk e shohin veten në media, në fund të fundit nuk do ta shohin veten kurrë si pjesë të komunitetit në të cilin jetojnë. Nëse gazetarët duan të pasqyrojnë tërë komunitetin, ata duhet të gjejnë mënyra për të garantuar që të gjithë anëtarët e komunitetit reflektohen në këtë pasqyrim.

Për shembull, historia e vonë tregon se raportimi i politikave qeveritare pa lënë hapësirë për dëgjimin e zërave të ndryshëm në lidhje me këto politika ka ushqyer racizmin, ndarjen në sekte, si dhe urrejtjen etnike në shumë kombe.

Drejtuesi pyet: Cilat janë çështjet kryesore të diversitetit të cilat besoni se nuk pasqyrohen nga mediat informative?

Drejtuesi i seminarit duhet t'i shkruajë të gjitha përgjigjet në një letër të madhe, të cilën mund ta shohin të gjithë pjesëmarrësit.

Shënim për drejtuesin:

Mund të pritet që përgjigjet të përfshijnë tema të tilla si historia e konflikteve etnike në një rajon; politikat për përpjekjet etnike ose ndryshimet

racore; politikat e mungesës së tolerancës etnike, racore, dhe fetare.

Drejtuesi i seminarit mund t'i kërkojë grupit të sjellë shembuj se si media ka ndihmuar në forcimin ose dobësimin e komuniteteve nëpërmjet pasqyrimin të tyre. Shembujt mund të jenë të një natyre lokale ose nga Ruanda, Lindja e Afërt, Kanadaja, Europa Perëndimore, etj. Përveç kësaj, drejtuesi i seminarit duhet të hetojë për gjëra specifike në lidhje me raportimin, të cilat cuan në fund të fundit në konflikt dhe luftë. Drejtuesi i seminarit gjithashtu duhet ta bëjë të qartë që lidhja historike me konfliktet është një sfond të cilit zor se mund t'i shpëtosh nëse burimi i vetëm i medias janë artikujt për konflikt, historinë e tij, politikat si të konfliktit ashtu edhe të përpjekjeve për ta zgjidhur atë.

Së pari, duhet të largohemi nga përplasjet dhe konfliktet dhe të hedhim një shikim në jetën e përditshme. Drejtuesi i seminarit duhet të rishikojë modulën e mëparshëm dhe t'u kujtojë pjesëmarrësve që një pasqyrim i fuqishëm i diversitetit fillon me pasqyrimin e jetës së përditshme. Po kërkojmë mënyra për të përfshirë të gjithë njerëzit, në një pasqyrim të rregullt dhe të përditshëm në mënyrën më të thjeshtë. Për shembull, nëse njerëzit fillojnë të lexojnë emra që janë të identifikueshëm nga grupet etnike jo të shumicës – emra femrash, emra të personave nga grupe të ndryshme racore ose fetare -ata do të fillojnë të ndihen pjesë e dialogut dhe debatit kombëtar.

Gazetarët duhet të zgjerojnë përdorimin e burimeve të informacionit nga grupe të ndryshme. Besueshmëria e mediave informative do të rritet ndërkohë që lexuesit dhe shikuesit pranojnë se ekziston një interes për të përfshirë pikëpamjet dhe përvojat e çdo segmenti të komunitetit.

Shumë gazeta dhe stacione radio dhe televizioni, qoftë në Europë, Afrikë, Azi, apo në Amerikë, janë konsideruar për dekada të tëra krye-

sisht si krahu i raportimit të asaj që qeveria ka vendosur dhe se si do të zbatohen këto vendime. Në modelin e gazetarisë përfshirëse dhe pasqyruese të diversitetit, thëniet e qeverisë kalojnë në plan të dytë në rrëfimin e historisë se si politikat dhe praktikat qeveritare ndikojnë në anëtarë të ndryshëm të komunitetit. Gazetari punon që të lejojë zëra nga komuniteti të rrëfejnë për veprimin apo mungesën e veprimit nga ana e qeverisë.

Atëherë kur këto zëra nga komuniteti bëhen të ditur, rritet aftësia jonë për të përfshirë më shumë njerëz në debat; mediat bëhen si forum për debatin, i cili me kalimin e kohës mund t'i lejojë shoqërisë të zgjidhë problemet e saj në interesin e të gjithë anëtarëve të saj.

Shënim për drejtuesin:

Duhet të jetë e qartë që të fillosh ndryshimin nuk do të thotë ta planifikosh atë. Gazetaria nuk është kryqëzatë. Mediat sigurojnë një hapësirë ku mund të dëgjohen zërat e ndryshëm.

Si fillim, drejtuesi i seminarit duhet t'u kërkojë pjesëmarrësve të sjellin një listë të temave që pasqyrojnë jetën e përditshme. Shembuj për të nxitur diskutimin: – Shëndetësia – Arsimi – Gjendja financiare personale – Fëmijët dhe zhvillimi i tyre – Feja ose besimi.

Drejtuesi i seminarit duhet të ketë shembuj artikujsh që merren me disa nga këto kategori dhe t'ua japë ato pjesëmarrësve. Duke përdorur këto artikuj si bazë për analizën, diskutoni se si artikujt mund të ishin zgjeruar për të përfshirë elemente të tjera të shoqërisë – moshën, grupin etnik, paaftësitë fizike, gjininë.

Shembull: Artikull mbi kujdesin shëndetësor gjatë shtatzanisë. A ka doktorë të cilët i përkasin minoriteteve ose grupeve etnike? A ka femra që janë si doktorë ashtu dhe pacientë? A ka çështje fetare të cilat duhen marrë parasysh gjatë diskutimit të kujdesit shëndetësor gjatë shtatzanisë? Kush mund të ishte përdorur për të krijuar një ndjenjë përfshirjeje në një artikull me këtë temë? Si mund t'i lokalizonit këto burime të larmishme informacioni?

Shënim për drejtuesin:

Filloni një diskutim me pjesëmarrësit rreth informacionit demografik që secili nga pjesëmarrësit dërgoi para fillimit të seminarit, ose informacionit demografik që keni hartuar dhe do të përdorni për të krijuar bazën për diskutimet tuaja rreth diversitetit brenda një komuniteti të vecantë.

Pyetje hipoteza që mund të merren parasysh për të filluar diskutimin:

Nëse 30% e popullsisë në komunitetin tuaj janë femra nga 25-40 vjeç, çfarë ndikimi mund të ketë ky fakt në mënyrën e pasqyrimit?

Disa përgjigje që ndihmojnë të ndizet diskutimi:

Këto janë femra të cilat janë në moshë për të pasur fëmijë. Ato janë të interesuara për çështje shëndeti dhe arsimimi, si dhe për informacion përsa i përket strategjive të rritjes së fëmijës. Ato janë të interesuara për politikat qeveritare në lidhje me shëndetësinë, arsimin, dhe mirëqenien, dhe dëshirojnë të dinë se si ndikojnë këto politika në jetën e tyre të përditshme.

Drejtuesi pyet: A ka ndonjë temë tjetër për të cilën ato mund të kenë interes? Kini parasysh që interesat e këtij segmenti të popullsisë do të ndryshojnë sapo të kalojnë mosha kur mund të kenë fëmijë. Cilat mund të jenë interesat e tyre kur të kalojë kjo moshë? Drejtuesi i seminarit duhet të sugjerojë që pjesëmarrësit të përdorin vetë jetën e tyre si njësi matëse për rregullimin e diskutimit sipas këtyre linjave.

A pasqyrohen këto tema në gazetën, radion apo televizionin tuaj?

Sa shpesh ndodh kjo, dhe si do e vlerësonit cilësinë e pasqyrimit? Cfarë do bënit për t'i shtuar më shumë përmbajtje raportimit të lajmit tuaj, në mënyrë që të plotësohen nevojat për informacion të këtij grupi të caktuar? Duke marrë parasysh nevojat për informacion të këtij grupi a po përconi informacion me interes edhe për burrat? Mos harroni që përcaktimi i zonave me interes për grupe të vecanta nuk do të thotë medoemos që të tjerat do të përjashtohen.

Shënim për drejtuesin:

Pyetini pjesëmarrësit në seminar për përshtypjen e tyre për thënien e fundit. Si është e mundur që pasqyrimi i një grupi të vecantë të jetë me përfitim edhe për të tjerë që nuk bëjnë pjesë në këtë grup? A ka ndonjë nga pjesëmarrësit ide ose koncepte për artikuj, të cilat do ta provonin thënien e mësipërme? Kërkojini pjesëmarrësve të sjellin shembuj konkretë për të ilustruar këtë koncept.

★ Nëse 20% e popullsisë në komunitetin tuaj është mbi 65 vjec: Cfarë ndikimi mund të ketë ky fakt në pasqyrim?

Disa pyetje që ndihmojnë të nxitet diskutimi:

Udhëtime dhe aktivitete argëtuese; gjendja financiare personale (të përballosh jetesën pasi dikush nuk punon më); plani për pension; shqetësime shëndetësore. Cfarë informacioni tjetër për këtë grup do të ishte i dobishëm në përpjekje për të sjellë një pasqyrim me interes për këtë grup njerëzish? A udhëtojnë ata? A është i përqendruar udhëtimi në zona të vecanta të vendit apo në vendet fqinje? A varen udhëtimet nga prejardhja etnike e njerëzve të kësaj kategorie? A varet nga gjendja ekonomike e njerëzve që hyjnë në këtë kategori?

Shënim për drejtuesin:

Ashtu si edhe më sipër, pyetini pjesëmarrësit në seminar për përshtypjen e tyre për thënien e fundit. Si është e mundur që pasqyrimi i një grupi të vecantë të jetë me përfitim edhe për të tjerë që nuk bëjnë pjesë në këtë grup? A mund të sjellin pjesëmarrësit ide ose koncepte për artikuj, të cilat do ta provonin thënien e mësipërme? Punoni me pjesëmarrësit në mënyrë që të sjellin shembuj konkretë për të ilustruar këtë koncept.

★ Nëse të dhënat demografike tregojnë se 30% e njerëzve në një zonë janë më pak se 25 vjec: Cfarë ndikimi mund të ketë kjo statistikë në pasqyrim?

Disa përgjigje që ndihmojnë të ndizet diskutimi:

Artet (sidomos muzika); gjendja financiare personale; shëndeti dhe mirëqenia. Cfarë informacionesh

të tjera për interesat e këtij grupi mund të jetë e nevojshme të caktohen në mënyrë që të vendosen nëse ka zona të pasqyrimin të një gazete për të cilat duhet të ndërgjegjësohemi, ose që duhen të kenë më shumë peshë? Sporti dhe aktivitetet argëtuese? Marrëdhëniet? A i pasqyron gazeta juaj këto tema?

Shënim për drejtuesin:

Shqyrtoni të njëjtat çështje si më sipër në lidhje me përfitimet e të gjitha grupeve kur rritet pasqyrimi i atyre që janë të dukshëm tani.

Drejtuesi duhet të përdorë shembuj nga shqyrtimi i gazetave dhe kronikave të sjella nga pjesëmarrësit që të zgjerojë fokusin e këtij moduli. Pyetjet mund të jenë shumë specifike në lidhje me çështje etnie, moshe, dhe gjinie në cdo vend apo rajon ku mund të zhvillohet seminari.

Ushtrim për seminar:

Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga katër veta. Secili pjesëmarrës merr gazetën ose kronikën radiofonike ose televizive dhe rishikon lajmet në mënyrë që të bëjë pyetje për përfaqësimin e elementeve përbërës kyc, duke u nisur nga informacioni demografik që kanë sjellë pjesëmarrësit. Ndërkohë që pjesëmarrësit i bëjnë pyetje njëri-tjetrit rreth diversitetit të audiencës së tyre dhe lajmeve që prodhojnë, krijohet një profil demografik jo formal në bazë të asaj që thuhet. Cdo pjesëmarrës duhet të mbajë shënime gjatë diskutimit për të raportuar pastaj para grupit.

Pjesëmarrësit kërkojnë:

★ Profil demografik në trajtë anekdote.

★ Cfarë informacioni *nuk* është i ditur, që do të ndihmonte të përcaktonte nëse gazeta po mbulon të gjitha segmentet e komunitetit.

Rezultatet e revistës së materialeve dhe të diskutimit të grupit të vogël paraqiten para gjithë seminarit. Duhet mbajtur shënime për fushat të cilat kanë nevojë për përmirësim në mënyrë që të rritet pasqyrimi i diversitetit për t'u diskutuar në një modul të mëvonshëm.

Moduli 4:

PIKA TË VEÇANTA PËR DISKUTIM RRETH GJUHËS

Qëllimi:

Zhvillimi i ndjenjës së përdorimit të gjuhës për të shmangur stereotipet me bazë racore dhe etnike.

Parimi:

Fjalët tona kanë forcën e nxitjes së komuniteteve tona për të lexuar gazetatat tona, për të dëgjuar dhe për të transmetimet tona, dhe për të na besuar. Po këto fjalë mund të nxisin këndvështrime negative të komunitetit rreth grupeve të ndryshme dhe të hedhin një dritë paragjykimi dhe anshmërie në raportimin dhe shkrimet e medias informative. Është e rëndësishme të kihet parasysh pse disa fjalë nuk funksionojnë fare.

Shënim për drejtuesin:

Drejtuesi i seminarit duhet të fillojë një diskutim duke përdorur shembuj nga artikujt e gazetës ose transmetimet në radio dhe televizion të sjella nga pjesëmarrësit. Në rastin e shembujve nga shtypi, fotokopjoni artikujt që do përdorni në mënyrë që cdo pjesëmarrës të lexojë dhe të ndjekë diskutimin. Kronikat e transmetuara duhet të shfaqen për gjithë grupin.

Shumica e mediave informative nuk nisen me qëllimin për të krijuar stereotipe apo përcarje. Megjithatë, gazetarët shpesh nuk arrijnë ta përdorin gjuhën me efikasitet në mënyrë që të shmangen stereotipet e grupeve dhe mungesa e tolerancës. Duke e marrë si të mirëqenë që media e sotme informative është e interesuar në shmangjen e dëmit të shkaktuar nga përdorimi i papërshtatshëm i gjuhës, rregulla kryesore për gazetarët është:

Ndiqni rregullat e saktësisimit gjatë shkrimit, në mënyrë që gjuha të përdoret në trajtën më të kulluar.

Fjalët që zgjedhim janë kritike në përpjekjen tonë për diversitet në përmbajtjen e medias.

Vështirësia e parë është të paraqesësh anëtarë nga grupe të ndryshme etnike dhe racore me drejtësi dhe saktësi duke i zgjedhur fjalët me kujdes, si dhe duke shmangur stereotipet dhe cliché-të që mund të shihen si ofendime.

Disa organizata lajmesh kanë krijuar komitete për të ndrequr “problemet” e keqpërdorimit dhe identifikimit të gabuar. Të tjerë i kanë kthyer çështjet gjuhësore në një pjesë përbërëse të zhvillimit të rregullave dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me stilin.

Megjithatë, shumica e gazetarëve rrallë kanë mundësi të ulen dhe të mendojnë se përse zgjedhin fjalët që përdorin. Presioni i kohës, kufizimet e hapësirës dhe në fund rrjedha e artikullit shpesh janë ato që vendosin për zgjedhjet që bëjmë. Rrallëherë ndodh që të kemi kohë për të diskutuar fjalën më të mirë për punën që kemi në dorë.

Tani që mediat informative e njohin dhe pranojnë sa i thellë është diversiteti në shoqëri, dhe ndërsa zbulojmë ndikimin që diversiteti ka ose duhet të ketë në punën tonë si gazetarë, jemi të detyruar t’u hedhim një shikim më të kujdesshëm fjalëve që përdorim.

Në fakt, arsyeja e vetme për të kontrolluar mënyrën se si i quajmë njerëzit dhe si i përshkruajmë vendet është përpjekja për të raportuar saktë rreth gjithë segmenteve të komuniteteve tona, dhe gjatë kohës që bëjmë këtë, të përdorim edhe fjalët e duhura për këtë punë. Kur e vërejmë me kujdes përdorimin dhe keqpërdorimin e gjuhës, nuk jemi nën varësinë e korrektesës politike. Ajo që po bëjmë është ndërtimi i punës duke përdorur të gjitha rregullat dhe burimet që kemi në dorë.

Përdorimi i Fjalorit

Hapi i parë në shqyrtimin e përdorimit dhe keqpërdorimit të fjalëve është i thjeshtë:

Përdorni fjalorin. Libri është një burim që

mund të duket herë pas here në punën tonë të përditshme ndërkohë që ndeshemi me mënyra për të paraqitur me saktësi dhe ndershmëri nuancat e komuniteteve tona.

Kohërat ndryshojnë. Kuptimet ndryshojnë. Fjalori mund të na i kujtojë këto fakte, mund të na kujtojë origjinën e fjalëve që përdorim, dhe të na ndihmojë të zgjedhim fjalët e përshtatshme për artikujt që shkruajmë.

Shembull:

Geto: Në vitet 1960, përkufizimet e fjalorit e cilësonin geton si një vend ku ligji e detyronte një grup njerëzish të jetonte në një zonë të kufizuar të qytetit, dhe në mënyrë të vecantë përmendte pogromët në Europë. Në kohët e sotme është shtuar një përkufizim i dytë. Ky përkufizim lejon që fjala të përdoret si një lagje ose sektor i qytetit në të cilin anëtarë të një grupi të pakicës jetojnë për shkak të presionit social, ekonomik, ose ligjor. Fakte kyce të përmendura në këtë përkufizim të dytë ndryshojnë përkufizimin e mëparshëm, i cili kërkonte që të ishte një veprim nga qeveria të krijojte një geto.

Cfarë duhet të dinë gazetarët dhe redaktorët para se të përdorin këtë fjalë?

- 1) vetëm një grup pakice jeton në zonën në fjalë, dhe
- 2) ata jetojnë atje për shkak të trysnisë sociale, ekonomike, apo ligjore.

Shënim për drejtuesin:

I kërkoni pjesëmarrësve të sjellin fjalë për të cilat mund të diskutohet në gjuhën e tyre. Drejtuesi i seminarit duhet të ketë gati disa fjalë për të cilat mund të diskutohet. Aty ku shihet e nevojshme, pjesëmarrësit të përdorin fjalorin për të saktësuar kuptimin e fjalëve që diskutojnë. Ndonjëherë, ky ushtrim mund të nxjerrë në pah shumë aspekte të ndryshme. Në ato raste kur fjalët e njohura nuk janë të sakta, dhe zbuloni se fjalët po keqpërdoren, pyetini pjesëmarrësit se çfarë efekti mendojnë ata se do ketë ose ka pasur ky përdorim i gabuar? Kush ndikohet më shumë nga ky përdorim i gabuar?

Me të vërtetë që ka vende në qytete të ndryshme të botës të cilat mund të quhen geto,

por gazetarët duhet të jenë shumë të kujdesshëm që të gjitha faktet e nevojshme për të përmbushur përkufizimin ekzistojnë. Përsëri, fjala nuk mund të përdoret si frazë për të tërhequr vëmendjen për zona të qytetit që duket se nuk plotësojnë standardin e shtëpive të klasës së mesme. Për më tepër, në shumicën e rasteve, gazetarët duhet të përdorin mundësinë që kanë dhe të jenë specifike e të përmendin zonën ose lagjen ku ndodhin ngjarjet.

Mësojini lexuesit dhe burimet e informacionit

Sa gazetarë kanë shkruar artikuj për qytetarët e moshuar duke i quajtur ata “të vjetër,” ndërkohë që nuk kishin pyetur për moshën e njerëzve të intervistuar?

Po për një shkrim në një agjenci, që e quajti një burrë “sakat” pa e përshkruar gjendjen e tij specifike? Edhe njëherë, kontrolloni kuptimin në fjalor. Përkufizimi është shumë i vecantë dhe përdoret vetëm për një përqindje të ulët njerëzish të cilët janë konsideruar të paafte fizikisht.

Dallime pa ndryshime? Jo, këto janë dallime të cilat i ndajnë gazetarët nga njerëzit të cilëve u shërbejmë. Këto janë dallimet që vazhdojnë të polarizojnë shoqërinë tonë.

Ndërsa drejtohem në shekullin e 21-të na mbetet një përgjegjësi e madhe për të garantuar që polarizimi nuk do të vazhdojë dhe do të shtohet thjesht sepse ishim shumë të zënë, përtacë, apo moskockëçarës për të kontrolluar disa fjalë në fjalor.

Disa këshilla të tjera:

★ Bëni kujdes kur përdorni mbiemra dhe ndajfolje. Këto fjalë janë përshkruese dhe mund të nxisin stereotipet. Gazetarët janë raportues dhe jo përshkrues. Ne iu sjellim lexuesve, dëgjuesve dhe shikuesve fakte në mënyrë që ata të arrijnë në përfundimet e veta rreth përshkruesve të përshtatshëm për përdorim në një situatë të caktuar. Funkzioni ynë nuk është t’i themi komunitetit atë që duhet të besojnë. Funkzioni ynë është t’i sigurojmë komunitetit faktet e paanshëm, të cilat i lejojnë cdo anëtar të komunitetit të marrin vendime se si do e jetojnë jetën e tyre dhe se si do i përjetojnë përfitimet dhe detyrimet e anëtarësisë në komunitet.

★ Tregohuni vigilentë dhe shmangni termat e ngarkuar ose frazat që krijojnë një ndjesi të mungesës së përkatësisë për ata që janë pjestarë të grupit që preket më shumë.

A e përshkruajmë një burim informacioni si një njeri zeshkan, brun duke u përpjekur të krijojmë një atmosferë dhe nuk arrijmë të kuptojmë që toni që krijojmë ka një natyrë prej stereotipi? Duhet të mendojmë për lexuesin, dëgjuesin, dhe shikuesin normal sa herë që zgjedhim një fjalë dhe frazë që zgjedhim. A po e komunikojmë atë që kishim ndërmend? A po përforcojmë stereotipe të grupeve të vecanta pa e pasur qëllim ose pa e vënë re fare?

Fjalët tona kanë pushtetin të nxisin pjesëtarë të komuniteteve tona – një e nga një – të lexojnë gazetat tona, të dëgjojnë dhe të shohin transmetimet tona, dhe të besojnë informacionin që përcojmë cdo ditë. Kur përdorim fraza të ngarkuara, cliché, dhe zhargon, rrezikojmë të humbim cdo besim që është ndërtuar mes komunitetit dhe medias.

Fjalët që përzgjedhim mund të përjetësojnë perceptimet e komunitetit që mediat janë ende të paragjykuara kundrejt disa segmenteve të shoqërisë, ashtu si ishin gazetat, radiot, dhe televizionet e brezave të mëparshëm, ose të regjimeve politike të mëparshme. Fjalët tona kur lexohen ose dëgohen krijojnë përsëri përvojën e kohëve të vjetra – kohë kur dinamikat sociale, politike, ekonomike dhe ligjore krijojnë hapësirë për urrejtje, frikë, përçarje, dhe konflikt. Me cdo rindërtim ne kthehemi përsëri mbrapsht në kontekstin historik në vend që të lejojmë komunitetet tona të ecin përpara dhe të bëhen shoqëri që vlerësojnë lirinë e shprehjes dhe mendimet e ndryshme, ku bazohet një media demokratike.

Përkufizoni se çfarë është një stereotip. Kërkojini pjesëmarrësve të diskutojnë stereotipet që ekzistojnë rreth grupit etnik, racor ose fetar me të cilin identifikohen ata. Kërkoni nga pjesëmarrësit të komunikojnë se si ndihen ata kur shohin një stereotip që ka të bëjë me grupin e tyre racor ose etnik në një artikull gazete ose lajm të transmetuar në radio ose televizion.

Shënim për drejtuesin:

Përdorini artikujt nga gazetatat të sjella nga pjesëmarrësit e seminarit për të diskutuar përdorimin e gjuhës në kërkim të diversitetit. Si mund të ishte ndryshuar gjuha në këto artikuj për të shmangur ose eliminuar stereotipet?

Duhet sqaruar pikat e mëposhtme:

★ Shmangni fjalë ose fraza që nuk paraqesin një pamje të plotë.

Shembull: Në një komb ku liria fetare po rivedoset, një përshkrim i organizatave të pakicës fetare si Dëshmitarët e Jehovait, Baptistët dhe Protestantët si sekte fetare është e pasaktë dhe gjithashtu përcon një imazh të turbullt për komunitetin në lidhje me dinamikën mes “organizatave kryesore,” si për shembull organizatat katolike, myslimane, dhe ortodokse.

Shënim për drejtuesin:

Në këtë pikë drejtuesi i seminarit duhet të kërkojë që dikush nga grupi të lexojë përkufizimin e fjalës “sekt,” dhe duhet të pasojë një diskutim për të sqaruar se pse kjo fjalë mund të ketë një efekt negativ për ata anëtarë të grupeve fetare të cilët u futën në këtë kategori.

★ Shmangni përshkrime të njerëzve që kanë tendencën të provojnë ose të hedhin poshtë një stereotip.

★ Përdorni fjalë që përshkruajnë me saktësi të moshuarit, pa treguar mëshirë dhe pa i fyer.

★ Shmangni përdorimin e fjalëve stereotipe për të moshuarit. Shembuj: i pafuqishëm, i rrënuar, sakat.

★ Shmangni përshkrimet e femrave duke u nisur nga bashkëshortët e tyre. Femrat në artikujt tanë duhet të kenë identitetin e tyre. Mos i identifikoni ato si bashkëshortet e burrave, por lejojini që të kenë identitetin e tyre.

★ Shmangni pasaktësitë gjeografike ose historike të gjuhës.

★ Përdorni detajet dhe shmangni etiketimet. Shembull: Në një artikull mbi një krim, i dyshuari përshkruhet si një mashkull me lëkurë të errët midis 20 dhe 30 vjec. Këmbëngulni për më shumë detaje nga policia. Cfarë kishte veshur; ku u pa që po ia mbathte; si i kishte flokët?

Autoritetet do të japin detaje vetëm atëherë kur gazetarët të bëjnë pyetje. Dhe pyetjet tona speci-

fike ndihmojnë që t'i përcojnë komunitetit një përshkrim të mjaftueshëm të një të dyshuari në vend që të japin një përshkrim të përgjithshëm, i cili mund të përshkruajë 50 përqind të një popullsie apo një grupi etnik ose racor. Po sikur të mos ketë detaje? Merrni parasysh nëse përshkrimi shërben për ndonjë qëllim tjetër përveçse të ndihmojë autoritetet të kapin një kriminel.

Moduli i Pestë: PYETJE RRETH ETNISË

Pyetjet dhe përgjigjet e mëposhtme janë paraqitur për t'u përdorur në diskutimet me grupin. Përqendrojeni diskutimin rreth shembujve të vecantë nga përvojat e pjesëmarrësve. Përgjigjet e dhëna më poshtë duhen konsideruar si një fillim dhe jo si fundi i diskutimit. Lërnini pjesëmarrësve kohën e mjaftueshme për të debatuar nëse identifikimi etnik apo racor ishte i përshtatshëm në artikujt ose kronikat që sollët si shembull. Pjesëmarrësit do të ngrenë çështje në të cilat drejtuesi duhet të jetë i përgatitur që t'i shqyrtojë plotësisht, t'i vërë në pikëpyetje, ose t'i zhvillojë në mënyrë që të ndihmojë të gjithë grupin të zhvillojë një diskutim me vlerë. Në fund të diskutimit drejtuesi i seminarit duhet të bëjë përsëri përmbledhjen e përfundimeve të grupit.

Shënimet nga këto seksione duhen ruajtur në mënyrë që të zgjerohen më shumë pyetjet dhe përgjigjet në çështjen e etnisë dhe raportimit në rajon.

Shënim për drejtuesin:

Artikujt mbi krimet shpesh janë më të mirat për t'u përdorur si bazë diskutimi rreth etnisë dhe raportimit të saj. Këto mund të jenë shembujt më të volitshëm për t'u gjetur në gazetatat e pjesëmarrësve.

Pyetje: Në cilat raste janë raca ose etnia domethënëse?

Përgjigje: Në përgjithësi, raca ose etnia nuk janë të rëndësishme në një artikull, me përjashtim të rasteve kur etnia është faktor që është në qendër të artikullit. Në artikujt që kanë të bëjnë me politikën, veprimtari apo situata sociale, etnia nuk është domethënëse në mënyrë automatike. Gazetarët duhet të bëjnë kujdes që lexuesi të mos ndikohet nga zgjedhja e fjalëve dhe të kujtojë se ka etnia është një nga çështjet e artikullit.

Shembull: Në qytete të mëdhenj një grup etnik mund të ketë në pronësi shumë lloje të ndryshme dyqanesh të vegjël ose punishte biznesi. Këto dyqane shpesh janë në shënjestër të vandalizmit dhe urrejtjes nga ana e grupeve të tjera. Edhe kështu, gjatë raportimit të një vandalizmi të caktuar, gazetari nuk duhet të mendojë që motivimi është i një natyre etnike. Në shikim të parë, etnia mund të jetë një element kyc. Megjithatë, një vështrim më i kujdesshëm dhe burime të mira informacioni në zonën përreth mund të zbulojë shkaqe të tjera për dhunën, përfshirë këtu edhe marrëdhëniet personale midis njerëzve që banojnë në një lagje të caktuar. Në këto rrethana, etnia është një faktor i parëndësishëm dhe mënyra e raportimit nuk duhet ta orientojë lexuesin të besojë që anëtarë të një grupi tjetër kanë dalë për të shkatërruar ose lënduar anëtarët e një grupi tjetër.

Shënim për drejtuesin:

Kërkojini grupit të diskutojë nëse mund të përcaktojnë në ka ndonjë racë që është kryesore këtu apo është rasti klasik i atyre që kanë kundërt atyre që s'kanë? Apo është thjesht një element kriminel i cili është cmendur? Si mund ta pasqyrojë artikulli ose kronika me saktësi situatën? Pyetni nëse ky person do identifikohet me anë të etnisë nëse ai ose ajo do të bënte pjesë në grupin e shumicës? Nëse përgjigja është jo duhet konsideruar seriozisht nëse etnia është domethënëse për artikullin ose kronikën.

Drejtuesi i seminarit duhet të gjejë shembuj të identifikimit të personave me anë të grupit të tyre etnik, të cilat dalin në përfundimin që artikulli ose kronika është rreth një situatë me natyrë etnike pse racore.

Pyetje: Cili vendos nëse ekziston një këndvështrim i natyrës racore ose etnike?

Përgjigje: Gazetarët nuk duhet të marrin përsipër barrën e vendimit nëse një incident ka ngjyra etnike ose racore. Faktet e artikullit duhet të flasin vetë. Shpesh një burim qeveritar do t'i thotë gazetarit që raca ose etnia janë elemente të një artikulli ose kronike. Deklaratat zyrtare mund të testohen duke biseduar me përfaqësues nga komunitetet e përfshira. Zhvilloni burime informacioni në varësi të linjave racore ose etnike dhe të paktën do të ketë gjithnjë pikëpamje të shumëfishta rreth kësaj çështjeje në artikullin ose kronikën tuaj nëse zyrtarët pretendojnë që një incident ose një problem ka një këndvështrim racor ose etnik. Vëri në provë të njëjtët zyrtarë me pyetje që hetojnë "përse?" kanë vendosur që është një çështje etnike në lojë.

Shembull: Policia e etiketon luftën midis bandave si përpjekje etnike. Atëherë kur gazetarja pyet pse, zbulon që policia ka arritur në përfundimin se përplasjet janë etnike meqë një bandë është nga një grup etnik dhe një bandë tjetër është nga një grup tjetër etnik. Por në fakt, përplasje mund të ketë filluar si një luftë për territor për tregti të paligjshme dhe me fitim droge në rrugët e qytetit tuaj. Lufta kishte të bënte me territorin që ka lidhje me ekonominë dhe jo me përplasjen etnike. A mund të ketë një element etnik në gjithë këtë histori? Ka mundësi. Megjithatë, nuk është patjetër arsyeja më e rëndësishme për konfliktin dhe si rrjedhim matura duhet përdorur në përcaktimin se çfarë rëndësie duhet t'i vërë gazetari çështjeve etnike në këtë artikull.

Pyetje: Si duhen quajtur njerëzit?

Përgjigje: Një mënyrë për të trajtuar këtë çështje është të pyesni burimin e informacionit – personi të cilin po citoni ose po i referoheni – si dëshiron ai ose ajo të përshkruhet dhe kjo mund të arrihet thjesht duke pyetur. Megjithatë, është rregull

i përgjithshëm që vetëm atëherë kur etnia e një burimi informacioni është e rëndësishme për temën e artikullit ose kronikës, duhet përmendur.

Mos harroni, një pamje flet më shumë se një mijë fjalë. Shpesh identiteti i burimeve të informacionit mund të komunikohet me efikasitet nëpërmjet përdorimit të pamjeve në gazeta dhe televizion. Ku të jetë e mundur, pse të mos e tregoni burimin tuaj të informacionit si personi i vërtetë që është në vend që ta karakterizoni në mënyrë të tërthortë?

Shënim për udhëheqësin:

Përshkrimet e burimit të informacionit duhet të jenë sa më specifike që të jetë e mundur. Thjesht duke thënë që dikush është nga Azia nuk përbën ndonjë informacion domethënës rreth personit atëherë kur identiteti racor është vendosur që është i rëndësishëm. Jini specifik. Përgjithësimet nxisin krijimin e stereotipeve. Gazetaria cilësore është specifike në çdo gjë – përfshirë këtu edhe etnicitetin. Nga cili vend në Azi është ky njeri?

Pyetje: Po emigrantët?

Përgjigje: Përdoret i njëjti rregull. Shmangni futjen e të gjithë emigrantëve në klasa. Për shembull: Afrikanë, Aziatikë. Lexuesi ose shikuesi merr më shumë informacion nëse sillni detaje më specifike rreth origjinës së një personi. Një person nga Amerika mund ta ketë prejardhjen nga Kanadaja, Shtetet e Bashkuara ose Amerika Latine. Lexuesi nuk mëson ndonjë gjë kur themi se njeriu në artikull ose kronikë është nga Azia; për artikullin ose kronikën është më i rëndësishëm vendi i prejardhjes së këtij njeriu. Thuajini lexuesit kombin, shtetin ose qytetin atëherë kur ky ka rëndësi. Afrika është një kontinent i madh. Tregojini lexuesit nga cili komb vjen ky person. Rregulla kritike: Përcillini lexuesit ose shikuesit informacion specifik.

Moduli i Gjashtë:

ZHVILLIMI I BURIMEVE TË INFORMACIONIT

Qëllimi:

Të ndihmoni pjesëmarrësit në zhvillimin e burimeve të reja të informacionit

Parimi:

Diversiteti i burimeve të informacionit në artikuj ose kronika nga vetë natyra e tij do të krijojë një raportim lajmesh më të larmishëm.

Ndryshimi i mënyrës se si gjejmë dhe përdorim burimet e informacionit në raportimin e lajmeve është një detyrë që kërkon veprime shumë të ndërgjegjshme nga ana e gazetarit. Cdo gazetar që është i interesuar të ketë më shumë zëra të pranishëm në artikujt e tij ose të saj duhet të fillojë të gjejë burimet përkatëse për secilin kontakt që krijohet brenda komunitetit. Takimet rastësore me njerëzit mund të kthehen në mundësi për të takuar një doktor ose jurist, të cilët mund të jenë në gjendje të sjellin një perspektivë tjetër në një artikull ose kronikë që mund të duket si pjesë e rutinës. Takimet rastësore mund të jenë edhe një mundësi për t'i shtuar emrat dhe numrat e akademikëve të respektuar, dhe këta mund të jenë nga grupe të ndryshme etnike. Cdo kontakt me një person interesant kthehet në një mundësi për të zgjeruar listën e burimeve të informacionit që keni përveç burimeve qeveritare, të cilët kanë qenë faktorja e gazetarëve të lajmeve për dekada të tëra. Gazetarët më të mirë janë ata që kanë rrjetin më të larmishëm të burimeve të informacionit.

Shënim për drejtuesin:

Zgjidhni katër artikuj ose kronika nga shembujt e pjesëmarrësve, ose nga c'keni lexuar ose parë vetë dhe që mund të përdoret për të zgjeruar bazën e burimeve për lajme. Kërkoni që pjesëmarrësit të lexojnë cdo artikull dhe ndahuni në grupe të vegjël. Kërkoni pjesëmarrësve t'u vënë notë artikujve në lidhje me larminë e burimeve ose të zërave. A janë cituar vetëm burrat? A janë cituar vetëm anë-

tarë të qeverisë? A janë cituar vetëm njerëz nga shumica, megjithëse mund të ekzistojnë këndvështrime të tjera të çështjes nga grupe të tjerë racorë apo etnikë?

Për të reflektuar:

★ Kini kujdes nga artikujt e njëanshëm që mund të shfaqen.

Problemet e pakicës nuk kërkojnë komente nga shumica; ceshtjet e hebreyve nuk kanë nevojë për koment nga anti-Semitët. As problemet e gayve dhe lezbikeve nuk kërkojnë ndonjë koment nga elementë homofobikë. "Balancimi" mekanik i burimeve të informacionit mund të hapë rrugë për raportim të njëanshëm duke rritur mundësinë për të përdorur stereotipe, klishe, dhe zëra me paragjykime.

★ Bëni kujdes gjatë përshkrimit të mënyrës së jetës midis të rriturve.

Në shumë vende nuk ka shumë rëndësi nëse një burrë e një grua nuk kanë certifikatë martesë ose që dy burra apo dy gra janë çift dhe jetojnë bashkë. Nëse ky fakt duhet përmendur, mos bëni moral, dhe gjithashtu mos përdorni etiketa të këndshme ose dinake. Shumë gazetarë përdorin "partner" ose "shok i ngushtë" për të përshkruar këto marrëdhënie të gjata ose mënyrën e jetesës. Kryesorja: mos e merrni si të mirëqenë; pyetni personazhin e artikullit si duhet karakterizuar kjo marrëdhënie.

Shënim për drejtuesin:

Shihini artikujt dhe një herë. Kërkoni cdo pjesëmarrësi të bëjë një listë të kategorive të tjerë të njerëzve të cilët mund të kontaktohen dhe të thellojnë perspektivën e artikullit. Bëni të njëjtin ushtrim me tre artikujt që mbeten. Kërkoni që pjesëmarrësit të diskutojnë si do i identifikonin burimet e informacionit për të zgjeruar këndvështrimin në këto artikuj.

Moduli i Shtatë: PAMJET

Një nga momentet e para kur ku gazetarët mund t'u krijojnë një mundësi për pjestarët e të gjithë grupeve racore, etnike ose fetare të identifikohen me përmbytjen e gazetës, revistës, ose kronikave televizive, është të përdorimi i pamjeve. Shënim për drejtuesin: Pyetini pjesëmarrësit e seminarit çfarë lloj pamjesh të pakicave – nëse ka – gjenden në gazeta apo në kronika lajmesh televizive. A ka përfaqësues të pakicave që shërbejnë si folës apo si gazetarë në terren? A dalin në artikuj femra që mund të ndihmojnë në paraqitjen e ngjarjes, apo është fotografia në lajme e mbizotëruar nga meshkujt? Drejtuesi i seminarit duhet të nxjerrë shembuj nga gazetatat dhe kronikat televizive të sjella nga pjesëmarrësit ose shembuj që ai i ka gjetur vetë dhe mendon se do të ishin të shkëlqyera për të ilustruar mungesën e diversitetit në pamjet që shfaqim.

★ Ndërkohë që i tregoni shembujt grupit, kërkojini atyre që të vrasin mendjen për mënyra të tjera se si mund të ishin ilustruar artikujt, duke pasur në mendje diversitetin, në vend që të përdoret vetëm i njëjti burim qeveritar, mashkull, dhe të paraqitet fotoja e tij ose pamja në video.

★ Kërkoni nga pjesëmarrësit që t'i kushtojnë vëmendje punës artistike që shoqëron artikujt mbi krimin. Këto lloj ngjarjesh zakonisht përmbajnë më shumë grafikë. Gjithashtu, gjeni dhe pamje video ose fotografi të ngrira xhirimesh nga zona lufte ose zona trazirash civile. A sjellin këto fotografi apo pamje të xhiruara një këndvështrim të njëanshëm të trazirave ose të luftimeve? Përsa u përket xhirimeve, a përdoren ato që të përcojnë një pikëpamje të caktuar? A është ky ose a duhet të jetë ky qëllimi i gazetarit? Si mund të shmangët paraqitja e një pikëpamje në artikuj që kanë një kontekst të fuqishëm politik ose historik, i cili

gjithmonë ka përjashtuar të gjitha këndvështrimet përveç atij të qeverisë?

Pamjet – si ato në fotografi dhe ato në video – duhet të pasqyrojnë lajmin. Por nuk ekzistojnë rregulla për përfshirjen e pamjeve që pasqyrojnë lajmin. Me përjashtim të ngjarjeve që përbëjnë lajmin e ditës, dhe lajmeve që raportohen nga vendndodhja, shpesh ekzistojnë zgjedhje të tjera.

Shënim për drejtuesin:

Shikoni gazetatat dhe videot e sjella nga pjesëmarrësit dhe kaloni pamjet që keni në dispozicion. Diskutoni nëse kishte mundësi të tjera për të dhënë një pamje më të larmishme të ngjarjes nga ajo që u përdor nga gazeta apo stacioni televiziv në fjalë? Diskutoni kronikat që janë zgjedhur nga videot e sjella nga pjesëmarrësit. A mund të ketë pasur mundësi të tjera për të ilustruar historinë, të cilat do të kishin siguruar një pamje më të larmishme të ngjarjeve?

Kur ka një ngjarje të rëndësishme, fotografët mund të kërkojnë të kapin larminë e turmave në vend që të fokusojnë objektivin në ata që përfaqëson njëtrajtshmërinë e shumicës.

Shembull: Në një artikull të fundit për zgjedhjet, fotografi fotografoi një qendër votimi me një grua që monitoronte kutitë e votimit dhe me një tjetër që votonte. Fotografi e dinte që kjo skenë nuk do të ishte dokumentuar në të kaluarën në një shoqëri të mbizotëruar nga meshkujt. Pamja e marrë nga fotografi sinjalizon një ditë të re. Fotografi mund të kishte vajtur në një qendër tjetër votimi ose mund të kishte kapur një fotografi të ngjashme me meshkuj dhe të ishte larguar. Në këtë rast ai fiksoi ndryshimin, dhe lexuesit dhe shikuesit do të preken në një farë mënyre nga ndryshimi që përfaqësohet në këtë pamje. Me vetëdije apo pa vetëdije, lesuesi ose shikuesi do të

fillojë të ndjejë një ndryshim në komunitet përsa i përket rolit të femrës në këtë komunitet.

Shënim për drejtuesin:

Edhe një herë, kërkoni shembuj të pamjeve të cilat sjellin një ndjesi të një ndryshimi jo fort të dukshëm brenda komunitetit. A ka ndonjë të tillë në materialet e gazetave apo transmetimeve të sjella para seminarit? A ka ndonjë pamje për të cilën pjesëmarrësit në seminar menduan se mund të ishte kapur bashkë me të tjerat për të krijuar më tepër larmi, pa ndryshuar lajmin?

Një nga qëllimet në shqyrtimin e pamjeve për diversitet është të bëhet e mundur që disa nga lexuesit dhe shikuesit tanë të thonë: “Faleminderit që më krijoni mundësinë të shoh veten time në gazetën apo transmetimet tuaja televizive. Faleminderit që më lejuat të bëhesha pjesë e këtij komuniteti, sepse ju, mediat informative, përcaktoni komunitetin tonë nëpërmjet lajmeve që raportoni dita-ditës.”

Shënim për drejtuesin:

Në këtë pikë, drejtuesi i seminarit duhet të theksojë se pamjet e përdorura janë një çështje zgjedhesh nga personat brenda mediave informative, të cilët marrin vendimet për atë se çfarë pamjesh duhen shtypur apo përgatitur për transmetim.

Si duhet ndryshuar procesi i vendim-marrjes nëse qëllimi është të ketë një rritje në imazhet e larmishme në gazetë ose në kronika lajmesh televizive? Kthehuni përsëri dhe shihni disa nga xhirimet dhe fotografitë e gazetave të para më përpara në këtë modul. Ku janë zgjedhjet e tjera që mund të ishin bërë? Kur do të ishte bërë kjo zgjedhje, dhe kush i bën zgjedhjet? Drejtuesi duhet ta fusë grupin në një diskutim rreth një skene në kronikë dhe marrjes së vendimeve në pikën kur fotografi ose gazetari planifikon punën artistike ose kur kameramani planifikon xhirimet.

Larmia në punën artistike e përdorur nga mediat informative përfshin gjithashtu edhe marrjen e vendimit atëherë kur vendoset të përdoret një pamje në vend të një tjetre për një artikull ose kronikë. Cdo person që ka përgjegjësi të gjeje dhe

përzgjedhë artin duhet të fillojë të pyesë se cila është mënyra më e mirë për të ilustruar këtë artikull në një kohë që tërheq sa më shumë lexues që të jetë e mundur.

Shënim për drejtuesin:

Përzgjidhni dy ose tre artikuj pa fotografi nga gazeta lokale ose kombëtare, të cilat do bëhen subjekt i sugjerimeve për punën artistike që mund të kishte ilustruar më mirë artikullin duke pasur parasysh parimet e diversitetit. Shënoni sugjerimet për cdo artikull në një tabak të madh letre, që ta shohin të gjithë pjesëmarrësit. Kur të ketë përfunduar procesi, sugjeroni që pjesëmarrësit të përdorin të njëjtin proces për artikuj ose kronika në të cilat mbajnë përgjegjësi për punën artistike. Si do ta integronte secili prej pjesëmarrësve një proces të tillë si pjesë të organizatës së tij të lajmeve?

Komenti editorial: Karikaturat

Karikaturat editoriale përbëjnë një problem të vecantë. Karikaturat editoriale kanë për qëllim të jenë fyese dhe ndonjëherë të paraqesin ekstremet e pikëpamjeve politike ose të mosmarrëveshjeve sociale. Këto karikatura shpesh përdorin shumë stereotipe të grupeve të pakicës.

Por karikaturat editoriale, megjithëse në një kategori tjetër, nuk mbeten jashtë vlerësimit, sidomos kur karikaturat kanë prirjen të përjetësojnë stereotipe që përcajnë komunitetin ose forcojnë urrejtjen dhe mosbesimin. Zgjidhja në këtë rast është debati dhe vigjilenca e vazhdueshme e gazetarëve dhe organizatave të lajmeve.

Gjeni shembuj të karikaturave editoriale dhe bëni kopje për të gjithë pjesëmarrësit. Pyetini nëse këto karikatura përmbajnë ndonjë element fyese për pjesëmarrësit; ose për dikë nga një grup tjetër racor, etnik, ose fetar? Pyetja e fundit: A besojnë pjesëmarrësit se fyerja – qoftë edhe në formë të fshehur – ishte një “cmim që ia vlej të paguaje” për mesazhin që përconte karikatura? Përdoreni reagimin e pjesëmarrësve si njësi matëse për të përcaktuar nëse komentet editoriale në formë kartonash është aq fyese sa të përbëjë një kërcënim për ndonjë pjesë të popullsisë.

Shënim për drejtuesin:

Filloni një diskutim në lidhje me dallimin midis një karikature editoriale dhe fotografie që shoqëron një artikull në shtyp, ose pamje që shoqëron një kronikë lajmi televiziv. Cilat janë standartet e ndryshme që përdoren për të dyja? A e kupton publiku dallimin? Cila do të ishte pikë-pamja e pjesëmarrësve mbi atë se çfarë duhej bërë nëse një karikaturë fyese do të dilte në shtyp? Po sikur të gjithë ta dinin që ishte fyes dhe të mos kishte ankesa? Fakti që nuk pati ankesa, a do të përbënte një sinjal për një problem që ekziston midis komunitetit dhe medias, një problem për të cilin media duhet të punojë që ta zgjidhë?

Plani individual i veprimit

Plani Individual i Veprimit është zgjidhja për të ndihmuar gazetarët që të marrin me vete në punët e tyre atë për të cilën kanë diskutuar, kanë analizuar, dhe kanë mësuar gjatë këtij programi. Është një mjet për të nxitur pjesëmarrësit që të angazhohen në mënyrë aktive për të ndryshuar atë që bëjnë çdo ditë si profesionistë. Për më tepër, meqë gazetarët nuk mund të angazhohen thjesht me veprime individuale, por edhe në punën me kolegët e tyre, me organizatat e lajmeve, si dhe shoqatat dhe bashkimet profesionale, Plani Individual i Veprimit (PIV) mund të jetë edhe një mekanizëm për të shtrirë ndikimin edhe në individë dhe institucione të tjera.

Drejtuesi i seminarit duhet ta përshtasë formularin e PIV që është shtypur më poshtë, duke shtuar ose zëvendësuar pyetjet që janë këtu, dhe ta shpërndajë PIV-në në fillim të workshop-it ose seminarit, në mënyrë që çdo pjesëmarrës ta ketë parasysh këtë rezultat gjatë gjithë seminarit. PIV duhet të diskutohet nga grupi para se të plotësohet në mënyrë individuale, dhe drejtuesi duhet të nxisë çdo pjesëmarrës të jetë sa më specifik që të jetë e mundur në lidhje me qëllimet që po i vë vetes, mjetet që duhen përdorur, dhe afatet që duhen respektuar. Sugjerohet që një periudhë kohore prej gjashtë muajsh duhet përdorur për PIV, por kjo është në varësi të drejtuesit dhe të grupit, të cilët duhet të korrigjojnë formën e PIV derisa të gjithë pjesëmarrësit e grupit të jenë dako-

rd me zotimet që kërkohen nga ata. Pasi formularët e PIV janë plotësuar në seksionin e fundit, drejtuesi duhet të sugjerojë që secili pjesëmarrës ta diskutojë Planin e vet të Aksionit para gjithë grupit.

Drejtuesi duhet të mbajë shënime për secilin, në mënyrë që të ndihmojë në diskutimin që do të pasojë. Në skenarin ideal, do të kishte një vazhdim nga drejtuesi në afatin e caktuar për PIV. Meqë angazhimi në një gazetari që është e ndjeshme kundrejt problemeve të diversitetit shpesh është e vështirë si nga ana personale, ashtu edhe nga ajo institucionale, ky përcaktim kohor i vazhdimit të projektit krijon mundësi për të rishikuar diskutimet origjinale, për të nxitur akoma më shumë këto diskutime, dhe për të përforcuar qëllimet fillestare në lidhje me diversitetin. Në rrethanat më të mira, një vazhdim i tillë do të institucionalizohej në formën e workshop-eve, botimeve të vazhdueshme, dhe forma të tjera të trajnimit gjatë punës dhe mënyra të tjera mbështetjeje.

Mos harroni misionin: Të fuqizohen besueshmëria dhe vlerat e pasqyrit të lajmeve në gazetë, radio, apo television, si mjete të mirëkuptimit dhe tolerancës në komunitet.

Kini parasysh objektivat kryesorë:

- ★ Rritja e larmisë së zërave dhe pamjeve në gjithë lajmet e pasqyruara
- ★ Fuqizimi i lidhjeve me lexuesit, dëgjuesit, shikuesit, si dhe me lexuesit, dëgjuesit, dhe shikuesit e mundshëm në të ardhmen
- ★ Shtrijeni masën e lexuesve, ose publikun e shikuesve ose të dëgjuesve, në një segment më të gjerë të komunitetit
- ★ Nxitni punën dhe komunikimin në grupe brenda organizatës tuaj të lajmeve.

Plani individual i veprimit është një nga hapat më të rëndësishëm në fillim të rrugës së vështirë për të zbatuar atë që keni shqyrtuar gjatë këtij programi. Çdo pjesëmarrës duhet të marrë me vete një plan

veprimi konkret, të cilin do do ta përdorni kur t'i ktheheni punës së përditshme si gazetar.

Ju lutem, ndaloni një minutë dhe konsideroni mënyrat të cilat mund të përdorni për të rritur larminë e zërave dhe pamjeve në punën tuaj, për të eliminuar stereotipet, për të përdorur gjuhën me kujdes, dhe, në përgjithësi, për të qenë të ndjeshëm në lidhje me problemet e diversitetit që u diskutuan gjatë këtij programi.

Më pas, shkruani një përshkrim të shkurtër të hapave që do ndërmerreni për të arritur disa nga objektivat e caktuara në fillim të këtij programi. Merreni planin tuaj si një plan gjashtëmuor; në cdo interval gjashtëmuor do të kontrolloni përparimin tuaj, shtoni edhe një qëllim tjetër ndërsa vazhdoni të lëvizni drejt krijimit të një media informative që vlerëson dhe nxit mirëkuptimin dhe tolerancën në një komunitet. Planet e Veprimit janë deklarata pohuese të cilat përquendohen në detyrën e posacme që ju mendoni se është interesante dhe ia vlen të angazhoheni në fund të programit. Plani i Veprimit duhet konsideruar si plani juaj personal për të punuar dhe për të arritur dicka nga ajo që përshkruhet si deklarata e misionit më sipër. Është e rëndësishme të caktoni qëllime të cilat e dini se jeni në gjendje t'i arrini dhe t'i mbani për gjashtë muaj ose më gjatë.

Disa shembuj. Përdorni hapësirë shtesë për të zhvilluar ose ndryshuar modelet ose për të hartuar një deklaratë veprimesh të cilat do të funksionojnë për ju.

1] Do të diskutoj parimet e diversitetit me një gazetar tjetër atje ku punoj, si dhe do t'i jap materialet e marra gjatë trajnimit. Do ta bëj nga data...

2] Do të përdor gjuhën me më shumë saktësi dhe do të mbikqyr punën time për të eliminuar ofendimet, klishetë, dhe terma të tjera me ngarkesë, të cilat mund të jenë ose janë fyese për një grup apo për një tjetër. Do ta bëj këtë duke...

3] Do t'i shkëmbej strategjitë e mia të suksesshme për një përdorim më të saktë të gjuhës edhe me gazetarët e tjerë. Këtë do ta arrij me anë të ...

4] Do të organizoj një seksion trajnimi për pjestarë të tjerë të stafit, për të diskutuar parimet e diversitetit dhe si përdoren ato për...

5] Do të vëzhgoj pamjet e parqazitura në gazetat tona ose në transmetimet televizive dhe do të bëj sugjerime ose do të planifikoj mbledhjen time të lajmeve për të krijuar mundësi për pamje të larmishme – femra, të moshuarit, njerëz me pre-jardhje të ndryshme racore, etnike, ose fetare – në raportimin tim të lajmeve. Do të filloj duke...

Shënim:

Sugjerimet janë thjesht shembuj të planeve të mundshëm të veprimit. Hartoni deklaratat tuaja duke përdorur sugjerimet e mësipërme si modele. Jini konkretë. Jini specifikë. Jini realistë. Pavarësisht se sa e thjeshtë mund të duket, mos harroni se ne qoftë se secili prej nesh hedh një hap në shtimin e diversitetit të zërave brenda mediave tona informative, aq më shumë i afrohem krijimit të një instrumenti për mirëkuptimin dhe tolerancën në komunitet në të ardhmen.

14. Fjalor i vogël

Fjalor i vogël

DISKRIMINIM MOSHE	Paragjykim ose diskriminim duke u nisur nga mosha e dikujt ose nga stereotipet për njerëzit e moshuar.
ANTI-SEMITIZËM	Paragjykim ose diskriminim ndaj hebrenjve duke u nisur nga mendimet negative rreth praktikave dhe besimeve të tyre fetare ose duke u bazuar në stereotipe etnike.
FANATIZËM	Një ngulmim kokëfortë dhe pabaza në mendime, mënyrën e jetesës dhe sistemin e besimeve, me mungesë të theksuar tolerance apo paragjykim kundrejt perspektivave të kundërta dhe atyre që i kanë këto mendime.
DISKRIMINIM KLASE	Paragjykim ose diskriminim duke u nisur nga klasa sociale dhe ekonomike.
PAAFTËSI	Një mangësi fizike ose mendore, e cila pengon dikë për të kryer disa aktivitete të caktuara, ose ka ndikim negativ në funksionimin intelektual.
DISKRIMINIM	Mohimi i drejtësisë dhe trajtimit me ndershmëri të atyre që bëjnë pjesë në kultura të tjera apo në komunitete të ndryshme etnike dhe grupe të tjera sociale të kategorive të ndryshme, përfshirë këtu punësimin, banimin, të drejtat politike dhe akomodimet publike.
DIVERSITETI	Prania, e cilësive dhe karakteristikave të ndryshme, si në individë, ashtu edhe në grupe njerëzish, qofshin këto elementë të lindur, të cilat në përgjithësi nuk varen nga zgjedhjet personale (mosha, etnia, gjinia, orientimi seksual, paaftësia, etj) ose elementë të përfutur, të cilat janë arsimimi, vendndodhja gjeografike, gjendja civile, besimi fetar, etj.
BARAZIA	Kushti i të pasurit ose i të dhënit të njëjtin dinjitet, vend, ose privilegj si të tjerët.
ETNOCENTRIZËM	Praktika e të gjykuarit me ose pa vetëdije të grupeve të tjera etnike duke u nisur nga vlerat, standartet dhe kriteret e grupit të vet etnik, duke shpërfillur kështu këndvështrime dhe qasje të ndryshme.
INCIDENT URREJTJEJE	Një sulm, bezdi ose veprim tjetër agresiv dhe armiqësor, i cili i drejtohet personit ose pronës së dikujt, duke u nisur nga raca, feja, gjinia, orientimi seksual ose identitet tjetër i një grupi të caktuar.

HETEROSEKSIZËM	Praktika e konsiderimit dhe trajtimit me ose pa vetëdije të homoseksualitetit dhe biseksualitetit si inferiore ndaj heteroseksualitetit, në mënyrë të pandreqshme dhe përtej cdo dyshimi.
HOMOFOBIA	Frikë nga ose përbuzje e njerëzve të cilët janë, ose mendohen se janë, gay, lesbike dhe biseksualë.
MULTIKULTURALIZËM	Praktika e njohjes dhe respektimit të një spektri të gjerë kulturash, fesh, komunitetesh etnike dhe grupe të tjera të cilat bashkëekzistojnë brenda një shoqërie.
PARAGJYKIM	Një dyshim ose urrejtje e paarsyeshme e një kategorie të tërë njerëzish; një gjykim ose mendim armiqësor për të tjerët, duke u nisur vetëm nga ose kryesisht nga statusi i tyre si anëtarë të një grupi të caktuar etnik, fetar ose ndonjë kategorie sociale.
RACIZËM	Paragjykim ose diskriminim duke u nisur nga bindja se disa grupe etnike kanë lindur superiorë ndaj të tjerëve për sa i përket inteligjencës, karakterit moral, sistemit të besimeve, mënyrës së jetesës ose cilësi të tjera.
HEDHJA E FAJIT	Akti i ngarkimit me faj të një kategorie të tërë njerëzish, ose individësh, të perceptuar si anëtarë të atij grupi, në lidhje me probleme sociale, ekonomike, ose të një natyre tjetër, të cilat në të vërtetë e kanë burimin në shkaqe komplekse dhe të shumëfishta.
ORIENTIMI SEKSUAL	Drejtimi i interesit seksual të një personi ndaj pjesëtarëve të të njëjtit seks, të seksit të kundërt, ose ndaj të dy sekseve.
STEREOTIP	Një përgjithësim i gjerë rreth një grupi të tërë njerëzish, i cili shpërfill ose anashkalon mundësinë e dallimeve ose ndryshimeve individuale.
TOLERANCA	Pranimi i dhe mendësia e hapur ndaj praktikave, qëndrimeve dhe besimeve të kulturave të tjera, si dhe ndaj komuniteteve etnike dhe grupeve të tjera sociale.
KSENOFOBIA	Një antipati, frikë ose përbuzje e thellë për të huaj ose njerëz nga kultura të tjera ose grupe të tjera etnike.

Kapitulli i Europës Juglindore për Rrjetin e Raportimit të Diversitetit

Instituti Shqiptar I Medias – Tiranë
Remzi Lani – Drejtor
<http://pages.albaniaonline.net/institutemedia/>

Shoqata e Mediave të Pavarura Electronike (ANEM) – Beograd
Veran Matic – Drejtor
<http://www.anem.org.yu/anemnews/indexSr.jsp>

Agjensia e Lajmeve Beta – Beograd
Dragan Janjic – Drejtor
<http://www.beta.co.yu/>

Qendra për Gazetarinë e Pavarur – Bukuresht
Ioana Avadani – Drejtore
<http://www.ijf-cij.org/>

Qendra për Gazetarinë e Pavarur – Budapest
Sandor Orban – Drejtor
http://www.media-diversity.org/rdn_partners.htm

Qendra për Gazetarinë e Pavarur – Kishinau
Angela Siribu – Drejtore
<http://ijc.iatp.md/en/>

Qendra për Mirëkuptimin dhe Bashkëpunimin Multikulturor – Shkup
Kim Mehmeti – Drejtor

Shoqata e Gazetarisë së Pavarur të Serbisë – Beograd
Milica Lucic-Cavic – Drejtor

Qendra Ndërkombëtare për Arsimimin e Gazetarëve – Opatija
Stjepan Malovic – Drejtor
<http://icej.hnd.hr/>

Instituti Maqedonas për Median – Shkup
Zaneta Trajkoska – Drejtore
<http://www.mim.org.mk/index.htm>

Qendra e Medias – Sarajevo
Boro Kontic – Drejtor
<http://www.media.ba/>

Qendra për Zhvillimin e Medias – Sofia
Ognian Zlatev – Drejtor
<http://www.mediacenterbg.org/>

Instituti Media Plan – Sarajevo
Zoran Udovicic – Drejtor
http://www.media-diversity.org/rdn_partners.htm

Qendra e Shtypit për Romët – Budapest
Gabor Bernath – Drejtor

Agjensia e Lajmeve STINA – Split
Stojan Obradovic – Drejtor
http://www.media-diversity.org/rdn_partners.htm

Vijesti, gazetë e përditshme e pavarur – Podgorica
Zeljko Ivanovic – Drejtor
<http://www.vijesti.cg.yu/>

Për detajet e kontaktimit të ndonjërit nga partnerët e Rrjetit për Raportim të Diversitetit ju lutem kontaktoni Institutin e Diversitetit të Medias (MDI).



Rreth Institutit të Diversitetit të Medias

Instituti i Diversitetit të Medias, me qendër në Londër, është një organizatë jofitimprurëse dhe jo partizane, e cila u formua për të nxitur zgjidhjen e konfliktit nëpërmjet raportimit të diversitetit në shoqëritë në zhvillim e sipër.

Puna kryesore e institutit është koordinimi dhe zgjerimi i Rrjetit për Raportim të Diversitetit (RDN), i cili bashkon gazetarë, organizata lajmesh, qendra për asistencë ndaj medias, shkolla gazetarie dhe të tjerë në një përpjekje bashkëpunimi për të mobilizuar pushtetin e mediave informative në mbështetjen për një kuptim më të thellë publik të diversitetit, komuniteteve të pakicës, konflikteve midis grupeve, dhe të të drejtave të njeriut. RDN-ja promovon standartet më të larta të gazetarisë profesionale në lidhjen e tyre me pasqyrimin e minoriteteve, diversitetit, dhe marrëdhënieve ndëretnike, si dhe zhvillon mjete, mënyra trajnimi dhe iniciativa praktike të raportimit, të nevojshme për të zbatuar këto standarte.

Raportimi i ndershëm, i saktë, dashamirës dhe i thelluar është jetësor për nxitjen e mirëkuptimit midis grupeve të ndryshëm. Media është përdorur shumë shpesh si një armë, duke nxitur paragjykimin dhe diskriminimin. MDI ka për qëllim të ndryshojë dhe ta kthejë median në një armë për fuqizimin e të drejtave të njeriut dhe të demokracisë.

Këto ne i bëjmë kryesisht nëpërmjet arsimimit e trajnimit dhe në bashkëpunim me:

- * gazetarët në profesion;
- * profesorët dhe akademikët që iu japin mësim atyre;
- * pronarët dhe vendim -marrësit në media;
- * mediat, të drejtat e njeriut dhe organizatat e pakicave.

Metoda jonë gjithëpërfshirëse, trajtimi i problemit të diversitetit nga të gjitha këndet e mundshme, është karakteristika specifike e Institutit. Ne trajnojmë gazetarë dhe manaxherë mediash si nga mediat kryesore dhe nga ato të pakicës; ne u mësojmë organizatave të pakicës si të komunikojmë me mediat; ne përpiqemi të fuqizojmë mediat e pakicës dhe ne punojmë me profesorët e gazetarisë, të cilët do të trajnojnë breza të ardhshëm të gazetarëve.

Aktivitetet e MDI-së ndahen në nëntë fusha kryesore:

1. trajnimi për ndërgjegjësimin ndaj diversitetit për gazetarët dhe vendim-marrësit në media
2. trajnimi praktik për diversitetin dhe zhvillimi profesional për gazetarët në mes të karrierës
3. iniciativat e raportimit të diversitetit të lajmeve, përfshirë raportimin në ekip dhe projektet e agjencive të lajmeve
4. zhvillimi i kurrikulumit të diversitetit, në bashkëpunim me fakultetet e gazetarisë
5. trajnim i mediave dhe zëdhënësve nga grupet e pakicës
6. projekte të hartuara për të nxitur pajtimin nëpërmjet medias
7. prodhimi i manualeve për diversitetin, manuale për burime si dhe manuale trajnimi
8. zhvillim profesional pas konflikteve për gazetarët, me vëmendje të vecantë për Çrregullime Traummatike Post Stres (PTSD)
9. monitorimi i mediave në lidhje me problemet e diversitetit

Manual i Raportimit të Diversitetit

Autor: David Tuller për Institutin e Diversitetit të Medias

Botues: Instituti i Diversitetit të Medias
Samizdat B92 [www.b92.net/samizdat]

Botues: Lydia El Khouri për Institutin e Diversitetit të Medias dhe
Dejan Ilic për Samizdat B92

Përktheu: L Lazar Semini

Redaktoi: Agim Doksani

Dizajn i kopertinës: Leonard Vucinic

Faqosja: Samizdat

Printimi: STANDARD 2

CIP – Katalogizacija u publikaciji
Narodna biblioteka Srbije, Beograd

316.344/.35:316.77(035)
659.3/.4(035)
32.019.5(035)

TULLER, David
Reporting Diversity Manual / David Tuller ;
foreword by John Owen. – Belgrade : Samizdat B92 ;
London : Media Diversity Institute, 2002 (Belgrade
: Standard 2). – 145 str. ; 21 cm

Foreword: str. 11. – Str. 13–15: Introduction /
Milica Pešić. – Glossary: str. 141–142.

ISBN 86-7963-161-2

a) Масовне комуникације – Транзиција – Приручници
b) Мањинске групе – Масовне комуникације – Приручници

COBISS-ID 102994700

